




# Koha

www.koha.mk



Pijaneci më i suksesshëm në historinë amerikane

FAQE 9

E përditshme informative

Viti XI • Numri 3150 • E enjte 17 gusht 2017 15 DEN

## Nga 10818 vende, vetëm 215 në gjuhën shqipe



Shkup, 16 gusht – Të enjten dhe të premten (në datat 17 dhe 18 gusht) do të hapen dyert për regjistrimin e studentëve të rinj edhe në Universitetin "Kirili dhe Metodi" në Shkup. Në universitetin më të vjetër në vend, për vitin akademik 2017/2018 janë rezervuar 10818 vende,

prej të cilave 5865 për studentë të rregullt me kuotën shtetërore të financimit, 3793 vende për studentë të rregullt me bashkëfinancim dhe 1116 për studime me korrespondencë. Tarifat e studimeve si në të gjitha universitetet publike për një semestër janë 100 euro për studime

me kuotën shtetërore të financimit, si dhe 400 euro në kuotën e bashkëfinancimit dhe në kuotën e studimeve me korrespondencë. Për UKM-në prej këtij viti, me vendim të Qeverisë janë ndërprerë të gjitha programet e disperzuara.

FAQE 4

Ligji për mbrojtjen e gjuhës

## Dështon departamenti, gati Agjencia për shqipen



Përveç përcaktimit në ligj në vija të përgjithshme të mënyrës së funksionimit, nuk ka asnjë informacion më konkret dhe as përfshirje të institucioneve të tjera akademike, katedrave, instituteve e të tjera. Gjithçka duket se do të mbetet në Qeveri, e cila pritet të merret me formimin e grupeve të punës, emërimet, e të tjera

FAQE 2

## Nënshkruhet protokoli për hapjen e kufirit Bellanoc-Stançiq



Prishtinë, 16 gusht - Në Prishtinë të mërkurën është nënshkruar protokoli teknik mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë për hapjen e pikës kufitare Bellanoc-Stançiq. Nga Maqedonia protokollin e ka nënshkruar zëvendësministria e Jashtme Arta Toçi, kurse pjesë e delegacionit qeveritarë ishte edhe

zëvendësministri i MPB-së, Agim Nuhiu. "Pas një angazhimi të shtuar të zv/kryeministrit Osmani dhe anëtarëve të tjerë të kabinetit qeveritar, projekti për pikën kufitare "Bellanoc-Stançiq" mori drejtimin e duhur. Me nënshkrimin e Protokollit me palën kosovare në Prishtinë, Qeveria e Maqedonisë përmbyll

pjesën e detyrimeve të saj duke i mundësuar palës kosovare edhe kontraktimin e menjëhershëm të kompanisë për ndërtimin e objektit të përbashkët në pikën kufitare "Bellanoc-Stançiq", ka njoftuar përmes "Facebookut", zv/ministri i Punëve të Brendshme, Agim Nuhiu.

FAQE 2

SPORT

E njohim Milanin, por Shkëndija do të shfaq më të mirën



Të vënë para reputacionit dhe historisë së klubit italian, tre lojtarët shprehen me respekt për Milanin, por theksojnë se Shkëndija do të jap më të mirën nga vetja. Kapiteni Adrian Cuculi thotë se Shkëndija për dy...

FAQE 19

GLOBI

Vështirësohet situata në Shtëpinë e Bardhë

FAQE 15

RAJON

Janë ndërmarrë hapa kundër radikalizimit religjioz

FAQE 14

HISTORI

Spastrimi i fundit i Stalinit



FAQE 9





Ligji për mbrojtjen e gjuhës

# Dështon departamenti, bëhet gati Agjencia për shqipen

Përveç përcaktimit në ligj në vija të përgjithshme të mënyrës së funksionimit, nuk ka asnjë informacion më konkret dhe as përfshirje të institucioneve të tjera akademike, katedrave, instituteve e të tjera. Gjithçka duket se do të mbetet në Qeveri, e cila pritet të merret me formimin e grupeve të punës, emërimet, e të tjera



Koha Evis HALILI

Shkup, 16 gusht – Agjencia për zbatimin e gjuhës shqipe, që do të jetë kompetente për standardizimin dhe përdorimin e njehsuar të gjuhës, është institucioni që pritet të themelohet si pjesë e Ligjit për gjuhën shqipe dhe të miratohet nga Parlamenti. Përveç përcaktimit në ligj në vija të përgjithshme të mënyrës së funksionimit, nuk ka asnjë informacion më konkret dhe as përfshirje të institucioneve të tjera akademike, katedrave, instituteve e të tjera. Gjithçka duket se do të mbetet në Qeveri, e cila pritet të merret me formimin e grupeve të punës, emërimet, e të tjera. Themelimit të kësaj Agjencie, i paraprin vetëm ideja e dështuar e themelimit të një institucioni të ngjashëm brenda IT-

SHKSH-së dy vjet më parë dhe asnjë lloj debati publik, por edhe masa përgatitore dhe përfshirje të institucioneve kompetente, katedrave, gjuhëtarëve, e të tjera.

Po si i parashikon propozim-ligji kompeten-

cat e Agjencisë? Institucioni do të duhet të japë mbështetjen e vet të gjitha institucioneve të tjera gjatë përkthimit dhe lekturimit të dokumenteve. Do të duhet të korrektojë të gjitha dokumentet që publikohen në Gazetën

zyrtare, të promovojë dhe të marrë masa për avancimin e shqipes, të hartojë për nevoja të Qeverisë materiale analitike dhe t'i raportojë asaj për punën që bën. Të japë mendim profesional për ato materiale që janë në

funkcion të zbatimit dhe avancimit të gjuhës shqipe.

Sipas Ligjit, drejtori i institucionit do të zgjidhet nga Qeveria, me një mandat katër vjeçar dhe në të parashikohet të punojnë përkthyes, linguistë dhe filologë, si edhe lektorë të licencuar, saktësohet në ligj, edhe pse të tillë në fakt nuk ekzistojnë. Për krijimin e Agjencisë dhe të inspektoratit nga buxheti i shtetit për vitin e parë të funksionimit do të akordohet një fond prej 16 milionë denarë. Ndërsa punësimet në to do të bëhen duke transferuar punonjës nga institucione të tjera shtetërore, kryesisht nga Sekretariati për Implementimin e Marrëveshjes së Ohrit. Po ashtu

tu në buxhetin e vitit 2018 do të ndahet edhe një fond tjetër prej 90 milionë denarësh, i cili do t'i jepet shfrytëzuesve të tjerë buxhetorë që do të merren me implementimin e dispozitave të Ligjit. Po ashtu, Inspektorati do të jepte organin tjetër që do të merret me sanksionimin e abuzimeve me drejtshkrimin e gjuhës. Gjobat parashikohen të shkojnë nga 4 mijë deri në 5 mijë euro dhe do t'iu shqiptohen të gjitha organeve të pushtetit shtetëror, institucioneve qendrore, ndërmarrjeve publike, agjencive, drejtorive, organizatave dhe enteve, komisioneve, personave juridik, e të tjerë.

Themelimi i Agjencisë u parapri dy vjet më parë me një iniciativë të ngjashme, ajo e krijimit të një Sektori për mbrojtjen e gjuhës shqipe, por edhe dhënien e licencave të lektorëve të gjuhës. Në fund të vitit 2015 me kërkesë të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore ish ministri i Arsimit dhe Shkencës Abdilajim Ademi ranë dakord për themelimin e një Sektori, që do të shërbente si një mekanizëm i fuqishëm për mbrojtjen e gjuhës shqipe, sidomos në përdorimin e saj zyrtar. Grupi i punës do të përbëhej edhe nga përfaqësues të Ministrisë së Kulturës, Sekretariati për Implementimin e Marrëveshjes së Ohrit. Për dy vjet jo vetëm që nuk u krijua asnjë lloj sektori, por edhe grupi punues nuk arriti të mblidhej.

## Si i parashikon propozim-ligji kompetencat e Agjencisë?

Institucioni do të duhet të japë mbështetjen e vet të gjitha institucioneve të tjera gjatë përkthimit dhe lekturimit të dokumenteve. Do të duhet të korrektojë të gjitha dokumentet që publikohen në Gazetën zyrtare, të promovojë dhe të marrë masa për avancimin e shqipes, të hartojë për nevoja të Qeverisë materiale analitike dhe t'i raportojë asaj për punën që bën. Të japë mendim profesional për ato materiale që janë në funksion të zbatimit dhe avancimit të gjuhës shqipe. Sipas Ligjit, drejtori i institucionit do të zgjidhet nga Qeveria, me një mandat katër vjeçar dhe në të parashikohet të punojnë përkthyes, linguistë dhe filologë, si edhe lektorë të licencuar, saktësohet në ligj, edhe pse të tillë në fakt nuk ekzistojnë

## Nënshkruhet në Prishtinë protokoli për hapjen e kufirit Bellanoc-Stançiq

Me nënshkrimin e Protokollit me palën kosovare në Prishtinë, Qeveria e Maqedonisë përmbyll pjesën e detyrimeve të saj duke i mundësuar palës kosovare edhe kontraktimin e menjëhershëm të kompanisë për ndërtimin e objektit të përbashkët në pikën kufitare "Bellanoc-Stançiq"



Prishtinë, 16 gusht - Në Prishtinë të mërkurën është nënshkruar protokoli teknik mes Republikës së Kosovës dhe Republikës

së Maqedonisë për hapjen e pikës kufitare Bellanoc-Stançiq. Nga Maqedonia protokollin e ka nënshkruar zëvendësministr-

ja e Jashtme Arta Toçi, kurse pjesë e delegacionit qeveritarë ishte edhe zëvendësministri i MPB-së, Agim Nuhiu. "Pas një

angazhimi të shtuar të zv/kryeministrit Osmani dhe anëtarëve të tjerë të kabinetit qeveritar, projekti për pikën kufitare "Bel-

lanoc-Stançiq" mori drejtimin e duhur. Me nënshkrimin e Protokollit me palën kosovare në Prishtinë, Qeveria e Maqedonisë përmbyll pjesën e detyrimeve të saj duke i mundësuar palës kosovare edhe kontraktimin e menjëhershëm të kompanisë për ndërtimin e objektit të përbashkët në pikën kufitare "Bellanoc-Stançiq", ka njoftuar përmes "Facebookut", zv/ministri i Punëve të Brendshme, Agim Nuhiu. Paraprakisht, të martën zëvendëskryeministri i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Bujar Osmani, e nënshkroi plotësimin e Marrëveshjes për financim të IPA programit për bashkëpunim ndër-kufitar mes Republikës së Maqedonisë dhe

Republikës së Kosovës për vitin 2013, me çka edhe ligjërisht IPA mjetet e këtij programi vihen në dispozicion për financim të projektit strategjik Bellanoc-Stançiq. Kësaj i parapriu vendim i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë me çka Osmani mori autorizimin për nënshkrim të plotësimin të marrëveshjes për financim të IPA-s. "Me përkushtim të madh u punua për plotësimin e të gjitha kushteve të domosdoshme, të cilat ishin të nevojshme për fillimin e realizimit të këtij projekti. Një prej aktiviteteve më të rëndësishme ishte ndërtimi i rrugës deri tek kalimi i ri kufitar, i cili u financua prej mjeteve nacionale në shumë prej rreth 6.000.000 eurosh", tha Osmani për mediat.





Partitë në pushtet LSDM, BDI dhe ASH, kalkulojnë për koalicionet joformale në rrethine dytë zgjedhor, ndërsa ASH dhe LSDM llogaritin edhe në përkrahjen e Lëvizjes BESA në bastionet e tyre. VMRO synon ta diskreditojë LSDM-në para shqiptarëve, kurse kjo u fundit pretendon fitore në Qytetin e Shkupit me ndihmën e shqiptarëve

# Partitë kalkulojnë bashkëpunimet për lokalet

## Pushteti dhe opozita me koalicionet joformale

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 16 gusht - Partitë politike në të dyja taboret po bëjnë kalkulimet e radhës për zgjedhjet lokale, nga njëra në përzgjedhjen e emrave dhe me pike-timin e premtimeve kyçe ndaja elektoratit, dhe nga ana tjetër edhe me bashkëpunimet e mundshme ndërmjet veti, qoftë edhe me koalicionet joformale. Pikërisht bastionet e partive në pushtet dhe atyre opozitare do të bëjnë pika referuese për të bashkëpunuar ndërmjet veti në rrethin e dytë zgjedhor, ndërsa në raste të caktuara nuk përjashtohet edhe bashkëpunimi që në rrethin e parë, kjo për ta ndihmuar njëra-tjetrën të shkojnë në rrethin e dytë zgjedhor, si për shembull në Strugë, Gostivar, Tetovë dhe në Qytetin Shkupit, por edhe në disa komuna rurale.

### VMRO synon ta diskreditojë LSDM-në para shqiptarëve

Burime nga VMRO për gazetën KOHA theksojnë se në këtë parti "aktualisht janë duke u ndërtuar kauzat kundër LSDM-së me dështimin e saj me deponitë, zjarret dhe aspektet tjera, kjo që të krijojë bindja ndaj qytetarëve, sidomos atyre shqiptarë, se LSDM nuk është e aftë të qeverisë me vendin dhe të realizojë premtimet ndaj tyre". Duke qenë të sigurt se në elektoratin maqedonas nuk mund t'i rival-



izojë siç pret vetë LSDM-ja, nga VMRO po përpiqen që përmes dështimeve të LSDM-së të relativizojnë votën shqiptare që ishte dhe theksuar nga partnerët parlamentarë dhe ishte kyçe që LSDM të marrë 49 deputete nga 33 sa kishte më herët. Nga kjo parti, siç thonë këto burime, presin përsëri mbështetje tek romët, turqit dhe serbët, ndërsa synimet i kanë që të mbajnë Qytetin e Shkupit dhe qendrat kryesore, si Manastiri, Ohri, Shtipi, Gjevgjelia, Velesi, ndërsa kësaj radhe do të tentojnë të marrin edhe Kumanovën.

Nga ana tjetër, LSDM hynë me pretendime të mëdha që pas shumë vitesh qeverisje me pushtetin lokal të VMRO-së, kësaj radhe ta fitojnë atë në shumicën e komunave maqedonase, ndërsa me gjasa hynë edhe në disa komuna shqiptare, si Haraçina, Kërçova dhe Di-

bra, ku pritet të ketë kandidat shqiptar nga kjo parti. Në LSDM, sipas burimeve anonime, presin mbështetje për qytetin e Shkupit nga partnerët shqiptar në qeveri BDI dhe ASH, meqë Shkupi është synimi kryesorë i kësaj partie, kurse emrat që përfliten janë ai i Petre Shilegovit, Damjan Mançevskit dhe Stevo Pendarovskit. Por në këtë mes, për LSDM-në nuk përjashtohet bashkëpunimi në rrethine dytë me subjektet politike shqiptare BDI, ASH, por edhe Lëvizja BESA, sidomos në komunat e qytetit të Shkupit por dhe rreth tija, si Buteli, Çairi, Gazi Baba, Karposhi Studeniçani, Saraji, Haraçina, Kumanova.

### BDI solo, LR-PDSH targeton komunat perëndimore

Nga partitë shqiptare BDI në bllok hynë me syn-

ime në të gjitha komunat shqiptare, duke pasur si përparësi përvojën dhe qeverisjen afatgjatë diku me performanca pozitive, kjo sipas asaj që thonë burime nga vetë strukturat e larta partiake. Vetëm në Kërçovë BDI mund të ketë bashkëpunime të hapura me partitë tjera shqiptare, përveç në mëdyshe është mbështetja e Lëvizjes BESA. Po sipas këtyre burimeve, BDI sa ai përket partive tjera mund të ketë bashkëpunim të heshtur me RDK-në e Vesel Memedit dhe në një pjesë e strukturave të UNITEIT të afërta me kryetarin Gëzim Ostreni. Ndërkohë LR-PDSH pritet këto ditë të pranohet vendim për emrin ri partiak nga organet shtetërore, pra të titullohet Aleanca për Shqiptarët para zgjedhjeve lokale. Burime nga kjo parti thonë se nga partitë maqedonase nuk përjashtojnë

### BESA: S'KEMI KONFLIKTE TË BRENDSHME PËR KANDIDATURAT

Nga kjo parti përjashtojnë zërat se ka konflikte të brendshme për kandidaturat, duke thënë se Lëvizja BESA ka demokraci partiake më shumë se çdo parti tjetër, ku kandidatët nuk i cakton me diktat kryetari i partisë, por ato do të vijën në shprehje vetëm pas debateve dhe analizave në degë dhe në Këshillin e përgjithshëm. Kohëve të fundit BESA ka vendosur kontakte me PDSH-në, i cili afrim u konsideruar si afrim para zgjedhjeve lokale, sidomos në Tetovë ku PDSH hyn me pretendime të mëdha, ndërsa përkrahja t'i kthehet BESËS në komunat e Shkupit dhe atë Likovës, përveç se në Studeniçan ku BESA mund ta përkrah PDSH-në në rrethine dytë zgjedhore. Mirëpo, vet kreu i PDSH disa ditë pas takimit tha se janë ndarë pa rezultat konkret. Kohë më parë burime nga PDSH për gazetën KOHA referuan se kjo parti synim kryesor ka Tetovën, ndërsa do të ketë kandidat dhe lista për këshilltar në të gjitha komunat shqiptare, kurse bashkëpunimin me partitë tera përveç me ASH-së nuk e përjashtojnë, por vetëm në ato në komuna ku rrezikohet vota shqiptare.

bashkëpunimin me LSDM për qytetin e Shkupit dhe ndihma t'i kthehet nga kjo parti në rajonin veriperëndimor, nga Vrapçishti e deri në Strugë. Nga ASH po në komunat perëndimore, sidomos në Gostivar dhe Vrapçisht, presin përkrahje në rrethin e dytë nga Lëvizja BESA, të cilës mund t'ia kthejnë në komunat e pjesës veriore, si Çairi, Saraji, Studeniçani, Haraçina dhe Likova. Në raport me BDI-në, nga kjo parti thonë se bashkëpunimi mund të lidhet vetëm nga liderët partiak, edhe atë për rrethin e dytë zgjedhor duke përjashtuar Kërçovën, kjo pasi rela-

cionet si partner qeveritar janë dëmtuar pasi BDI aktualisht po frenon të lëshojë disa nga drejtoritë që i takojnë ASH para zgjedhjeve lokale. Sa i përket Lëvizjes BESA, ende është herët të thuhet nëse në bllok do të përjashton bashkëpunim në rrethin parë me partitë tjera, ndërsa në rrethin e dytë varësisht nga rezultate kjo parti llogaritin në votat e LSDM-së, të ASH dhe të PDSH-së. Referuar burimeve partiake, Lëvizja BESA në zgjedhjet lokale hyn me pretendimin reale t'i fitojë ato në mbi 50 % të komunave, ndërsa fitore bindëse që në rrethin e parë e presin në Çair, Saraj, Likovë dhe Tearcë.

## Zaev kërkon termine nga Xhaferi, i gatshëm për pyetje të deputetëve

Shkup, 16 gusht - Kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë Zoran Zaev të mërkurë me shkrim kërkoi nga kryetari i Kuvendit Talat Xhaferi që të caktojë termin për pyetje tematike të deputetëve një herë në javë. Në letër, Zaev thotë se Qeveria është e gatshme që të fillojnë pyetjet javore tematike të deputetëve në kohëzgjatje prej një ore, në kohë dhe format të cilin do ta caktojë kryetari i Kuvendit. "Në kontekst të zbatimit të tërësisht të Planit 3-6-9, do të doja ta shpreh gatishmërinë e padyshimtë të Qeverisë për mbajtjen e pyetjeve javore, tematike të deputetëve në kohëzgjatje prej një ore, në kohë dhe format të cilin Ju do ta

vlerësoni se është më adekuati dhe në pajtim me procedurat e Juaja të brendshme", thuhet në letërën e kryeministrit. Zaev përkujton se në pjesën e Planit, i cili përqendrohet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, Qeveria u obligua në përkrahje të tërësishtme të një sërë masash me qëllim të kthimit të ambientit demokratik në këtë institucion kyç, përmes dialogut politik dhe bashkëpunimit me të gjitha partitë parlamentare, duke përfshirë edhe opozitën. "Qeveria është e gatshme të japë kontribut në sigurimin e kushteve për implementimin e rekomandimeve të kontraktuara pas ngjarjeve jo të hijshme më 24/12/2012



dhe lidhur me ngjarjet e dhunshme më 27/04/2017. Në këtë drejtim, në bashkëpunim të hapur dhe të sinqertë me opozitën, partnerët e koalicionit dhe shumica do të kujdesen që funksioni mbikëqyrës i kuvendit dhe

trupave kuvendore mbi punën e Qeverisë dhe shërbimeve të saj të sigurisë dhe zbuluese të jetë i rregullt dhe rutinor. Shumica do të angazhohet edhe për përfshirje më të madhe të shoqërisë qytetare në diskutimet e

trupave të Kuvendit", shton Zaev. Qeveria i përshëndet hapat e Kuvendit për plotësimin e dispozitivave nga Plani 3-6-9 si riaktivizimin e Klubit të deputeteve dhe Komisionit të përhershëm anketues, si dhe fillimin e punës të dy komisioneve për mbikëqyrje të shërbimeve. Gëzohemi për bashkëpunimin e ardhshëm me ta. Qeveria, sipas tij, aktivisht angazhohet edhe për përfshirje të Kuvendit në reformën e shërbimeve zbuluese dhe të sigurisë, e cila momentalisht, siç tha, është në vijim. Qeveria po ashtu obligohet dhe pranon elaborim të obligueshëm para trupave të Kuvendit të propozim ligjeve në nivel ekspert.

Kryeministri informon se në periudhën e ardhshme, Qeveria do t'i përgatis aktivitetet e ardhshme nga plani 3-6-9. "Ju ftoj, së bashku me Juve dhe kolegët e Juaj, që bashkarisht t'i harmonizojmë hapat e ardhshme reformuese, të cilat do ta përforcojnë ambientin demokratik në vend dhe posaçërisht në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe sërish do të hapet perspektiva evropiane e vendit tonë", thekson Zaev në letërën dërguar Xhaferit. Njëheri ia uroi edhe 100 ditët e para nga udhëheqja me Dhomën ligdhënëse në drejtim të arritjes së transparencës më të madhe dhe afrimin deri te qytetarët.





Jo të gjitha vendet e Katedrës së shqipes janë për studentët shqiptarë. Vetëm 55 vende janë për drejtimin e pedagogëve, ndërsa 60 vendet tjera janë për programin e përkthyesve edhe atë të ndara taksativisht përgjysmë mes shqiptarëve dhe jo shqiptarëve

Numri i vendeve për studime në gjuhën shqipe, në kuadër të UKM-së vazhdon të mbetet në kuotat e 215 vendeve, që nuk përbën as 2 për qind të numrit të përgjithshëm në nivel universiteti. Përveç kësaj, studimet në gjuhën shqipe janë të limituara vetëm në dy fakultete dhe katër programe studimore. Tradicionalisht UKM ka studime shqip në Fakultetin Filologjik "Bllazhe Koneski" (85) dhe në Fakultetin Pedagogjik "Klimendi i Ohrit" (130)

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 16 gusht – Të enjten dhe të premten (në datat 17 dhe 18 gusht) do të hapen dyert për regjistrimin e studentëve të rinj edhe në Universitetin "Kirili dhe Metodi" në Shkup. Në universitetin më të vjetër në vend, për vitin akademik 2017/2018 janë rezervuar 10818 vende, prej të cilave 5865 për studentë të rregullt me kuotën shtetërore të financimit, 3793 vende për studentë të rregullt me bashkëfinancim dhe 1116 për studime me korrespondencë. Tariaf e studimeve si në të gjitha universitetet publike për një semestër janë 100 euro për studime me kuotën shtetërore të financimit, si dhe 400 euro në kuotën e

## Të enjten dhe të premten regjistrimi në UKM Nga 10818 vende, vetëm 215 në gjuhën shqipe



bashkëfinancimit dhe në kuotën e studimeve me korrespondencë. Për UKM-në prej këtij viti, me vendim të Qeverisë janë ndërprerë të gjitha programet e disperzuara.

Numri i vendeve për studime në gjuhën shqipe, në kuadër të UKM-së vazhdon të mbetet në kuotat e 215 vendeve, që nuk përbën as 2 për qind të numrit të përgjithshëm në nivel universiteti. Përveç kësaj studimet në gjuhën

shqipe janë të limituara vetëm në dy fakultete dhe katër programe studimore. Tradicionalisht UKM ka studime shqip në Fakultetin Filologjik "Bllazhe Koneski" (FBK) dhe në Fakultetin Pedagogjik "Klimendi i Ohrit" (FKO). Në këtë të fundit, janë 410 vende gjithsej. Në gjuhën shqipe për programet e mësuesisë janë ndarë 70 vende, kurse në programet e edukatorëve 60 vende, respektivisht 130 vende gjithsej.

290-të vendet e mbetura janë për studime në gjuhën maqedonase dhe turke. FBK-ja, për këtë vit ofron 980 vende gjithsej. Pas Katedrës së Gjuhës dhe letërsisë Angleze, e dyta me radhë për nga numri më i madh i vendeve për regjistrim është Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe. Te anglishtja janë 120 vende, ndërsa te shqipja 115 vende. Mirëpo, jo të gjitha vendet e Katedrës së shqipes janë për

studentë shqiptarë. Vetëm 55 vende janë për drejtimin e pedagogëve, ndërsa 60 vendet tjera janë për programin e përkthyesve edhe atë të ndara taksativisht përgjysmë mes shqiptarëve dhe jo shqiptarëve. Pra, në programin studimor të përkthyesve, sipas Konkursit 30 vende janë për studentë që e kanë shqipen gjuhë amtare ndërsa 30 vende për studentë që nuk e kanë shqipen gjuhë amtare. Rrjedhimisht në këtë fakultet, në Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe për studentët shqiptarë do të ketë vetëm 85 vende. Fakultete me më tepër vende të UKM-së janë ai i Shkencave Matematike-Natyrore (1115), i Filozofisë (1090) dhe i Ekonomisë (1050). Në universitetet tjera publike, regjistrimi ka filluar që në datat 15, respektivisht 14 gusht. Në bazë të kuotave të caktuara nga Qeveria, për të gjitha universitetet publike janë siguruar 26105 ven-

de, prej të cilave 13953 për studime të rregullta në kuotën shtetërore, 8367 për studime të rregullta me bashkëfinancim dhe 3785 për studime me korrespondencë. Një vëmendje e veçantë, sikurse është bërë e ditur paraprakisht nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, i është kushtuar studimeve që ofrojnë kualifikime të nevojshme për tregun e punës. "Gjatë konfirmimit të numrave për regjistrim të studentëve është bërë llogari për nevojat e tregut të punës, deficitin e profesioneve dhe mundësitë e disponueshme për punësim, numrin e studentëve për të cilat janë akredituar fakultetet, si dhe për treguesit për interesin e nxënësve të shkollave të mesme për regjistrim në fakultete të caktuara viteve të kaluara", bënte të ditur MASH. Si rezultat të qasjes së diskriminimit pozitiv gjinor dhe eurointegimeve, është marrë vendim që në UKM të aktivizohen studimet gjinore në Fakultetin Filozofik të cilat ishin pezulluar 5 vjetet e kaluara, si dhe studimet për Siguri dhe Eurointegime, të cilat gjithashtu ishin të pezulluara viteve të fundit. Për herë të parë këtë vit janë konfirmuar edhe kuotat për regjistrimin e studentëve me vetëm njërin print, në programe të caktuara e që do të paguajnë gjysmën e shumës për regjistrim.

## UT organizon Kongresin ndërkombëtar të bujqësisë

Tetovë, 16 korrik - Universiteti i Tetovës, në bashkëpunim me Qendrën kërkimore-shkencore "Nobel" nga Republika e Turqisë, prej 15 deri 18 gusht 2017, në Shkup, organizojnë Kongresin ndërkombëtar të bujqësisë. Në këtë kongres, me kumtesat e tyre marrin pjesë mbi 100 studiues nga Maqedonia dhe Turqia. Prorëktori për Shkencë i Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Hazir Pollozhani, në hapjen solemne, theksoi se qëllimi i këtij kongresi është që të diskutohet dhe të prezantohen rezultatet e punës kërkimore dhe profesionale dhe në këtë mënyrë të mundësojmë një transferim më të mirë të arritjeve profesionale dhe shkencore në fushat e bujqësisë, ushqimit dhe mjedisit, në drejtim të një zhvillimi të qëndrueshëm, duke vendosur një bashkëpunim afatgjatë midis studiuesve nga universitetet tona, institucioneve kërkimore dhe specialistëve të fushave të ndryshme, nga rajoni dhe më gjerë. "Ndërtimi i urave ndërmjet biodiversitetit, reduktimit të varfërisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm të bujqësisë është çështje thelbësore. Përdorimi i natyrës, shfrytëzimi i natyrës, kualiteti i ambientit jetësor i një vendi, ose më thjeshtë, resurset e biodiversitetit të një vendi janë të lidhura ngushtë me zhvillimin ekonomik. Zh-

villimi i qëndrueshëm mbështetet në idenë: „mendo globalisht dhe veçpro lokalisht“. Potenciali ekzistues i resurseve natyrore dhe atyre profesionale i rajonit tonë përmes një strategjie për zhvillim të qëndrueshëm, duke u mbështetur pikërisht në simbiozën në mes të shkencës dhe të arriturave shkencore e premtion një gjë të tillë", tha Prof. Dr. Hazir Pollozhani. Ndërkaq, kryetari i Qendrës kërkimore-shkencore "Nobel" nga Republika e Turqisë, Prof. Dr. Mehmet Karataş, tha se ky kongres paraqet një platformë akademike ideale për hulumtuesit, që t'i paraqesin zbulimet më të reja, t'i përshkruajnë teknologjitë e reja dhe lëmenjtë e shkencave inxhinierike. "Ky kongres ka për qëllim prezantimin e gjetjeve të reja nga fusha e shkencave inxhinierike. Kongresi është një e arritur si rezultat i bashkëpunimit ndërkombëtar që ne vazhdimisht e kultivojmë. Prandaj, në emër të këtij kongresi dhe në emrin tim personal, në mënyrë të veçantë e falënderoj Prof. Dr. Vullnet Ametin, Rektor i Universitetit të Tetovës, për përkrahjen e këtij bashkëpunimi të përbashkët në një atmosferë ndërkombëtare, ku promovohen bashkëpunimi ndërkufitar dhe llojllojshmëria", u shpreh Karataş.

## Projektet kapitale në zgrrip financiar

### Për dy teatrot mezi janë derdhur paratë

Kjo "praktikë" e funksionimit në zgrrip financiar pritet të ndryshojë dhe për të dy këto projekte nga buxheti i shtetit do të ndahen fondet e duhura për të përshpejtuar përfundimin e tyre. Mbështetja për kulturën shqiptare, por edhe për projekte që zhvillohen në frymë përjashtuese për shqiptarët, siç është rasti i festivaleve ndërkombëtare, do të realizohet përmes ndryshimeve edhe frymës së re për avancimin e kulturës së përbashkët

Koha Evis HALILI

Shkup, 16 gusht – Zvarritja e dy projekteve kapitale të kulturës, që duhej të kishin përfunduar vite më parë, Teatri Shqiptar të Shkupit dhe kompleksit Biblioteka dhe Teatri i Tetovës kanë ardhur si pasojë e barrierave financiare për të përfunduar në kohë punimet. Për të janë ndarë më pak para sesa duhej për të siguruar ecurinë e parashikuar të punimeve, si për rindërtimin e teatrit në Shkup, ashtu edhe për ndërtimin e godinës në Tetovë. Kështu i arsyeton ministri Robert Allagjozovski afatet e tejkaluara dhe ngecjen prej disa vitesh të punimeve. Duke u bazuar në dokumentacionet dhe



korrespondencat mes këtyre institucioneve dhe Ministrisë së Kulturës neglizhencat për të shlyer detyrimet financiare dhe për të siguruar fonde të mjaftueshme nga kjo e fundit janë shkaktarët e situatës së krijuar. Kjo "praktikë" e funksionimit në zgrrip financiar pritet të ndryshojë dhe për të dy këto projekte nga buxheti i shtetit do të ndahen fondet e duhura për të përshpejtuar përfundimin e tyre. Mbështetja për kulturën shqiptare, por edhe për projekte që zhvillohen në frymë përjashtuese për shqiptarët, siç është rasti i festivaleve ndërkombëtare, do të realizohet përmes ndryshimeve edhe frymës së re për avancimin e kul-

turës së përbashkët. Vetë Ligji për gjuhën shqipe do të ndryshojë situatat, si tek manifestimi "Mbrëmjet Poetike të Strugës", ku atakimi i drejtuesve të festivalit dhe komunës ka ardhur si pasojë e neglizhimit të gjuhës shqipe, por edhe elementeve shqiptare dhe strugane në të. Sa i takon "spastrimeve" në shumë institucione dhe emërimeve të reja, ato janë bërë për të ndërprerë zinxhirin e abuzimeve nga ish drejtuesit. Mesa duket lista do të jetë më e gjatë pas ndryshimeve në Ligjin e Kulturës dhe atë të Admnistratës, por edhe pas përfundimit të zgjidhjeve lokale. Abuzimet kryesisht janë bërë në shpërndarjen e pabarabartë të parave

dhe format diferenciale të pagimit të honorarëve. Ministri ka përmendur rastet e kur një institucion ka shpenzuar 47 mijë denarë për reklama duke blerë vathë, varëse, e të tjera. Vetëm skenografia e hapjes së MPS është paguar 200 mijë denarë, honorare këto që janë paguar po ashtu edhe për skenografi në Verën e Ohrit, kokteli për Filarmoninë ka kushtuar 600 mijë denarë..., e të tjera. "Shkak për ndryshimet e drejtorëve të disa institucioneve dhe anëtarëve të këshillave drejtues kanë qenë veprimtaria antiligjore e tyre dhe keqpërdorimi i detyrës", ka sqaruar ministri. Emërimet e reja janë shoqëruar me debate në opinion, siç ishte zgjedhja e poetit Leshkovski në MPS, i cili dha dorëheqje. Ushtruesit në detyrës do të jenë në këto pozicione të përkohshme deri në gjashtë muaj, deri në emërimet e reja, për të cilat do vendosen kritere të reja të përzgjedhjes. Ndryshime të tjera do të pësojnë edhe Ligji për të drejtat e autorit, Programi vjetor i kulturës, e të tjera.

### "LAKURIQ PËR PROMETEUN ME TË MBATHURA"

Duke sqaruar për një fotografi nudo publikuar ku shfaqet ministri, pjesë e një projekti artistik të disa viteve më parë Allagjozovski thotë se ajo është një tentativë e turpshme nga ana e VMRO-DPMNE për të denigruar atë. "Ajo është pjesë e një projekti dhe publikimi cenon edhe të drejtat e autores. Fotografia lakuriq është një protestë ndaj Prometeut që ka mbathje", ka sqaruar ministri. Ai ka shtuar se në të ardhmen do të vazhdojnë që të kurojnë një politikë kulturore transparente dhe të hapur, e cila respekton krijimtarinë e lirë.





**Vendimi i Ministrisë së Mbrojtjes për të shpallur afat të dytë të regjistrimit për pranimin e kadetëve në Akademinë Ushtarake vjen pas denoncimit të gazetës KOHA për diskriminim të kandidatëve në procedurën e selektimit. Madje, pas konstatimit të parregullsive nga MM, ka ndryshuar edhe rregullorja për pranimin e kadetëve të rinj**

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 16 gusht - Refuzimi i pa arsyeshëm i dhjetë kandidatëve për pranin në Akademinë Ushtarake, të cilin Komisioni psikiatrik e bëri në fund të muajit qershor, ka ndikuar që Ministria e Mbrojtjes të publikojë konkurs të ri, i cili zgjati dy ditë dhe përmbyll të martën (16 gusht). Vendimi i Ministrisë së Mbrojtjes për të shpallur afat të dytë të regjistrimit për pranimin e kadetëve në Akademinë Ushtarake vjen pas denoncimit të gazetës KOHA për diskriminim të kandidatëve në procedurën e selektimit.

Duke i sqaruar masat e ndërmarra pas vërtetimit të shkeljeve dhe parregullsive në afatin e parë të regjistrimit, Ministria e Mbrojtjes sqaron se në datat 13 dhe 17 korrik, Inspektorati shtetëror i Arsimi ka realizuar inspektim të jashtëzakonshëm në dokumentacionin e kandidatëve të cilët kanë konkurruar në afatin e parë të regjistrimit (prej 4



deri 31 maj). "Me këtë rast është konstatuar se vetëm 13 kandidatë kanë dorëzuar dokumentacionin të kompletuar, i cili ka qenë në përputhje me kushtet e përgjithshme dhe ato të posaçme të parashtruara në konkurs. Për këto shkaqe, vetëm 5 kandidatë i kanë plotësuar kushtet e parapara, me çka të njëjtit janë pranuar si studentë/

kadet në ciklin parë të studimeve pranë Akademisë Ushtarake", thonë nga Ministria e Mbrojtjes.

Për dallim nga mënyra e mëhershme e realizimit të provimeve pranuese, mes tjerash, nga Ministria e Mbrojtjes, kanë theksuar se procedura e regjistrimit të kandidatëve në afatin e dytë në Akademinë Ushtarake, do

t'i nënshtrihen një procesi pjesërisht të ndryshuar, i cili do të realizohet në përputhje me ndryshimet e Rregullores për kushtet, kriteret, mënyrë dhe realizimin e konkursit pranues. Plotësimi apo ndryshime i kësaj Rregullore, siç thonë nga kjo ministri, parasheh që për dhjetë vendet e lira për të cilët është konkurruar, kandidatët fillimisht do t'i

nënshtrihen provimeve në matematikë dhe gjuhë angleze, gjegjësisht pas përfundimit të kësaj faze të njëjtit do të vazhdojnë me dhënien e provimeve psikofizike dhe kontrollit të gjendjes fizike të kandidatit. "Testimi i kandidatëve do të realizohet në mënyrë anonime, me qëllim të zvogëlimit të ndikimit dhe subjektivitetit në procedurë. Nga ana tjetër, testimet psikologjike do të bëhen me shkrim pranë Qendrës Ushtarake Mjekësore. Këtë testim do ta realizojnë psikologë nga shërbimi i Armatës dhe një anëtar i jashtëm nga Klinika e psikiatrisë. Ndryshmit e fundi të Rregullores janë kryer me qëllim të mënjanimin të parregullsive të theksuara, për precizim të përgjegjësive të të gjithë palëve të përfshira në procedurë dhe rritje të transparencës në procesin konkurrues", thonë mes tjerash nga Ministria e Drejtësisë.

Në fazën e parë të këtij konkursi, sipas të dhënave zyrtare të Akademisë Ushtarake, kishin konkurruar 84 kandidat. Hapja e pazakontë e

konkursit pranues në Akademinë Ushtarake, të cilën ish Ministri i Mbrojtjes, Zoran Jolevski, e publikoi në maj, në kohë kur procesi edukativo arsimor ende nuk kishte përfunduar, për ministren Radmilla Shëqerinska, ishte tregues i mjaftueshëm se një pjese të madhe të nxënësve u ishte cenuar drejta për të konkurruar. Problem shtesë ishte diskriminimi të cilin Komisioni psikiatrik në krye me mjekun Petre Ristevski, pa arsytim i refuzoi rreth dhjetë kandidatë, ndërsa më pas ministrja Shëqerinska, solli vendim që testimi psikiatrik edhe njëherë të përsëritet. Por, ngjashëm si herën e parë edhe kësaj radhe psikologu Ristevski i refuzoi kandidatët e dëmtuar, me arsytim se nuk kanë të drejtë t'i nënshtrihen testit psikiatrik pa kaluar gjashtë muaj nga testimi i parë. Ndërkohë, për gazetën KOHA, zëvendës Ministri i Mbrojtjes, Bekim Maksuti, në disa raste pat deklaruar se parimi i përfaqësimit të drejtë dhe adekuat i shqiptarëve në këtë konkurs do të respektohet.

## Qasje të barabartë për investitorët

Shkup, 16 gusht - Qasje të barabartë dhe politikë transparente për investitorët, paralajmëroi ministri i angazhuar për investime të huaja Adnan Qahil para anëtarëve të Odës Ekonomike Maqedonisë - Turqi (MATTO). Në seancën e Këshillit drejtues (KD) të MATTO-s Qahil informoi se Qeveria përgatit ndryshime lidhur me politikën investuese, por, siç tha, kjo nuk duhet t'i prekë investitorët e deritanishëm nëse procedurat në procesin e zhvillimit kanë qenë tërësisht legale. Qeveria, njoftoi Qahil, është përgatitur t'u ndihmojë investitorëve. Konsideron se marrëdhëniet me biznes bashkësinë mund të zhvillohen vetëm me dialog të vazhdueshëm. "Gjithsesi se do të ballafaqohemi me probleme dhe pengesa, por qëllimi ynë është që ta ndryshojmë dhe përmirësojmë sistemin midis firmave dhe organeve qeveritare. kaluan 20 vite nga debia ime e parë në Qeveri. Besoj se kam përvojë të mjaftueshme që të mund t'i shohë gabimet në punën e qeverisë paraprake", tha Qahil. Në seancën e KD të MATTO-s në të cilën, krahas ministrit Qahil morën pjesë edhe ministrja turke në Maqedoni Tylin Erkal Kara, si dhe udhëheqësi i përfaqësimit tregtar të Republikës së Turqisë Benjamin Kutlu, u prezantua Propozim-strategjia e politikës investuese që e paralajmëroi Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Sipas Kabinetit të ministrit Qahil, takimi ka qenë fillim efikas i dialogut dhe bashkëpunimit midis Qeverisë dhe investitorëve turq për avancim të klimës investuese në vend.

## Arrestohet Palevski, jozyrtarisht dyshohet për publikim të përgjimeve

Shkup, 16 gusht - Me urdhër të Prokurorisë Speciale Publike, të martën në Shkup është arrestuar Lupço Palevski, i cili sipas të dhënave jozyrtare dyshohet për lëshim të materialeve nga përgjimet e jashtëligjshme në rrjetin social "Youtube". Ministria e Punëve të Brendshme vetëm e ka konfirmuar lajmin se është arrestuar një person me iniciale L.P, mirëpo nuk kanë informacione shtesë, ndërsa mediat kanë raportuar se i dyshuari ka lidhje me një procedurë para hetimore të cilën e realizon PSP-ja. Pas arritjes së



Marrëveshje së Përzihos, e cila rezultojë me ndalimin e "bombave" nga opozita e atëhershme, në rrjetet sociale filluan të paraqiten audio materiale të bisedave të realizuara nga gazetar,

afaristë dhe politikanë. Në mesin e këtyre materialeve që opinionin më i gjerë pati mundësi t'i dëgjon, një pjesë të cilëve ende janë aktive në rrjetet sociale, drejtpërdrejtë prekën funksionarë të BDI-

së. Shumica e bisedave të publikuara, për të cilat thuhet se burojnë nga procesi i jashtëligjshëm i përgjimeve, ishin të natyrës intime dhe private, ndërsa personi që i ngarkonte në rrjetin social "Youtube", thirrej në pseudonimin "Nikolla Tesla", për të cilët mediat raportojnë se bëhet fjalë për Lupço Palevski. Palevski ishte kryetarë i degës së LSDM-së në vitet e 90-ta në Shkup dhe botues i gazetës "Start", ndërsa me ardhjen në pushtet të VMRO-DPMNE-së i njëjti u afrua me këtë parti. (O.XH)

## S'ka vendim për shtrenjtim të energjisë

Shkup, 16 gusht - Nuk ka vendim qeveritar për shtrenjtim të energjisë, njoftoi kabineti i zëvendëskryeminstri për çështje ekonomike Koço Angjushev. Në kumtesë, Kabineti i Angjushevit njofton edhe se Qeveria nuk vendos për çmimin e energjisë. Njëherit informon se ligji i ri për energjetikë tanimë po përgatitet, ndërsa qëllimi kyç

është mbrojtja e interesave të qytetarëve. Ligji është reformues, me të do të përmirësohet gjendja e përgjithshme e rregullimit të marrëdhënies në sektorin energjetik dhe qartë do të përcaktohen rregullat për furnizim të sigurt dhe cilësor konsumatorëve me energji. "Korniza e re ligjore përmban rregulla dhe reforma evropiane me të cilat Maqedonia

do të jetë në hap me rajonin dhe proceset reformuese me të cilët vonohet me vite. Bëhet fjalë për ligj reformues që do të harmonizohet me obligimet e ndërmarra nga Bashkësia energjetike evropiane për implementim të Pakos së tretë, që paraqet set i direktivave dhe rregullativave të Bashkimit Evropian. Afati deri kur duhej të implementohet

Pakoja e tretë ishte 1 janari i vitit 2015, ndërsa mosrespektimi i obligimeve të ndërmarra ishin arsye që Bashkësia energjetike evropiane të hapë kontest kundër Maqedonisë", njofton Kabineti i Angjushevit. Në kumtesë thuhet edhe se me implementimin e ligjit, Qeveria do ta kthejë Maqedoninë në trajektoren e liderëve në rajon në këtë sferë.





Qeveria ngarkon MPPS-në me obligime të reja

# Dy ndërrime në çerdhe dhe lokacione për kuzhina popullore

Qeveria e Maqedonisë e ka obliguar MPPS-në që ta informojë opinionin për propozimin që çerdhet për fëmijë të funksionojnë në ndërrime dhe të kërkojë mendim nga të gjitha palët e prekura për nevojën e zbatimit të dy ndërrimeve në çerdhet ditore



Shkup, 16 gusht – Qeveri në seancën e fundit ka shqyrtuar mundësinë e vendosjes së dy ndërrimeve në çerdhet e fëmijëve dhe të përcaktimit të lokacioneve për kuzhinat popullore në komunat e parapara. Përgjegjëse për realizim dhe mbikëqyrje të këtyre dy vendimeve do të jetë Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS). "Gjatë seancës është shqyrtuar mundësia e vendosjes së ndërrimit të dytë në çerdhet e Maqedonisë. Qeveria e Maqedonisë e ka obliguar MPPS-në që ta informojë opinionin për këtë propozim dhe të kërkojë mendim nga të gjitha palët e prekura për nevojën e zbatimit të dy ndërrimeve në çerdhet ditore",

thuhet në njoftimin e Qeverisë së Maqedonisë. Meqë Qeveria në këtë seancë diskutoi edhe për projektin "Hapja e kuzhinave popullore", për të njejtën sërish e angazhoi MPPS-në që të kryejë analiza dhe në bashkëpunim me komunat të caktojë hapësira të përshtatme për qasje sa më të lehtë të qytetarëve në këtë projekt. "Qeveria e shqyrtoi edhe progresin e projektit "Hapja e

kuzhinave popullore" për periudhën janar-qershor 2017 dhe të nxjerr përfundimet. Me anë të kësaj disa komuna janë të obliguara të ofrojnë kushte hapësinore për shpërndarje dhe transport të ushqimit dhe për këtë të informojnë MPPS-në në afat të paracaktuar kohor. Qeveria e Maqedonisë e obligoi MPPS-në që të kryejë analiza dhe të propozojë modele për përmirësim të funk-

sionimit të këtyre kuzhinave", thuhet ndër të tjerash në njoftimin e Qeverisë së Maqedonisë. Në këtë seancë, Qeveria e Maqedonisë shqyrtoi edhe mundësinë e largimit të vendimit për shkuarje të anëtarëve të Armatës së Maqedonisë për pjesëmarrje aktive në Hungari dhe Gjermani. Gjithashtu u rekomandua se ligji për energjetikë të jetë ndër ligjet prioritare.

## 15 të lënduar në përplasjen e dy autobusëve në Strumicë

Strumicë, 16 gusht - Pesëmbëdhjetë persona janë lënduar dje në një aksident rrugor në rrugën lokale në fshatin Bansko - fshati Murtino në të cilin kanë marrë pjesë dy autobusë, një automjet motorik në terren dhe një automobil. Nga Ministria e Punëve të Brendshme informojnë se janë përplasur autobusi "Van Holl" me targa të Shtipit, i drejtuar nga B.K. (62) nga Radovishi, autobusi "Neoplan" me targa të Shtipit i drejtuar nga Gj.J. (59) nga Gradsko Balldovci, automjeti motorik për terren "Opel Kombo" me targa të Strumicës i drejtuar nga M.M. (51) nga f.Radovo dhe automjeti i udhëtarëve "Opel Zafira" me targa të Strumicës, i drejtuar nga R.I. (26) nga f. Bansko. Lëndime të rënda trupore kanë marrë shoferi i automjetit për terren i cili është dërguar dhe mbajtur për mjekim në Qendrën mjekësore në Strumicë. Lëndime të lehta trupore ka marrë bashkudhëtarë i automjetit të udhëtarëve dhe 13 udhëtarë të autobusit "Van Holl" të cilët pas ndihmës së dhënë mjekësore në Qendrën mjekësore në Strumicë janë lëshuar për mjekim shtëpiak. Ekspertizë në vendin e ngjarjes ka kryer ekipi i SPB Strumicë.

Publicitet

# Koha

www.koha.mk  
E përditshme informative

## ÇMIMORE PËR PREZANTIM TË PAGUAR POLITIK ZGJEDHJET LOKALE 2017

Faqja e parë (color) 1 cm <sup>2</sup>	2 €
Faqja e fundit (color) 1 cm <sup>2</sup>	1 €
Faqja e brendshme (color) 1 cm <sup>2</sup>	0,8 €
Faqja e brendshme (bardhë e zi) 1 cm <sup>2</sup>	0,6 €
1/1 faqja e brendshme (bardhë e zi)	350 €
1/2 faqja e brendshme (bardhë e zi)	196 €
1/4 faqja e brendshme (bardhë e zi)	126 €
1/1 faqja e brendshme (color)	455 €
1/2 faqja e brendshme (color)	266 €
1/4 faqja e brendshme (color)	140 €
1/2 faqja e brendshme portret (bardhë e zi)	280 €
1/2 faqja e brendshme portret (color)	350 €

### Dimensionet

1/1	250 x 385 mm
1/2	250 x 190 mm
1/4	122 x 190 mm

Shërbime speciale: - kërkesa e veçantë për pozicionim të reklamës e rrit çmimin për 25%.  
Në çmim nuk është llogaritur TVSH-ja.







Kërkohet zgjidhje afatgjate për lidhjen me Kosovën



# Rruga Tetovë-Jazhincë s'i plotëson kushtet për autostradë

**Rruga Tetova-Jazhincë nuk i plotëson kushtet që të jetë autostradë, pasi që numri i qytetarëve që shkojnë për në Kosovë është diku rreth 1 mijë vetura në ditë dhe është jashtë çdo norme, sepse ky numër duhet të jetë rreth 10 mijë vetura mesatarisht në ditë, thotë profesori universitar Vullnet Palloshi**

Koha | Urim HASIPI

Tetovë, 16 gusht - Vite me radhë rruga rajonale Tetovë-Jazhincë, së bashku me rrugët e qytetit të Tetovës, autostradën Tetovë-Shkup dhe rrugët rajonale Tetovë-Pirok dhe Tetovë-Vollkoviçë, vazhdojnë të jenë mes e rrugëve më të rrezikshme. Kjo për shkak se në këto rrugë, në veçanti në rrugën Tetovë-Jazhincë, janë regjistruar shumë aksidente dhe në disa raste edhe me të vdekur. Arsyet më të shpeshta për numrin më të madh të aksidenteve në këto rrugë janë

mos përshtatja e shpejtësisë me kushtet e rrugës, gjegjësisht vozitja e shpejtë, mos respektimi i sinjalistikës rrugore, stërngarkimi i rrugës për shkak të rritjes së fluksit të automjeteve që qarkullojnë në këtë rrugë, sidomos në muajt e verës, por edhe për shkak të dëmtimit të rrugës në shumë pjesë të saj. Si rezultat në këtë rrugë rajonale janë regjistruar shumë dalje nga rruga, të cilat jo rrallë herë janë shoqëruar edhe me rrokullisjen e automjeteve, ndeshje, por ka pasur raste kur kanë pësuar edhe këmbësorët, ciklistët dhe motoçiklistët. Përveç kësaj aksidentet në këtë periudhë kohore kanë ndodhur edhe për shkak të veprimeve jo të ndërgjegjshme gjegjësisht të pahijshme, si parakalimet jo të rregullta, mos mbajtja e distancës dhe të ngjashme. Profesori universitar Vullnet Palloshi thotë se nuk ka mundësi që të ndërtohet autostradë e re por ajo ekzistuese të rikonstruohet dhe të ndërtohet një gjysmë unaze nga Tetova për në Komunën e Tearcës dhe Jeganocit. "Rruga Tetova-Jazhincë nuk i plotëson kushtet që të jetë autostradë, pasi që numri i qytetarëve që shkojnë për në Kosovë është

diku rreth 1 mijë vetura në ditë dhe është jashtë çdo norme, sepse ky numër duhet të jetë rreth 10 mijë vetura mesatarisht në ditë. Ajo rrugë nuk duhet të bëhet autostradë, është e mirë por këtu pjesa nga Tetova për në Poroj dhe Xhepcisht është e stërngarkuar dhe ideja ime ka qenë që ajo pjesë të ngel ashtu siç ka qenë sepse ajo rrugë është nëpër vendbanime dhe nuk është rrugë transite dhe unë dhashë propozim por nuk u pranua nga askush që të jetë pjesë e programeve qeveritare që të bëhet një unazë apo një krah prej hyrjes së Tetovës deri në territorin e Komunës së Tearcës. Pra ajo pjesë që është e stërngarkuar apo edhe ku ndodhin aksidente të kalohet me një krah dhe do të lehtësohet rruga nga frekuentimi i madh. Kjo do të bënte që për 30 për qind të zvogëlohet numri i automjeteve në komunikacion dhe automatikisht do të zvogëlohet komunikacioni dhe do të pastrohet ajri sidomos më pak do të kemi automjete të rënda në pjesën aktuale të kësaj rruge", deklaroi Palloshi. Banorët e fshatrave të Porojit dhe Xhepcishtit që gravitojnë përkaj kësaj rruge janë të ndarë në mendimet e tyre për

gjetjen e një zgjidhje më të mirë dhe afatgjate me qëllim evitimin e aksidenteve me pasoja tragjike. Disa thonë se zgjidhja më e mirë do të ishte hapja e një rruge alternative që do kontribuonte në shkarkimin e komunikacionit në këtë pjesë të rrugës, disa të tjerë theksojnë se nevojitet që pjesëtarë të policisë të kryejnë patrullime më të shpeshta me qëllim që të vendoset një rend i mirëfilltë në komunikacion, të tjerë mendojnë se rekonstruimi i rrugës një zgjidhje poashtu e mirë dhe jo hapja e një rruge të re për shkak se hapja e një rruge tjetër alternative do të nënkuptonte humbje të mëdha për bizneset. Ndërkaq, Palloshi thotë se kur ka ideja të mira ata nuk merren parasysh nga ana e autoriteteve dhe këta projekte duhet fillimisht të përpilohen nga ana e autoriteteve lokale në letër, me qëllim që më pas të adresohen tek qeveria. Ai theksoi se nëse vet pushtetet lokale nuk përpilojnë projekte të mëdha vështirë se qeveria do të ndërtojë sepse nëse ka një plan apo projekt atëherë është më lehtë që të kërkohen mjetet dhe të fillohet realizimi, por nëse nuk ekzistojnë fare atëherë fillimi është shumë më i vështirë.

## "Qyteti i Shkupit të mos e financojë Rrotën Panoramike"



Shkup, 16 gusht - Grupi i deputetëve të LSDM-së dhe koalicioni në Këshillin e Qytetit të Shkupit e kundërshtojnë tentimin e autoriteteve të qytetit të cilën e ndërton NTP Shkup. Këtë sot e deklaroi Dragi Davçevski, koordinator i grupit të deputetëve të LSDM-së dhe koalicionit në Këshillin e Qytetit të Shkupit. "Në kushte kur buxheti i Qytetit të Shkupit për periudhën prej gjashtë muajt e parë ka realizuar nën 30 për qind me ribalancin rriten mjetet për këtë ndërtim joproduktiv.

Kjo bëhet përmes modelit për subvencione të cilat jepen si mjete të NTP Shkup për të a.q. vështirësi në punë, ndërsa në realitet bëhet fjalë për mbulim të shpenzimeve nga ndërtimi i Rrotës Panoramike", theksoi Davçevski. Në këtë mënyrë, siç tha, NTP Shkup do të marrë subvencione prej 3,5 milionë euro, jo për sanksionimin e vështirësive në transportin publik, por për Rrotën Panoramike për të cilën kishin propozim të arsyeshëm për stopimin dhe konservimin e saj.

## Postës i kërkohet t'i ulë shpenzimet joproduktive

Shkup, 16 gusht - SHA për qarkullim postar Posta e Maqedonisë Shkup duhet që të përgatitë program për uljen e shpenzimeve joproduktive dhe në një afat prej dy muajve t'ia parashtrijë Qeverisë. Kjo u vendos në seancën e qeverisë, në të cilën u diskutua dhe u miratua Raporti për punë financiare i NP HM Infrastrukturë, si dhe llogaria vjetore, d.m.th. Raporti financiar dhe Raporti për punën për vitin 2016 të SHA për qarkullim postar -Posta e Maqedonisë-Shkup. Me vendimin

qeveritar miratohen llogaritë vjetore për punën financiare të dy ndërmarrjeve publike dhe raporti financiar, njoftoi pres shërbimi i Qeverisë. Qeveria e ka shqyrtuar edhe punën financiare të Ndërmarrjes Publike për Rrugët Shtetërore për periudhën janar-mars të këtij viti. NPRSH-së, me vendim të Qeverisë, i është urdhëruar që të përcaktojë një organ mbikëqyrës dhe afate në të cilat do të kryhet kontroll mbi punët e bëra nga kompanitë e ndërtimit", thuhet në njoftim

## Nga e hëna ulje e konsiderueshme e temperaturës

Shkup, 16 gusht - Paraqitje lokale e vranësirave jostabile me shi afatshkurtër dhe bubullima të rralla, priten në ditët në

vazhdim, paralajmëron DPHM. Deri të shtunën moti do të jetë kryesisht stabil dhe i ngrohtë, deri në 38 gradë Celsius në

juglindje të vendit. Por, të dielën nga fundi i ditës do të ketë shi lokal të rrëmbyeshëm me bubullima, ndërsa të hënë pritet mot

me vranësira me reshje më të mëdha të shiut, erë të forcuar dhe ulje e konsiderueshme e temperaturës së ditës.

## Humbim 20 për qind nga mosdeponimi adekuat i prodhimtarisë bujqësore

Shkup, 16 gusht - Deri në 20 për qind në vit arrijnë humbjet në bujqësinë e Maqedonisë për shkak të deponimit joadekuat, tregton analiza e fundit e "Koalicionit rural". Në korniza botërore, ky lloj i humbjes në agro biznes

lëviz prej pesë deri në 10 për qind. "Çdo vit një pjesë e madhe e prodhimtarisë bujqësore të Maqedonisë dështon për shkak të ruajtjes jo të duhur, në depo të improvizuara të cilat janë nën ndikimin e kushteve të motit. Kjo

është një prej arsyeve që i ofrojnë fermerët për të kryer shitje të prodhimeve me çmime shumë të ulëta ose t'i hedhin ato", qëndron në analizë. Ruajtja jo adekuate e prodhimtarisë e zvogëlon cilësinë për çka edhe çmimi zvogëlohet.

"Ky problem ende është një prej më të rëndësishmëve për bujqësinë e Maqedonisë dhe më së shumti i prek prodhuesit e mollëve, pjeshkëve, dardhave, rrushit, domateve, patateve", thekson "Koalicioni rural".





Gjithsesi ka pasur pëshpëritje përreth Kremlinit, se dikush kishte hyrë në dhomën e Stalinit edhe para orën 10 të darkës, duke e parë shtrirë dhe i vendosur për të mos bërë zë deri kur të zhdukej çdo mundësi për ta shpëtuar

A ishte Stalini duke komplotuar një luftë të re botërore? Dhe a ishte "Komploti i Mjekëve" një farë preludi i saj? Nëse kjo teori joserioze konspiracioni, qe në fakt pjellë e imagjinatës së Stalinit - çka me siguri nuk do të ishte habitshme, çfarë ishte duke u përpjekur të bënte me të? Historianët japin mendime të ndryshme...

# "KOMPLOTI I MJEKËVE" Spastrimi i fundit i Stalinit

Në 13 janar të vitit 1953, gazeta zyrtare e Partisë Komuniste Sovjetike "Pravda", raportoi një zhvillim shpërthyes: disa mjekë në Moskë qenë arrestuar nga autoritetet shtetërore të sigurisë, duke u akuzuar se ishin përpjekur të vrisnin krerët më të lartë të Bashkimit Sovjetik, me anë të neglizhencës së qëllim të mjekësore. Komploti i mjekëve "të ligj", supozohej se ishte "organizuar nga inteligjenca amerikane" dhe të rekrutuar nga anëtarët e një komisioni famëkeq anti-fashist, që dyshohej se kishte motive të fshehta. Megjithatë, shumica e mjekëve të akuzuar ishin hebrej, dhe komiteti nga i cili ata erdhën ishte një organizatë sioniste. "Pravda" ndërkohë përmendi Komitetin e Përbashkët të Shpërndarjes, një organizatë hebraike me seli në Nju York, si një nga organet që qëndronte prapa komplotit të ndyrë. Gazeta e përmbyllte analizën e saj, duke pretenduar se hebrejtë ishin duke u përpjekur që të shkatërronin Atdehur Socialist. Historia e çuditshme e "Komplotit të Mjekëve", fillon në maj të vitit 1945, menjëherë pas fitores së Bashkimit Sovjetik ndaj Gjermanisë, në fund të Luftës së Dytë Botërore. Një zyrtar dhe shkrimtar i njohur sovjetik, Aleksander Shtetëror, për të cilin disa thoshin se pinte shumë, pësoi infarkt në zemër dhe vdiq në një spital të Moskës.

Tre vjet më vonë, në gusht të vitit 1948, një tjetër figurë e lartë sovjetike, Andrei Zhdanov, edhe ai shumë i dhënë pas alkoolit, vdiq në të njëjtat rrethana. Në të dyja rastet, mjekët e Kremlinit i trajtonin pacientët duke u konsultuar me një mjek hebre të quajtur Jakov Etinger. Në vjeshtën e vitit 1951 një zyrtar i Ministrisë së Sigurimit Shtetëror (MGB) rimajt Shtetëror (MGB) i quajtur Mikhael Rjumin i shkroi një letër eprorit të tij, Abakumov, duke pretenduar se Doktor Etinger kishte vrarë si Sherbakov, ashtu edhe Zhdanov, duke u shkakuar në mënyrë artificiale atakun kardiak. Abakumov nuk e besoi këtë histori, por gjithsesi Doktor Etingeri u arrestua. Nëse ai ishte i pafajshëm, nuk pati kurrë shansin për t'ia treguar MGB: vdiq pasi u torturua, një natë para se të merrej në pyetje nga vetë Abakumov. Shumë shpejt, dolën në sipërfaqe me shumë akuza për neglizhencë të qëllimshme nga ana e mjekëve.



Edhe pse thajse me siguri të nxitura nga shefat e MGB-së, në kërkim të një komploti për të rritur reputacionin e tyre në sytë e shefit të madh, Josif Stalinit, disa prej tyre mund të kenë pasur një grimë të vogël të vërtete. Ishte e mundur që Zhdanovi të kishte vdekur si pasojë e neglizhencës mjekësore, me mjekët e tjerë të Kremlinit që i dhanë kurën e gabuar, dhe më pas u përpoqën që ta mbulojnë atë, për të shmangur ndëshkimin. Në çdo rast, MGB u investua shumë në skenarin e qëllimeve të liga të mjekëve me origjinë hebreje, dhe që mund të lidhej me axhendat sioniste qoftë reale, apo të imagjinuara. Arrestimet

filluan që në shtator të vitit 1952, në fillim me mjekë jo-hebrej, por pastaj kryesisht hebrej. Përfundimisht qindra njerëz u mblodhën nga MGB, dhe nën tortura dhanë "rrëfimet" që implikonin të tjerët. MGB ishte nxitur në përpjekjet e saj nga Stalini, i cili kërkoi të merrin masa më të mëdha për të zbuluar komplotin. Por a kishte patur ndonjëherë ndonjë komplot? Ndoshta jo, por kjo pa dyshim nuk do të kishte rëndësi për Stalinin. Në fakt "Komploti i Mjekëve", ngjante si një zgjerim i valës së terrorit që pasoi i vrarjes në dhjetor të vitit 1934 të Sergei Kirovit, një vrasje që përfundimisht u bë një justifikim

për Stalinin për spastrimin e Partisë Komuniste, ushtrinë dhe shoqërisë së gjerë sovjetike që ai mendonte se (ose mund të ishte duke menduar) se e kundërshtonte atë. Ndoshta vetë Stalini e porositi vrasjen e Kirovit. Nëse ai në mënyrë aktive nxiti histerinë e MGB-së mbi "Komplotin e Mjekëve", këtë herë ai nuk shqetësohet për organizimin e një atentati; vdekjet natyrore - shkaku i Sherbakov dhe Zhdanov ishin thjesht shumë më të mira si justifikime, dhe për sa kohë që një mjek hebre apo sionist mund të ishte i lidhur me ato raste, çdo gjë funksiononte mirë. A ishte Stalini duke komplotuar një luftë të re botërore? Dhe a ishte "Komploti i Mjekëve" një farë preludi i saj? Ne nuk do të dimë dot kurrë. Nëse kjo teori joserioze konspiracioni, qe në fakt një pjellë e imagjinatës së Stalinit - çka me siguri nuk do të ishte habitshme, çfarë ishte duke u përpjekur të bënte me të? Historianët japin mendime të ndryshme, por ideja se ai ishte duke planifikuar një sërë spastrimesh masive, si ato të viteve '30, është e vështirë për t'u shpërfillur. Teksa Lufta e Dytë Botërore po afrohej, Stalini shkatërroi të gjithë

ata që ndoshta mund të ishin një kërcënim për të, duke e lënë vendin krejtësisht të varur nga udhëheqja e tij për mbijetesë, kur Bashkimi Sovjetik (sikundër ndoshta e parashikoi edhe Stalini) u sulmua nga Gjermania. Në vitet e fundit të Stalinit, ka disa prova se një Luftë e Tretë Botërore, këtë herë kundër Shteteve të Bashkuara, ishte pjesë e planeve të tij afatgjata. Nëse kjo është e vërtetë, ai mund të ketë menduar se kishte nevojë për më shumë spastrime, dhe sidomos të udhëheqësve politikë dhe ushtarakë me përvojë që e kishin ndihmuar atë të fitonte Luftën e Dytë Botërore, duke e lënë vendin krejtësisht në mëshirë e tij nëse shpërthen të ndonjë luftë tjetër. Megjithatë, një pyetje e madhe, është se pse Stalini zgjodhi të gosadë hebrejtë. Feja u anulua zyrtarisht në Rusi pas Revolucionit të vitit 1917, por hebrejtë si një pakicë etnike dhe kulturore mbetën një segment i rëndësishëm të jetës sovjetike, edhe pas numrit të madh të viktimave që shkaktoi Holokausti i Hitlerit në rajonet e Bashkimit Sovjetik, të cilat ranë nën pushtimin gjerman. Është e mundur që "Komploti i Mjekëve" të ishte një justifikim për pastrim etnik, por është gjithashtu e mundur të qe një provë besnikërie. Një letër u gjet në mesin e dokumenteve të Stalinit, në të cilën i kërkohej shumë udhëheqësve hebrej në BRSS të deklaratonin besnikërinë e tyre ndaj shtetit dhe të denonconin mjekët e ligj që ishin pjesë e komplotit. Letra nuk u publikua për shkak të vdekjes së Stalinit. Në qoftë se ajo do të ishte shndërruar në një politikë konkrete, e gjitha kjo mund të ishte një dredhi për të trembur hebrejtë sovjetike dhe nënshtrimin ndaj sundimit të Stalinit, duke dobësuar besnikërinë e tyre ndaj kauzës Sioniste e cilat është parë në BRSS, si e papranueshme pro-perëndimore dhe imperialiste.

"Komploti i Mjekëve" rezultoi i rremë, por ironikisht Stalini mund të ketë vdekur si rezultat i një të komploti të vërtetë, ose i diçkaje të përafërt. Mbrëmjen e 1 marsit 1953, 6 javë pas shpalljes në "Pravda" të konspiracionit, dhe ndërsa shumë prej komplotuesve të akuzuar ishin ende në paraburgim, Stalini shkoi në shtrat në daçan e tij jashtë Moskës, pasi kishte shumë dhe parë një film në shoqërinë e servilëve të tij të ndry-

(StoriaIn)





Pijaneci u bë i famshëm në një ditë të vetme. Ngjarja e fortesës së Delsonit e bëri hero kombëtar. Veriu do ta bënte atë heroin e vet dhe do ta përkëdhelte me një nofkë aq mikluese sa Granti do të bëhej i pavdekshëm për historinë amerikane. Kur komandanti i Fortesës Delson e pyeti se ç'kushte do t'i jepeshin Konfederatës, Granti u përgjigj pa hezituar: "Kapitullim pa ushte (unconditional surrender) është e vetmja e pranueshme!"

Nga Xherardo NIKJARI

Një herë gjatë Luftës Civile Amerikane, dukish i tha presidentit Abraham Linkoln se njëri nga gjeneralët etij, Uliks.S. Granti (1822-1885), kishte probleme me pijen. "Zbuloni çfarë marke pi-tha presidenti-dhe dërgojuani ca edhe gjeneralëve të tjerë". Në teatrin e rëndësishëm luftarak të Lindjes, ku zinin luftimet vetëm pak milje larg Uashingtonit dhe kryeqytetit të Konfederatës, Riçmondit, Linkoln kishte nëpër këmbë gjeneralë të cilët ose ishin më të kujdesshëm se ç'duhej, ose tepër guximtarë, se thjesht frikacakë. Granti ishte një lloj i veçantë ushtaraku jo vetëm në historinë amerikane por edhe atë ushtarake botërore, ai fitonte beteja dhe, uiski ia shtonte dellin e fitores, Linkoln do t'i dërgonte fuçi të tëra. Më në fund, Linkoln kishte gjetur dikë që të fitonte luftën më të përgjakshme në historinë e Amerikës. (Shënim: Gjatë Luftës civile u vranë më shumë amerikanë se sa në Luftën e Dytë Botërore, në Luftën e Parë Botërore, Luftën e Vietnamit, Luftën e Koresë së bashku.)

Por kur kjo luftë pati filluar, Uliks Simpson Grant nuk dukej fare si fitimtar. Ndonëse ishte diplomuar në një shkollat më të mira ushtarake, West Point, dhe kishte shërbyer shkëlqyeshëm në Luftën e Mekikës dhe pas kësaj Granti kishte dhënë dorëheqjen nga detyra, dhe e pati të vështirë të kthehej sërish në ushtri. Përveç shërbimit në Meksikë, e gjithë karriera e Grantit kishte qenë një varg gabimesh. Ai ishte pagëzuar me emrin Hiram Uliks Grant. Granti nuk i pëlqenin inicialet e veta, H.U, dhe u përpoq t'i ndryshonte. Mirëpo kur shkoi në Ëest Point, në 1832 zbuloi se kongresisti që e sponsorizonte e kishte regjistruar me emrin Uliks Simpson (emrin e vajzërisë së të ëmës) Grant. Në akademinë ushtarake ai vërtetoi se ishte një kalorës i jashtëzakonshëm, por një student indiferent (përveç matematikës). U diplomua i 21-ti në një klasë me 39 veta. Në Meksikë, ai shërbeu si nëntoger i Zakari Tejlorit (presidenti i 12-të, duhanpirës i pashoq). Granti mori gradën e nde-

# ULIKS S. GRANT



• Granti me familjen, 1870



• Grant duke punuar me kujtimet e tij, një muaj para se të ndërronte jetë. Granti si president, 1869

## Pijaneci më i suksesshëm në historinë amerikane që u bë i famshëm në një ditë të vetme...



• Pas presidencës, Granti udhëtoi dy vjet nëpër botë me të shoqen.



• Uliks S. Grant si Kryekomandant i ushtrisë së Unionit.

rit toger për trimëri në betejën e Molino del Reit dhe më vonë u gradua kapiten e toger i parë në ushtrinë e rregullt. Pas luftës ai u martua. U vendos në disa baza ushtarake të zymta, në Perëndim, ku e shoqja nuk mund të shkonte. Nisi të pinte. Karriera do t'i ndërprehej brutalisht pasi dashuria për uiskin e çoi në dorëheqje në 1854, përndryshe do të dilte para gjyqit për dehe. Në jetën civile ai provoi pa sukses një numër biznesesh, por dështoi tek të gjitha. Më në fund, i ati i prekur shumë, i dha një vend pune në ndërmarrjen e vet të lëkurëve në Illinois. I martuar, baba i shumë fëmijëve, Uliksi kishte vërtet shumë nevojë për këtë punë. Por jeta nuk do t'i sillte gëzim. Ai s'kishte më

miq dhe jetonte i mbyllur në vetvete në vetmi. Atë e gjeje "të pakënaqur, si një njeri të vogël që nuk arrinte të kujdesej as për veten". Shpërthimi i Luftës Civile Amerika nxiti një kërkesë të madhe për fuqi njerëzore. Granti, një veteran i dekoduar i luftës së fundit, u përpoq ta rifitonte detyrën, por ushtria nuk ishte e interesuar. Kështu, ai organizoi dhe stërviti një kompani vullnetare për shtetin e Illinoisit. Dy muaj pas kthimit nga lufta, Granti u gradua gjeneral brigade dhe mori komandën e distriktin të Misourit Juglindor. I pavlerësuar dhe i nënvlehtësuar, gjithçka do të ndryshonte një ditë më vonë. Ashtu si Bajroni, Granti u zgjua një mëngjes të bukur dhe e gjeti veten të famshëm.

Ai tërhoqi vëmendjen e Linkolnit dhe të oficerëve të lartë me koordinimin e shkëlqyer që i bëri ushtrisë dhe njësisë të marinës gjatë luftimeve të ashpër pranë fortesave Henri dhe Delson në 1862. Granti, i zënë në befasi nga ushtarët e Konfederatës, ai nuk u tremb, por talenti i tij ushtarak i solli fitoren e plotë mbi një ushtri të madhe jugore. Deri në atë kohë, Granti ishte i panjohur, pijaneci u bë i famshëm në një ditë të vetme. Ngjarja e fortesës së Delsonit e bëri hero kombëtar. Veriu do ta bënte atë heroin e vet dhe do ta përkëdhelte me një nofkë aq mikluese sa Granti do të bëhej i pavdekshëm për historinë amerikane. Kur komandanti i Fortesës Delson e pyeti se ç'kushte do t'i jepe-

shin Konfederatës, Granti u përgjigj pa hezituar: "Kapitullim pa ushte (unconditional surrender) është e vetmja e pranueshme!". Që nga ajo ditë, ai u quajt "ënkondishënjell sërëndër Grant". Fitorja nuk i solli vetëm famë por edhe ngritje në detyrë. Granti mori gradën e kryekomandantit të trupave në perëndim. Kryevepra e tij strategjike dhe taktike ishte pushtimi i Viksburgut, që e arriti duke i ngatërruar ushtarët e Konfederatës me manovra e tij dhe duke përçarë dy ushtritë e tyre. Rënia e Viksburgut e ndau Konfederatën në dysh. Por Granti zbuloi menjëherë se sukcesi dhe lavdia ngjallnin njëkohësisht urrejtjen. Kolegët e ushtrisë e kritikonin ashpër, e akuzonin se rrezikonte shpeshherë jetën e njerëzve të vet. Atë e përshkruanin hapur si më të keqin e pijanecëve. Pavarësisht nga këto presidenti nuk i kushtonte fare vëmendje këtyre thashethemeve: "Nuk mund të heq dorë nga ky njeri. Ai lufton". Në mars të vitit 1864, Presidenti Abraham Linkoln e bëri Grantin Komandant të Përgjithshëm të Ushtrisë Amerikane. Granti pasi iu ngarkuan të gjitha trupat e Shteteve të Bashkuara u transferua për në frontin e lindjes. Atje, Granti demostroi aftësinë e tij për të dalluar talente ushtarake - një aftësi që i mungonte tërësisht Shtabit të Lartë. Ai luftoi me trimëri dhe me një gjeneralitet brilant ushtarak

për pjesën tjetër të mbetur të luftës civile. Më vonë (me përfundimin e luftës), Uliks S. Grant u bë president i Shteteve të Bashkuara. Mirëpo njeriu që kishte vërtetuar se ishte ekspert në fushën ushtarake, në jetën civile ndihej i pasigurt. Pavarësisht faktit se gjatë mandatit të tij si president mblodhi rreth vetes një grup të çuditshëm me gjeneralë nga ish-Konfederata dhe Unioni, populli e pëlqente shumë aq shumë Grantin sa që e zgjodhi për një mandat të dytë. Presidencia e tij ishte e shoqëruar nga paaftësia e Grantit për politikën si dhe skandale të shumta korrupsioni, si ishte episodi i "Black Friday" (1869), "Credit Mobilier" (1873) dhe normalisht skandali i uiskit (1872). Uliks Simpson Granti ishte një strateg efektiv, vullneti dhe vendosmëria e tij së bashku me aftësinë për të mësuar nga gabimet e bënë një gjeneral të dorës së parë; performanca e tij e dobët si politikan dhe biznesmen është vetëm fali i besimit të tij të tepërt tek miqtë e vet. Pas largimit nga posti, ai rifilloi jo vetëm të pinte deri në dehe uiski nostalgjik por edhe rifilloi karrierën shkatërrimtare në biznesin privat. Investimet e pamatura e lanë trokë. Për t'u kujdesur për familjen (ndërsa po vdiste nga kanceri i fytyrës) ai shkroi "Kujtimet", që u bë një bestseller. E përfundoi librin katër ditë para se të vdiste, 1885.





Daniel T. BLUMSTEIN

# Leksione politike nga mbretëria e kafshëve

Pavarësisht nga gënjeshttrat që shesin disa politikanë, faktet ende kanë rëndësi dhe përcjellja e duhur e këtyre fakteve është thelbësore për mbijetesën. Unë e di, sepse shoh rregullisht pasojat vdekjeprurëse të shitjes së fakteve të gabuara. Unë jam një ekolog i sjelljes dhe studioj se si kafshët vlerësojnë dhe menaxhojnë rrezikun prej grabitqarëve. Por, në vend që të studioj grabitqarët flakëruar - me dhembët e tyre të mprehtë, që afrohen me shpejtësi rrufe dhe aftësitë mbresëlënëse të sprintit - unë përqendrohem në ushqimin e tyre. Disa kangurë të vegjël i përdorin keq faktet. Shumë shpesh, këta meze me katër këmbë injorojnë informacionin që kanë mu përpara tyre - si shushurima prapa një shkurreje, ose aroma e një mishngrënësi kalimtar. Dhe ata e paguajnë shtrëngimin e fortë të një nofulle të fuqishme. Por kërkimet e mia kanë treguar se shumë kafshë që shndërrohen në vakte -

**Për njerëzimin, imitimi i kangurit naiv dhe thjesht injorimi i shushurimës në shkurre, nuk është mënyrë për të shmangur vrasjen. Përkundrazi, kjo është një recetë e sigurt për shfarosje**

marmotë, zogj, hardhuca, peshq dhe jovvertebrorë detarë - janë më të aftë në vlerësimin e rrezikut. Në vitin 1979, ekologët Richard Dawkins dhe John Krebs propozuan "parimin e jetës-darkë", i cili thotë se preja, e cila ka më shumë për të humbur se sa grabitqarët, është më kreative kur vjen fjala tek mbijetesa. Rreziku për t'u ngrënë - dhe si pasojë, për t'u larguar nga pishina e gjeneve - siguron një stimull të fortë për të rritur aftësitë e mbijetesës. Për grabitqarin, e vetmja pasojë e dështimit është që të mbetet i uritur deri në vaktin e ardhshëm.

Ne e shohim parimin e jetës-darkë në punë, kudo përreth nesh. Kur pulëbardhat ose rosat dynden së bashku, tekta një qen vrapon nëpër një plazh a një pellg, kjo ndodh për shkak se zogjtë e kuptojnë se ka siguri tek numrat. Njerëzit bëjnë të njëjtën gjë. Ne ndjehemi shumë më të shqetësuar, për shembull, kur dalim të vetëm për sërë, sepse e dimë se, në rastin kur një peshkaqen vendos që të na bëjë vaktin e tij, shanset tona për mbijetesë rriten, kur peshkaqeni ka më shumë se një objektiv për të zgjedhur. Njerëzit, ashtu si kafshët, kanë nevojë për të dhëna të besueshme dhe të vërteta, që të marrin vendime të mira. Një herë, duke studiuar marmotat në vargmalin Karakoram mes Kinës dhe Pakistanit, mungesa e fakteve pothuajse më vrau. Një stuhi katastrofike dhe rrëshqitjet e tokës që erdhën si pasojë, kishin shkëpu-

tur të gjitha hyrjet dhe daljet në zonën time të studimit, duke më çorientuar tekta kërkjoja të largohesha. Ndërsa kushtet u përkeqësuan, ishte e pamundur të krijohesh një strategji daljeje. Për shkak se isha duke luftuar tifon dhe kisha shumë pajisje kërkimore me vete, thjesht nuk kisha energji për të ecur milje të tëra, nëpër shkëmbinj dhe baltë. Vetëm disa ditë më vonë, kur rreziku kaloi dhe më në fund mund të largohesha nga zona, e kuptova se sa i padobishëm ishte në të vërtetë, informacioni i disponueshëm, për rrugët dhe rrugëdaljet alternative që kisha përdorur deri atëherë. Ndërsa çdo shkencëtar me respekt për veten duhet të vërë në pikëpyetje gjithçka dhe të jetë kritik ndaj urtësisë tradicionale, është e mundur të bëhen parashikime, të kryhen eksperimente për mbledhjen e të dhënave

dhe, pas analizimit të këtyre të dhënave, të nxirren përfundime që mbështesin ose hedhin poshtë parashikimin fillestar. Ne mësojmë - dhe shkenca përparon - duke sfiduar vazhdimisht supozimet me informacione të freskëta dhe faktike. Në këtë mënyrë, ne i provojmë dhe i rregullojmë idetë tona, deri sa të mbërrijmë me një përfundim, që nuk mund të refuzohet lehtësisht. Ne e quajmë këtë, "të vërtetën tonë të zbuluar". Por e vërteta e zbuluar shkencore është gjithmonë subjekt i analizave të reja, shqyrtimit të ri dhe interpretimeve të reja. Gjithnjë konsiderohet si e përkohshme - domethënë, i nënshtrohet falsifikimit të mëvonshëm - në vend që të bëhet një dogmë e pranuar plotësisht. Kur shkencëtarët dhe publiku në përgjithësi hedhin poshtë hipoteza të mbështetura mirë, duke cituar të ashtuquajturat fakte alternative, të mbës-

shtetura nga asgjë më shumë se emocionet ose bindjet personale (post-truth, në të folurën politike), ne injorojmë një mundësi të rëndësishme për të forcuar analizën tonë. Kur ne hedhim poshtë artikujt e vërtetuar në burime lajmesh me reputacion, duke i quajtur "lajme të rreme", ne nuk arrijmë të përdorim provat, për të mbështetur konkluzionet tona. Në politikë ashtu si në shkencë, kur hedhim poshtë të vërtetën e zbuluar, rrisim gjasat për rezultate katastrofike. Njerëzit kanë mbijetuar, sepse paraardhësit e tyre të lashtë, i kanë marrë faktet si duhet, ashtu si pulëbardhat që bëhen bashkë nën kërcënimin e rrezikut. Në të gjitha aspektet e jetës duhet të insistojmë në një proces shkencor që i bazon vendimet e marra, në vrojtimet e grumbulluara. Nëse dhe kur ka dëshmi të mjaftueshme për të mbështetur një përfundim të caktuar, ne duhet ta pranojmë atë. Në vazhdimësi, analiza vetëkritike është thelbësore, por vetëm nëse paraqiten ide të reja, prova të reja ose metoda të reja eksperimentale. Për njerëzimin, imitimi i kangurit naiv dhe thjesht injorimi i shushurimës në shkurre, nuk është mënyrë për të shmangur vrasjen. Përkundrazi, kjo është një recetë e sigurt për shfarosje. (bota.al)

## Kush do të marshonte me Trumpin në luftë?



Matthias DEMBINSKI

Bota po mban frymën për shkak të skenarit kërcënues të luftës - Koreja e Veriut synon të sulmojë me raketa ishullin e Paqësorit, Guam, ku SHBA ka bazën e saj ushtarake. Sipas toneve luftarake nga Pheniani raketa megjithatë do të fundoset në det, 30-40 kilometra para Guamit, që do të thotë ajo bie në det pak para ujërave të kontrolluara nga amerikanët. Kështu SHBA-të politikisht nuk do të ishin të detyruara të reagonin me kundërsulm. Por frika nga shkallëzimi i situatës mbetet: Edhe nëse Koreja e Veriut godet në afërsi, presidenti amerikan mund të ndjehet i provokuar e të reagojë si edhe u shpreh me "zjarr e zemërim". Por mund të ndodhë që raketa koreanoveriore pa dashur të godasë ujërat territoriale amerikane. Ajo që dihet është, nëse fillon

**Retorika mes Uashingtonit dhe Phenianit po ashpërsohet gjithnjë e më shumë. Rreziku i luftës po shtohet, gjë që mund të detyrojë shtetet e NATO-s për angazhim brenda aleancës. Skenarët e mundshëm:**

një luftë në Gadishullin Korean, kjo do të prekë të gjithë bashkësinë ndërkombëtare. 1. Janë të detyruara shtetet e NATO-s për të ofruar ndihmë në kuadër të aleancës? Për anëtarët e aleancës vlen parimi: Nëse kryhet një sulm i armatosur ndaj një aleati, ky shihet si sulm ndaj të gjithëve. Këtë e kërkon neni 5 i Marrëveshjes së Aleancës së Atlantikut Verior. Por neni 6 e kufizon këtë, vetëm për sulme ndaj territorit shtetëror të një shteti evropian, atlantikoverior të NATO-s, apo "ndaj një ishulli ku njëra palë ka të drejtat territoriale në zonën atlantikoveriore e në veri të tropikut të gaforres (Tropiku i Veriut, shën.red)". Kjo klauzolë e përjashton ishullin Guam që ndodhet shumë më



tepër në jug. Megjithatë nga qarqet e NATO-s bëhet e ditur, se aleatët nuk ndjehen të kufizuar nga kjo klauzolë dhe se do të mbështesin SHBA-të. 2. Si do të ofrohej mbështetja? Mbështetje në kuadër të NATO-s nuk do të thotë, se aleatët do të dërgojnë të gjithë anije luftarake në drejtim të Paqësorit Jugor, në rast se Guami sulmohet. Politologu Matthias Dembinski nga Fondacioni i Hesenit për Studimet e Paqes dhe Konfliktëve, thotë se megjithatë „ato e peshojnë

vetë, se si do ta ofrojnë këtë mbështetje." Me vështrim nga Gjermania, politologu thotë, se "ne do të ofronim ndihmë diplomatike, solidaritet, por jo ndihmë ushtarake". 3. Po Britania e Madhe? Qeveria në Londër prej kohësh zhvillon me SHBA një „marrëdhënie speciale", një partneritet të veçantë, që ka bërë që trupat britanike të nisen bashkë për luftë me trupat amerikane, si në vitin 2001 në krah të presidentit Bush, kur nisi lufta e Irakut. Megjithatë Dem-

binski nuk beson se Britania e Madhe do t'i dilte krah SHBA-së nëse sulmohet Guami. Ky vend nuk është më në këtë rajon prezent si më parë nga ana e politikës së sigurisë, thotë eksperti. 4. Kush mund ta mbështeste SHBA ushtarakisht? Megjithëse sulmi koreanoverior ndaj Guamit është hipotetik, Australia siguroi ndërkohë Shtetet e Bashkuara për mbështetjen e saj. Kryeministri Malcolm Turnbull u shpreh se këtë e parasheh si të detyrueshëm Pakti i Si-

gurisë së Paqësorit, ANZUS. Në të vërtetë në marrëveshje nuk shënohet ndonjë detyrim, por konsultim. Megjithatë Australia i ka mbështetur SHBA-të, si në luftën e Koresë ashtu edhe të Vietnamit me një numër të madh trupash. Po ashtu ushtarakisht do të merrte pjesë edhe Koreja e Jugut, që në rast sulmi nga ana e Koresë së Veriut do të ishte më e prekura. Në rajon edhe Japonia qëndron krah Shteteve të Bashkuara. Por pritet që japonezët të mos angazhohen shumë ushtarakisht, sepse kushtetuta pacifiste është mjaft e kufizuar për sulmet ushtarake. Edhe popullsia japoneze është mjaft skeptike ndaj opsionit ushtarak. 5. Sa realist është skenari i luftës mes Koresë së Veriut dhe SHBA-së? Politologu Dembinski pret që të mos shtrohet çështja e opsionit ushtarak. Vetëm numri i viktimave të luftës në gadishullin korean do të ishte aq i madh, sa që të dyja palët kanë një interes themeltar që ta mënjanojnë përplasjen ushtarake. Sipas tij, ky konflikt „po ngre fluska më shumë se duhet". (DW)



# Pse Vuçiç po tregohet "realist" me Kosovën?



David L. Phillips

A po e shtron Vuçiç terrenin për të marrë përsipër një barrë të madhe? Barra e madhe do të nënkuptonte njohjen e Kosovës nga Serbia. Kosova do të anëtarësohej në OKB, derisa Kosova dhe Serbia do të vazhdonin punën për plotësimin e kritereve të anëtarësimit në BE, duke hyrë bashkërisht në BE. Kosova i shkëputi lidhjet me Serbinë më 1991 si kundërpërgjigje ndaj represionit drakonik të Slobodan Millosheviçit. Më shumë se dhjetë mijë shqiptarë të Kosovës u vranë dhe mbi një milionë të tjerë u zhvendosën gjatë fushatës represive të Serbisë. NATO nisi më 24 mars 1999 fushatën e bombardimeve ajrore, me qëllim të parandalimit të spastrimit etnik. Luftës i dha fund Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, me të cilën u vendos Administrata e Përkohshme e OKB-së (UNMIK) në

Kosovë. UNMIK-u ofroi ndihmesë për vetëqeverisje lokale dhe ndihmoi procesin për përcaktimin e statusit të ardhshëm të Kosovës, duke i hapur rrugë shtetësisë së Kosovës. Kur Kosova e shpalli pavarësinë më 17 shkurt 2008, Serbia e sfidoi deklaratën e pavarësisë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND). Megjithatë, GJND-ja vlerësoi se deklaratat ishte në pajtim me të drejtën ndërkombëtare. Sipas sekretares së atëherëshme amerikane të Shtetit, Condoleeza Rice: «Kombinimi i pazakonshëm i faktorëve në rastin e Kosovës – përfshirë ndarjen e Jugosllavisë, historinë e spastrimit etnik dhe krimet kundër civilëve në Kosovë, si dhe periudha e zgjatuar administratës së OKB-së – nuk janë hasur askund tjetër, rrjedhimisht Kosovën e bëjnë rast special». Pavarësia e Kosovës shkaktoi zhgënjim, mosbindje dhe zemërim anembanë Serbisë dhe nëpër enklavat serbe të Kosovës. Për shumë serbë, Kosova është pjesa më e shenjtë dhe më e rëndësishme e Serbisë, djepi i shtetësisë, kulturës dhe shpirtit serb. Serbët besojnë në prejardhjen hyjnore të sundimit serb. Instrumentet frymore

të manastirit ortodoks të Deçanit të shekullit të katërbëdhjetë në Kosovë ishin farkëtuat prej shpatave të fisnikërisë serbe të shuar në luftë kundër turqve osmanë. Serbët e konsiderojnë Betejën e Kosovës të vitit 1389 si pjesë të luftës së vazhdueshme ndërmjet dy civilizimeve – atij të krishterë dhe evropian, dhe tjetrit islamik dhe aziatik. Deri në ditët e sotme, Serbia refuzon ta pranojë se e ka humbur Kosovën; Kosova kurrë më nuk do të jetë nën kontroll të Serbisë. Deri tani, 114 shtete e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Serbia mundohet sistematikisht të sfidojë orvatjet e Kosovës për të pasur njohje të reja ndërkombëtare. Serbia minon shtetndërtimin e Kosovës, duke vendosur struktura paralele në veri të Kosovës, ku banojnë serbët. Me përkrahjen ruse, Serbia mbështet fushatat kundër anëtarësimit të Kosovës nëpër organizata ndërkombëtare, si Interpoli dhe UN-ECSO. Qasja e Serbisë mund të ndryshojë. Më 24 korrik 2017, presidenti serb, Aleksandar Vuçiç, shkroi një shkrim autorial, duke i bërë thirrje popullit serb «të mos e mbajë kokën në rërë» kur vjen puna të çështja e Kosovës, dhe të

fillojë «një dialog të brendshëm». Sipas Vuçiçit: «Ne duhet të tregohemi realistë, të mos e dorëzojmë ose ta humbim atë që e kemi, por të kthejmë çfarë e kemi humbur kaheër». Vuçiç mund të sjellë marrëveshje për Kosovën. Ka mandat të fuqishëm të bazuar në monopolin e tij nacionalist, dhe është zgjedhur së fundi president me mandat pesëvjeçar. Qëndrimi i tij gëzon përkrahje. Sipas ministrit serb të punëve të Jashtme dhe zëvendëskryeministrit të parë, Ivica Daçiç, «kohët dhe marrëdhëniet ndërkombëtare kanë ndryshuar». Vuk Drashkoviç, drejtues i Lëvizjes së Ripërtëritjes Serbe, e pranon: Serbia duhet «ta pranojë dhe njoh realitetin e Kosovës», si bazë për «zgjidhje të qëndrueshme». Akademia Serbe e Arteve dhe e Shkencave, tradicionalisht me qëndrim të sertë, nuk ka shprehur kundërshtim. Por çfarë e shtyri Vuçiçin të shkruante për Kosovën dhe të propozonte dialog të brendshëm në mesin e serbëve midis verës? A është përnjëmend i sinqertë kur vjen puna të zgjidhja e problemi Kosovë-Serbi, apo thjesht po tregohet i arsyeshëm për të përfutur nga Brukseli? Vuçiç është

edhe pragmatist, edhe politikan i matur. Serbisë i kërkohen reforma kushtetuese për t'i përbushur standardet e «acquis communautaires» të BE-së. Negociatat për anëtarësimin i kërkojnë Serbisë shumë ndryshime themelore në sistemin ligjor, ekonomik dhe politik, duke rezultuar me evropianizim të rendit kushtetues serb. Partia Radikale Serbe, më e madhja në opozitë kundër qeverisë së Vuçiçit, kundërshton me vendosmëri reformat kushtetuese. Vuçiç mund të vihet para një zgjidhjeje të zorit: ose ta përkrahë njohjen e Kosovës në njërin anë, ose t'i kryejë reformat në anën tjetër. Kjo e fundit është larg më e pranueshme për serbët. Vuçiç mund të provojë t'i distancojë serbët nga problemet ekonomike. Në një goditje të fuqishme për ekonominë serbe FIAT-i, investitori më i madh i huaj në Serbi, mund ta mbyllë fabrikën e vet në Kragujevc. Vuçiçit i duhet përkrahje popullore për reforma ekonomike që prekin administratën shtetërore, financat publike dhe ekonominë për të përparuar në rrugën e anëtarësimit në BE. Ose Vuçiç mund të provojë të nxit përplasje nacionaliste,

që rezulton me krizë. Serbia mund të kundërpërgjigjet me aneksimin e Kosovës veriore, duke jetësuar planin e ndarjes të Millosheviçit. Ky skenar duket i pamundshëm. Krijimi i një krize në Kosovë është punë e rrezikshme për një lidhshmëri. Vuçiçi e di se nuk mund të bëjë zgjidhje ushtarake, dhe ai aksion ushtarak në Kosovën veriore do të shkatërronte prospektet e Serbisë për anëtarësim në BE. A po e shtron Vuçiç terrenin për të marrë përsipër një barrë të madhe? Barra e madhe do të nënkuptonte njohjen e Kosovës nga Serbia. Kosova do të anëtarësohej në OKB, derisa Kosova dhe Serbia do të vazhdonin punën për plotësimin e kritereve të anëtarësimit në BE, duke hyrë bashkërisht në BE. Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë me ndërmjetësimin të BE-së me qasje të reja dhe në format tjetër do të mund t'i printe marrëveshjes, duke zgjidhur njërin prej konflikteve më të vështira të Evropës.

*(Shkruar për «Huffington Post». Autori, ish-këshilltari i lartë dhe eksperti i marrëdhënieve ndërkombëtare në administratat e Clintonit, Bushit dhe Obamas)*

# Turistët idealë janë ata që dërgojnë lekët dhe nuk vijnë fare!



Augustin Palokaj

Para disa vjetësh isha në pushime në Makrarska të Kroacisë. Diku rreth orës 1 pas mesdite në një kafene të qytetit bisedoja me një koleg që jeton në atë qytet. A shkon në plazh? E pyeta. «A je ti normal. Kush lahet me turistët. Nuk jam idiot të futem në det tani, kur e kanë okupuar ata!» përgjigjet ai. Një kushëri i tij e ngushëllon duke thënë: «hajt se kalon edhe kjo e keqe e pastaj lahem në det nga fundi i shtatorit!». Sikur në shumë vende të Dalmacisë edhe në këtë qytet për turistët flitet si për një të keqe të domosdoshme. E dinë se jetojnë nga turizmi. Dy muaj sezon, kur ata për vete edhe në garazhi fletë, u mjafton të jetojnë tërë vitin. Por për turistët asgjë të mirë nuk thonë. Ata janë sinonim për njerëz që «nuk din të ngasin veturat dhe për shkak se ata vozisin ngadalë krijohen tollovi në trafik!». Pak ka rëndësi se shumë turistë

vijnë nga Gjermania, Suecia dhe vende të tjera, kalojnë me mija kilometra dhe vështirë se do të kishin mbërritur gjallë sikur vërtet të ishin shoferë aq të këqij. Për turistët flasin se nuk dinë çka është ushqimi i kripë dhe në sezon mund t'iu shesësh gjithçka. «Ai është vetëm për turistët» është përshkrimi i ndonjë restoranti jo të mirë. Në secilin vend në Dalmaci, secilin vit, në secilin situatë është jashtëzakonisht e lehtë të niset debati rreth turistëve. Dhe ata nga përvoja e tyre mendojnë se i dinë karakteristikat e të gjithëve. Kush janë turistët të mirë e kush jo. Të gjithë disi i duroj, por ku afrohet 'feragosto', periudhë pushimesh kolektive në Itali, më mirë të iku në mal sesa të rri këtu. Italianët nuk mund t'i duroj. Vijnë si kope. Flasin me zë, nuk e di se kur grinden e kur bëjnë shaka», thotë njëri. Tjetri thotë se edhe me italianët është mësuar, por kurrsesi nuk i duron holandezët. «A nuk ju mjaftojnë biçikletat në Holandë tërë vitin, por duhet t'i marrin me vete edhe kur vijnë këtu. Nuk mund të ecish normalisht prej tyre. Dhe gjithmonë kanë pyetje për gjithçka», i përshkruan turistët nga Holanda. Por

me gjithë se «janë ta padrueshëm» italianët dhe holandezët e kanë epitetin e «turistëve të mirë», sepse shpenzojnë kur vijnë në pushime për dallim nga çekët. «Një familje vjen tek unë tash e sa vjet dhe marrin me vete ushqimin, blejnë vetëm bukë. Një herë kanë blerë edhe jogurt për ta lyer lëkurën kur i ka djegur dielli! Fillojnë përleshjet për turistët nga Republika Çeke. Një tjetër thotë se më të dashur për të janë turistët nga Bosnjë-Hercegovina, ani pse «hanë shalqin në plazh dhe bëjnë zhurmë». «Ndodh që turistët nga Çekia vijnë për dy javë, por rrinë 20 ditë sepse u mbeten lekë të pashpenzuara. Nga Bosnja vinë për të qëndruar dhjetë ditë, por shkojnë pas gjashtë ditësh sepse i kanë shpenzuar të gjitha paratë. Ata së paku bëjnë qejf!», shkon përvoja tjetër e një qiradhënësi në Dalmaci. Për sllovenët vlen e njëjta gjë, sikur edhe për kroatët nga pjesa kontinentale. Ata më së shpeshti vijnë në pushimoret e tyre, ose tek miqtë apo kushërinjtë. Pak ka dobi prej tyre në bregdet. Pa dallim, të gjithë kanë fjalë të mira për gjermanët. Ata nuk bëjnë zhurmë, harxhojnë shumë dhe, pa marrë parasysh

se nuk u ofrohet gjithmonë shërbimi sipas standardeve gjermane, kthehen prapë çdo vit. Në vendin e parë si turist të padëshiruar tash duket se kanë depërtuar anglezët, sidomos të rinjtë. «Ata janë aq të pa edukuar, aq arrogantë, aq problematikë sa që paratë e tyre nuk na duhen. Nuk ia vlen», mendojnë për ta. Debate që për turistët bëhen çdo verë në Kroaci tash dëgjohen shpesh edhe në Shqipëri, por edhe në Kosovë, ku turistë po thuajse nuk ka, nëse si të tillë nuk konsiderohen pjesëtarët e diasporës. Në Shqipëri shpesh dëgjohej se si «kosovarët marrin ushqim me vete» ose se «bëjnë zhurmë dhe janë të parregullt dhe vijnë sikur çergarët duke u zburuar vend e pavend». Pamë se si në Durrës autobusët nga Kosova nuk lejohehin të hynin në zonën e plazhit e ata nga Bosnjë-Hercegovina po. Pa patetikë, pa kërkesë për solidaritet vëllazëror, një diskriminim i tillë nuk duhet të bëhet ndaj askujt. Ligji duhet të vlejë për të gjithë njësoj. Edhe në Shqipëri tash dëgjohej se si polakët dhe çekët duken turistë më të mirë sesa kosovarët. E kosovarëve ka filluar t'u shko-

jë në nerva diaspora, sepse ua prish rutinën, ndërsa në Shqipëri kosovarët nuk duken më «turistë të mirë». Por «mikpritësit» e dinë se edhe Kosova jeton nga diaspora, dhe një pjesë e Shqipërisë nga turistët. Ndoshta idenë më të mirë për «turistët» idealë e kanë zbuluar në bregdetin e Dalmacisë në Kroaci, ku tash e sa kohë si «turist ideal» konsiderohet ai, i cili i dërgon lekët dhe nuk vjen fare në pushim! Turizmi është, po ashtu, një industri ku vlen rregulla e ofertës dhe e kërkesës. Nëse dikujt nuk i pëlqen, të mos vijë më. Nëse dikush mund t'iu shesë gjithçka turistëve, le të vazhdojë dhe le t'ua rritë lirisht edhe çmimin. Nëse kosovarët nga diaspora mund të shkojnë në Spanjë për pushime me më pak para sesa që harxhojnë për të ardhur në Kosovë, le të shkojnë. Është çështje tjetër se kënd mund ta impresionojnë në Spanjë me veturën e tyre, a mund të gjejnë atje nuse për djalin, apo burrë për vajzën, a mund të shkojnë nëpër aq shumë dasma dhe zifafete dhe a mund të porosisin këngë për secilin qytet të trojeve etnike. Nëse lokalet në Kosovë mund të tërheqin klientë nga Amerika, Franca apo

ndonjë vend tjetër le ta bëjnë këtë. Në të gjitha këto debate në sipërfaqe del mendimi tepër pozitiv i secilit për veten. Nëse kosovarët nuk ndihen mirë në Shqipëri, le të shkojnë diku tjetër. Pushimet, mes tjerash, janë çështje e zgjedhjes së lirë e jo detyrim. Turizmin duhet marrë si biznes, e jo më me patetizëm si atdheadashuri. E si biznes turizmi është ai që e mban gjallë Kroacinë sot, e cila do të shënojë rekord këtë vit me rreth 17 milionë turistë të huaj, nga të cilët do të fiton mbi 10 miliardë euro. Në të ardhmen turizmi do ta mbanë edhe Shqipërinë, sapo të mësojnë ta menaxhojnë më mirë këtë industri. Edhe Kosova, që është vendi më i varfër në Evropë, pa diasporën nuk do të mundë as të mbijetonte. Ideal apo jo, mysafirët, turistët, «bashkatdhetarët» siç quhen në Kosovë, kosovarët nga diaspora apo «refugjatët» siç kam dëgjuar t'u thonë në Shqipëri janë një e mirë që u ndodh këtyre dy shteteve, dhe atë duhet shfrytëzuar edhe si aset ekonomik. Kush e ka fatin apo fatkeqësinë që jeton jashtë apo brenda është një temë tjetër. (koha.net)



## Facebook, më i rrezikshëm për meshkujt



Rrjetet shoqërore janë më të rrezikshme për meshkujt se sa për femrat, sipas një studimi me 1500 përdorues të internetit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Britaninë e Madhe. Ky studim tregon se meshkujt nuk e kanë problem që në profilet e tyre në Facebook të pranojnë kërkesat e njerëzve të panjohur (sidomos nëse fotot e profilit tregojnë femra të bukura), të deklarojnë vendndodhjen e tyre, të lënë profilin të hapur për të gjithë dhe nuk tregohen të kujdesshëm përsa i përket kushteve të sigurisë së profilit të tyre. Në këtë mënyrë ata janë pre më e lehtë e krimeve kibernetike. Studimi tregoi se 65% e femrave nuk pranojnë kurrë kërkesa miqësie nga njerëz të panjohur, ndërsa për qindja tek meshkujt zbrit në 50%. Gjithashtu, 25% e meshkujve e lënë të hapur profilin e tyre në krahasim me vetëm 16% të femrave. U vërejt se shumica e meshkujve pranon kërkesat e vajzave të bukura, ndërsa femrat hezitojnë kur i vjen një kërkesë miqësie nga një mashkull i pashëm. George Petre, një nga personat që realizuan vëzhgimin, theksoi se kjo vjen nga fakti se shoqëria i mëson femrat të jenë të kujdesshme ndaj njerëzve të panjohur.

# Burrat më të mirë u përkasin këtyre katër shenjave të horoskopit

Shenjat e horoskopit janë një faktor i rëndësishëm për karakterin e një njeriu. Ndonjëherë janë shumë të dobishme sepse parashikojnë sjelljen e tjetrit në varësi të shenjës së horoskopit. Ky artikull mund t'ju vijë në ndihmë beqareve që janë kërkim të burri të përsosur. Sipas shenjave të horoskopit, burrat që i përkasin këtyre 4 shenjave janë të përsosur



- Akrepi. Burrat që i përkasin shenjës së akrepit janë të vështirë për t'u zënë. Ata kanë një flirtim misterioz dhe kjo veti i bën shumë tërheqës. Nëse arrini që të lidheni me një mashkull që i përket kësaj shenje, atëherë lirisht mund të thoni që ëndrra juaj është bërë realitet. Janë besnikë dhe e respektojnë privatësinë e partneres së tyre.

- Binjakët. Janë tipa me shumë humor dhe kjo ka rëndësi të madhe në jetën martesore. Pas një ditë të lodhshme, burrat që i

përkasin kësaj shenje janë mënyra më e mirë për t'ju ndihmuar të relaksoheni. Janë të përkushtuar dhe gruan e kanë prioritetin numër një. Gjithmonë do t'ju japin kohë dhe shmangin mosmarrëveshjet.

- Gaforja. Burrat e shenjës së gaforres janë të njohur për moralitet të lartë. Ata nuk e durojnë dhunën në familje dhe nuk abuzojnë me gruan. Nëse ndonjëherë

kanë dyshim, kjo ndodh për shkak të cilësisë së moralit të lartë që kanë. I kuptojnë shumë mirë detyrat e bashkëshortit dhe nuk vlerësojnë familjes. Gjithmonë përparësi u japin fëmijëve.

- Peshorja. Nëse jeni të martuar me një burrë që i përket shenjës së peshores, atëherë jeta juaj do të jetë e rrethuar nga dashuria dhe romanca. Peshoret do të

bëjnë gjithçka për t'ju bërë të lumtur. Ata duan vetëm një gjë, që të shohin buzëqeshje në fytyrën tuaj. Për më tepër, ata zotërojnë një gjentilesë të përsosur. Është kënaqësi që të kaloni jetën në shoqërinë e tyre. Nëse jeni të martuar me ndonjë nga këto shenja, atëherë duhet të falënderoni yjet. Nëse jeni duke kërkuar burrë, tani e ke më të lehtë të bëni zgjidhjen e duhur.

## Produktet që ju mbrojnë nga dëmi i duhanit

Antioksiduesit, të cilët mbrojnë qelizat nga radikale të lira, janë shumë të rëndësishëm për shëndetin tuaj. Radikale të lira konsiderohen ajri i ndotur, tymi i duhanit, rrezet e diellit, lëndët kimike, disa ilaçe, produktet e prishura dhe disa përbërës që gjenden tek ushqimet. Këto hyjnë në trupin tonë edhe kur marrim frymë apo hamë bukë dhe dëmtojnë shëndetin. Duke dëmtuar qelizat, radikale të lira ndikojnë shumë në shfaqjen e sëmundjeve serioze si kanceri dhe ato të zemrës.



Studimet kanë treguar se ushqyerja e pasur me antioksidues ul rrezikun e sëmundjeve kancerogjene, kardiovaskulare, Parkinsonit dhe Alzheimerit, transmeton "temina". Bazuar në një lajm të "Mayo Clinic", produktet e pasura me antioksidues përbajnë fibra, yndyrë të

pangopur, nivel të ulët kolesterolit dhe në të njëjtën kohë janë burim i mirë vitaminash dhe mineralesh.

Cilët janë produktet që përbajnë sasi të larta antioksiduese?

- Frutat e kuqe: Përbajnë shumë antioksidues. Luleshtrydhja, manaferra,

boronicat, mjedra, thana dhe të gjitha llojet e luleshtrydheve zënë vend në mesin e frutave me sasi më të larta antioksidues.

- Dardha, molla ose kumbulla: Nëse konsumohen me lëkurë dardha, kumbulla dhe shumë lloje mollësh përbajnë antioksidues. Krahas kë-

tyre edhe vishnja dhe portokalli janë një burim i mirë antioksiduesish.

- Mos harroni perimet: Lakra, sallata e gjelbër etj., zënë vendin e parë në listën e perimeve të pasura me antioksidues. Alternativa të tjera janë brokoli dhe lulelakra.

- Patatja: edhe mollët apo patatet e skuqura në furrë janë burim i mirë antioksiduesish.

- Produktet me lëvozhgë: Në mes tyre mund të përmendim arra, lajthia, bajamja. Krahas tyre edhe bishtajorët si fasulja dhe thjerrëzat përbajnë sasi të larta antioksiduesish. Ju mund të përforconi shëndetin tuaj duke konsumuar dhe lëng sheqe e pasur me antioksidues. Bashkë me të mund të konsumoni edhe një copë çokolatë për të mbështetur antioksiduesit.

## Gjendet ëmbëlsira 106-vjeçare në Antarktik

Shkencëtarët e Zelandës së Re kanë zbuluar një kek të vjetër me fruta 106 vjet i vjetër, i ruajtur në mënyrë perfekte. Ëmbëlsira e bërë nga pasticerët britanikë të Huntley & Palmers, ishte ende e mbështjellë me letër dhe brenda një ene prej kallaji dhe argjendi, në një kasolle të largët në Antarktik, shkruan Newser. Lizzie Meek nga "Antarctic Heritage Trust", në Christchurch të Ishujve të Jugut në Zelandën e Re, tha se keku i përkiste partisë veriore të Robert Falcon Scott të vitit 1911. "Mbetet ende mister se si është arritur të ruhet shija e ëmbël që prej shekullit të kaluar", ka thënë Meek.



## Si të shkurtoni kohën e larjes së rrobave?

Kur vjen puna tek larja e rrobave, pjesa më e madhe e njerëzve thjesht ndjekin udhëzimet e paketimit të detergjentit. Por gurujta australiane e pastrimit, Shannon Lush, thotë se kjo është e gabuar. Shannon ka rrëfyer disa trike për të përsheptuar procesin e larjes, dhe do të habiteni me to. Ajo thotë se gjëja me e rëndësishme që duhet të dini është se më shumë detergjent nuk i bën të më pastra rrobat tuaja. "Sapuni është me bazë yndyrash. Kur fije kanë kon-

takt me kaq shumë, tërheqin papastërtinë", thotë Shannon duke shpjeguar se sasia e tepërt i bën rrobat shumë shpejt më të papastra. "E dini kur peshqirët pasi i keni larë janë si me gjemba? Kjo ndodh për shkak të sasisë së madhe të detergjentit pasi ka yndyrë. Është si gjalpi kur e hedh në një tigan të ngrohur shkrin, dhe pasi ftohet forcohet prapë", vijon ajo.

Pra, sa detergjent duhet të përdorim? Për pak rroba rekomandohet 1/8 e matësit, ndërsa kur keni shumë rroba

për të larë, rekomandohet 1/4 e tij. Për rezultate më të mira Shannon rekomandon të shtoni dy lugë gjelle sodë bikarbonat dhe dy lugë gjelle uthull në çdo larje. "Përdorni uthull të bardhë në vend të aromatizuesit të rrobave, aromatizuesi nuk punon gjithmonë. Ai ka bazë vaji, dhe gjithçka që bën është që përhap vajin në larje. Hidhni më mirë uthull dhe sa zbutës, e mbi të gjitha nuk lë aroma", thotë Shannon. Shannon thotë se njerëzit ankohen gjithmonë se rrobat

nuk kanë erë dhe për këtë arsye e përdorin zbutësin. Por mund ti shtoni vaj esencial, por një sasi shumë të vogël, vetëm një pikë esence livandoje. Shannon thotë se kjo metodë shkurton edhe kohën tharjes me një të tretën. Një tjetër trik për të shkurrtuar kohën e tharjes është shtimi i një pecete me rrobat e lagura. "Unë e urrej tharësen e rrobave, siç mund ti përdorin disa. Një pecete e thatë me rrobat e lara dhe ato do të thahen tre herë më shpejtë.




## Nëse sperma juaj ka këtë ngjyrë, urgjent tek mjeku

Herën tjetër pas seksit apo masturbimit, patjetër kushtoni kujdes spermës të cilin e keni nxjerrë jashtë, sepse ajo mund t'ju tregojë shumë për shëndetin tuaj. Nuk është krejt njësoj çfarë është ngjyra e spermës, dendësia, aroma dhe sasia, sepse pikërisht këta parametra mund të tregojnë ndonjë sëmundje. Për fillim, ta keni të qartë nëse rastësisht në lëngun e

spermës vëreni gjak, menjëherë caktoni kontroll te urologu, sepse mbase keni kancer apo ndonjë sëmundje të rrezikshme, e cila mund t'ju kushtojë si me maskulitet ashtu edhe me jetë! Po ashtu, nëse sperma ju duket diçka më e zbehtë se zakonisht, madje edhe e tejdukshme, është koha për t'u brengosur. Mbase është fjala për ejakulimin retrograd – gjendje kur një pjesë e

spermës në vend që të nxirret jashtë nëpërmjet vrimës së uretres, e riorienton në traktin urinar. Nëse e injoroni, pas një kohe mund të filloni të keni të ashtuquajturin "orgazëm në të thatë", që "të gjuani në të zbrazët", përkatësisht të ndieni kulmin seksual, mirëpo jashtë nuk mund të nxirreni asnjë pikë lëngu. Fatkeqësisht, nëse nuk reagoget me kohë, imp-

likimet e këtij çrregullimi janë impotencia dhe shterpësia. Nga ngjyrat edhe më problematike janë sperma e verdhë dhe e gjelbër. Kjo me siguri është shenjë që jeni "prekur" me sëmundje seksualisht të transmetueshme apo me ndonjë infektion tjetër. Fatmirësisht, madje edhe kur është fjala për hlamidinë apo gonorrenë nëse reagoget shpejt do të shërohen



tërësisht. Me siguri as ju, si edhe as shumica e meshkujve nuk dëshironi të shikoni frytet e "punës tuaj të kaluar", e aq më pak që t'i nuhatni. Mirëpo,

do të duhej kohë pas kohe që t'i merrni erë spermës suaj, dhe nëse vëreni çfarëdo qoftë ndryshimi të erës, duhet që të konsultoheni me ekspertin.

## Ky është telefoni i parë në botë me kamerë f/1.6



Në dy vitet e fundit telefonat e linjës V nga LG kanë lënë shije të mirë për kamerat dhe aftësitë e shkëlqyera në regjistrimin e videove të cilësishë së lartë. Së fundi, kur na ndajnë tre javë nga debutimi i LG V30, kompania ofroi detaje të kamerës së telefonit. LG V30 do të karakterizohet nga një

kamerë e pasme e dyfishtë me hapje f/1.6, duke u bërë telefoni i parë në botë me një censor të tillë. Galaxy S8 dhe HTC U11 kanë lente me hapje f/1.7, G6 me f/1.8 dhe Google Pixel f/2.0. LG premtoi se kamera me hapje f/1.6 do të ofrojë 25% më shumë dritë sesa një lente me hapje f/1.8.

## Tërmetet ndodhin më shpesh natën apo ditën?

Edhe pse tërmetet janë perceptuar si fenomene që ndodhin kryesisht natën, gjeologët thonë se një tërmet mund të ndodhë në çdo kohë të ditës apo natës, dhe se shpeshësia e tërmeteve gjatë natës në krahasim me ditën është thjesht rastësore. Në fakt, pllakat tektonike lëvizin kilometra poshtë kores së tokës, ku fenomene sipërfaqësore si temperatura apo ndërrimi i ditës dhe natës nuk kanë asnjë ndikim. Tërmetet e fundit në disa vende kanë ndodhur pikërisht natën, ndaj dhe kjo është një rastësi, pasi duhet të kemi parasysh se në të shkuarën shumë tërmete

të fuqishme kanë ndodhur edhe në mëngjes. Sipas ekspertëve, perceptimi i tërmetit si një fenomen i lidhur me natën, mund të shpjegohet nga pikëpamja psikologjike. Tërmetet që bien gjatë natës krijojnë një ndikim shumë më të fortë emocional, pasi në këtë kohë krijohet ndjesia se nuk e ke situatën nën kontroll, si për shkak të fushëpamjes së dobët ashtu edhe aftësinë së ngadalësuar për të reaguuar, qoftë edhe për shkak se nata është një pjesë e ditës e dedikuar ndaj pushimit dhe qetësisë, që pasi trazohet shkakton frikë dhe irritim.



## Pse në Angli makinat i ngasin në krahun e djathtë?

Në Angli, Australi, Japoni dhe disa vende në Afrikën jugore, automjetet drejtohen në krahun e majtë, me timonin e vendosur në të djathtë: duke qenë se bëhet fjalë për një pakicë jo të vogël (rreth 30 për qind e drejtuesve të makinave në botë), ekziston një mendim i përbashkët se këto vende e kanë ndryshuar qëllimisht drejtimin për të dalë nga turma. Megjithatë në realitet, nuk ishte Anglia ajo që e ndryshoi anën e shoferit, por 70 për qindësi tjetër i botës! Zgjedhja për të drejtuar makinën në të majtë, e gjen origjinën e vet në dy shpjegime, një historik dhe tjetri shkencor/mekanik: që në Mesjetë, ushtarake qenë të detyruar të mbanin anën e majtë, në mënyrë që të kishin mundësi të nxirnin shpatën (e cila mbahet në anën e majtë) me dorën më të fortë, që është e djathta.



Një zakon ushtarak bëhet më pas detyruar pas kërkesave këmbëngulëse të Papa Bonifacit VIII: shekuj më vonë do të jetë revolucionari Robespier ai që do e thyejë këtë rregull, duke revolucionarizuar drejtimin e udhëtimit në shenjë proteste kundër Kishës. Vetë Napoleoni ru-

ajti zakonet e drejtimin të udhëtimit në të djathtë: duke qenë vetë mëngjarash, përfitimet ushtarake ishin shumë të dukshme. Shpjegimi më teknik ka të bëjë me formën e makinave të para: freni i dorës në fillim u vendos në pjesën e jashtme të anës së djathtë,

çka bëri të nevojshme pozicionimin e timonit dhe shoferit në të njëjtën anë. Me përparimin teknologjik, freni i dorës zhvendoset brenda në makinë, në një pozicion qendror: për të inkurajuar përdorimin e dorës më të fortë (të djathtës) vendi i shoferit lëvizti në të majtë.

## Sa orë duhet të flejë një grua shtatzënë?

Nevoja për gjumë në shtatzëni fillon të bëhet e dukshme menjëherë pas rezultativit pozitiv të testit. Nëse ndiheni e lodhur gjatë ditës, duhet të dëgjoni sinjalet e trupit tuaj dhe të shkoni të pushoni. Gjatë shtatzënisë ka edhe shumë gra të cilat vuajnë nga pagjumësia si një faktor natyral, ndërsa disa të tjera nuk mundin të flenë si pasojë e angazhimeve të tyre në familje apo punë.

- Për sa orë gjumë ka nevojë një grua shtatzënë?



Në shtatzëni trupi nuk ka nevojë për 2-fish kalori apo 2-fish gjumë. Gjëja më korrekte është t'i jepni mundësinë trupit të rekuerojë energjitë e humbu-

ra, për një mirëqenie të përgjithshme. Që ta bëni këtë do të ishin të mjaftueshme rreth 10 orë gjumë.

- Po nëse gruaja ka disa

shqetësime? Zakonisht gruaja nuk mund të flejë si pasojë e krampeve, të cilat mund të luftohen duke konsumuar ushqime të pasura me magnez dhe kalium si: kikirikët, bananet, kajsitë e thata dhe peshku. Gjithashtu mund të vuani edhe nga mpirja e duarve. Në këtë rast duhet të hapni dhe mbyllni grushtat ose vendosni duart tuaja në ujë të ngrohtë dhe të ftohtë, pra duke i alternuar. Këto veprime bëhen para gjumit.

## Nuk pajtohen për emrin e fëmijës, prindërit përfundojnë në gjykatë

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë mbi 5 mijë njerëz që përdorin emra të ndryshëm, kjo për shkak se prindërit nuk kanë arritur të pajtohen për pagëzimin e fëmijëve të tyre. Së fundmi një çift në Londër po shtyhen në gjykatë për të vendosur për emrin e fëmijës së tyre, shkruan KidSpot. Prindërit tanimë janë ndarë, dhe fëmija ka mbetur pa emër që prej 3

vjetësh kur ka lindur. Ata e thërrasin fëmijën secili me nga një emër. Edhe gjykatësi është shokuar kur ka dëgjuar prindërit të thërrasin vajzën në dy emra të ndryshëm. Madje e ka quajtur si rast "qesharak". Babai ka argumentuar se emri që ka zgjedhur ai është më i mirë sesa i nënës, për të cilin njerëzit mund të mendojnë se është i gabuar.







"Qeveria e Kosovës kishte punuar me Bashkësinë Islame të Kosovës (BIK) për ta luftuar ekstremizmin e dhunshëm dhe e ka dënuar vandalizmin në vendet religjioze", thekson raporti i Departamentit amerikan të Shtetit në kapitullin për Kosovën

# SHBA lavdëron Qeverinë e Kosovës

## Janë ndërmarrë hapa kundër radikalizimit religjioz

"Kushtetuta e Kosovës e ndalon diskriminimin religjioz dhe mundëson liri të fesë", shkruan në fillim të kapitullit për Kosovën në Raportin Ndërkombëtar të Lirive Fetare për vitin 2016 të Departamentit amerikan të Shtetit, i cili është publikuar të martën. Më tutje theksohet se "legjislacioni nuk lejon që grupet fetare të regjistruhen si entitete juridike, duke krijuar pengesa për ato në kryerjen e punëve të tyre. Qeveria e ka miratuar, ndërsa në Parlament është shqyrtuar, por nuk është votuar për propozim-ligjin, me të cilin do të lejohej regjistrimi i grupeve fetare si entitete juridike, në mënyrë që ato të mund të ushtronin aktivitetet dhe çështje juridike me shtetin dhe entitetet private". Në këtë kuadër, në raport thuhet se "Komuna e Prishtinës, duke e cituar mungesën e lejes së ndërimit, i ka ndaluar murgjit ortodoksë serbë nga pastrimi dhe riparimi i dritave në Kishën e Shpëtimtarit, e cila ende është e papërfunduar, pasi vandalët ia kishin vënë zjarin". "Qeveria e Kosovës kishte punuar me Bashkësinë Islame të



Kosovës (BIK) për ta luftuar ekstremizmin e dhunshëm dhe e ka dënuar vandalizmin në vendet religjioze", thekson raporti i Departamentit amerikan të Shtetit në kapitullin për Kosovën. "Protestuesit kanë hedhur gurë dhe kokteje molotovi kundër pjesëmarrësve të disa ngjarjeve me pelegrinë ortodoksë serbë. Në një incident, protestuesit etnikë shqiptarë kanë hedhur gurë dhe i kanë parandaluar pelegrinët ortodoksë serbë nga pjesëmarrja në një manifestim në Mushitisht. Në disa raste, vandalët i kanë dëmtuar pasuritë religjioze të Kishës Ortodokse Serbe,

përkundër mbrojtjes nga ana e Qeverisë. Një serb entik e ka dëmtuar një xhami myslimane", shkruan në raport dhe theksohet se "përfaqësuesit e Ambasadës së Shteteve të

Bashkuara shpeshherë janë takuar me zyrtarët qeveritarë për të kërkuar tolerancë fetare, kalim të legjislacionit për lejimin e institucioneve fetare për të fituar status juridik dhe

për implementim të plotë të legjislacionit, që i mbron vendet fetare dhe për të diskutuar për përpjekjet për zgjidhjen e kontesteve të pasurisë fetare". "Ambasada është angazhuar me komunitetet religjioze për të diskutuar për qasje në varrezat për protestantët dhe ishte kosponzore e një konference për rolin e femrave në dialogun ndërfaqësor dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm". Në pjesën e raportit "Praktikat qeveritare", theksohet se Qeveria e Kosovës "ka ndërmarrë hapa për kundërshtimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm të ndërlidhur me religjion". Sipas komuniteteve të religjionit, "Qeveria ka vazhduar t'i përgjigjet dhunës

dhe vandalizmit në shoqëri, kundër disa komuniteteve religjioze pakicë". Nga ky raport i gjatë, veçojmë edhe rastin ku theksohet se "më 26 korrik prokurorët e kanë akuzuar klerikun iranian, Hasan Azari Bejandi, për pastrim të parave nëpërmjet një organizate joqeveritare nominale, që ai e operonte". Autoritetet thanë se Bejandi ishte shef i Fondacionit "Kuran" në Kosovë, ku përfshiheshin pesë organizata shiite, të cilat ai i drejtonte në Kosovë, me lidhje në Iran. Policia e Kosovës, shkruan mëtutje në raport, nuk e ka arrestuar Bejandin, pasi ai ishte larguar nga vendi më 28 korrik. Menjëherë pas kësaj, Qeveria e Kosovës i ka mbyllur të pesë organizatat. Në pjesën e raportit për Shqipërinë, theksohet se Kushtetuta e këtij vendi garanton liri të religjionit dhe ndërgjegjes. "Qeveria i ka legalizuar 137 xhami gjatë vitit, në krahasim me gjashtë sosh para një viti", theksohet në raport dhe shtohet se "grupet fetare kanë raportuar një lloj të progresit në qindra kërkesa ndaj Qeverisë për kthim të pasurisë së konfiskuar gjatë periudhës komuniste". "Këshilli ndërfaqësor, që konsiderohej të funksiononte si forum i liderëve të komuniteteve religjioze të vendit, për të diskutuar për shqetësimet e përbashkëta, nuk është takuar, siç kishte ndodhur në vitet e kaluara", thekson raporti dhe shton se "Papa Françesk e ka mbajtur një audiencë në Romë me liderin e komunitetit global të bektashinjëve, me seli në Tiranë, që ishte audiencia e parë e këtillë për ndonjë lider fetar nga vendi me Papën".

### SITUATA DO SQAROHET SHPEJT, DONIM QEVERI ME BAZË TË GJERË

Kandidati për kryeministër nga radhët e koalicionit PAN, - mes Partisë Demokratike të Kosovës, Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nismës për Kosovën, - Ramush Haradinaj është shprehur këtë të mërkurë se shumë shpejt do të qartësohet situata politike në vend. Arsyeya pse është marrë kaq shumë kohë për krijimin e institucioneve, sipas tij është interesi për të pasur një qeveri me bazë të gjerë, e jo vetëm fakti që të sigurojnë 61 votat e nevojshme. Komentet e fundit, Haradinaj i ka bërë gjatë një konference për shtyp të AAK-së, ku prezantoi edhe kandidatët nga AAK për komunat e Pejës dhe Gjakovës. I pyetur nëse do të jetë kryeministër i Kosovës më 1 shtator, ai u shpreh: "Arsyeya pse mori më shumë kohë krijimi i institucioneve është se ishim të interesuar për një bazë më të gjerë, jo vetëm numerikisht me 61 vota, por me bazë më të gjerë. Mendoj se një qartësi politike do të vijë shumë shpejt. Implementimi mund të marrë më shumë kohë. Por, mendoj se një qartësi politike do të vijë shumë shpejt", tha Haradinaj.

## "Shteti i Pejës" dhe ndarja e Kosovës, sipas Çanak

Kryetari i Lidhjes Socialdemokrate të Vojvodinës (LSV) Nenad Çanak ka vlerësuar se propozimi i ministrit serb të Punëve të Jashtme Ivica Dačić për caktimin e kufijve ndërmjet serbëve e shqiptarëve në Kosovë, është i vonë për të paktën dhjetë vjet dhe ka shtuar se partia që ai e udhëheq kishte propozuar zgjidhje të ngjashme për çështjen e Kosovës, transmeton Koha.net. Siç njofton "kurir" i Beogradit, Çanak ka përkujtuar se partia që ai e udhëheq e ka prezantuar këtë propozim gjatë debatit për "Propozimrezolutën për zgjidhjen e drejtë të çështjes së Kosovës". Deputetë e kësaj partie atëherë kishin

propozuar që Qeveria e Serbisë të përgatiste dhe të nënshkruante "marrëveshjen" me Kishën Ortodokse serbe (KOS) për njohjen e "Shtetit të Pejës" të cilën do ta miratonte Kuvendi. LSV atëbotë kishte propozuar që "Shteti i Pejës" sovran, të ketë sovranitet mbi të gjitha kishat dhe manastiret e KOS-it dhe ndaj pasurisë së tyre. Formimi i këtij shteti, gjoja, do të bazohej në mënyrën se si ishte formuar shteti i Vatikanit. Në korrikun e vitit 2007, ky propozim ishte hedhur poshtë në Kuvendin e Serbisë me 205 vota kundër e Çanak me një deklaratë të shkruar thotë se amendamentin s'e kishte përkrahur Dačić.

## Dorëhiqen ministrat teknik, kompetencat te zëvendëministtrat



Tre muaj pas marrëveshjes "Rama-Basha", ministrat teknikë të Partisë Demokratike bënë aktin formal të largimit nga Qeveria "Rama", në të cilën u përfshinë si pjesë e marrëveshjes për të monitoruar nga afër sjelljen e administratës në zgjedhje dhe për të garantuar standardin e tyre. Partia Demokratike thotë se ky nuk është një objektiv i arritur, sepse sipas kreut të saj Lulzim Basha, Edi Rama i kishte blerë zgjedhjet përpara arritjes së marrëveshjes. Megjithatë, ministrat teknikë qëndruan në detyrë edhe gati dy

muaj pas zgjedhjeve për të hartuar raportin për standardin e zgjedhjeve. Top Channel mësoi se raporti ka përfunduar dhe menjëherë pas tij, ministrat kanë dorëzuar zyrtarisht dorëheqjet. Për ta bërë këtë, ata nuk i ka penguar mungesa e kryeministrit për shkak të pushimeve, sepse as zëvendëskryeministrja dhe as ministrat teknikë nuk u takuan asnjëherë këto 3 muaj me kreun e qeverisë ku bënin pjesë. Hallka lidhëse ishte Sekretari i Përgjithshëm i Kryeministrit, nëpërmjet të cilit kalonin

vendimet dhe kryej komunikimi për funksionimin e tyre. Përpara se të jepnin dorëheqjen, disa prej ministrave teknikë i kishin kaluar më parë kompetencat te zëvendëministtrat përkatës: ministri i Brendshëm, i Shëndetësisë dhe ajo e Financave. Por me përfundimin e raportit për zgjedhjet, duke dhënë dorëheqjen, përfaqësuesit e Partisë Demokratike në Qeverinë "Rama" rrëzojnë çdo tezë për një bashkëqeverisje Rama-Basha, për të cilën kreu i opozitës është sulmuar edhe nga kritikët e tij brenda Partisë Demokratike.







Kryestrategu i Shtëpisë së Bardhë, Bannon, sipas informacioneve të medieve ndoshta ndodhet pak para shkarkimit. Kanali televiziv, CBS madje përcaktoi edhe një kornizë kohore. Ai raportoi duke iu referuar një burimi, që nuk e përmendi, se Bannon mund të largohet nga posti që në fund të javës. Si shkak shihen deklaratat e Presidentit Trump për dhunën ekstremiste të djathtë në Virxhinia

Sipas informacioneve të kanalit televiziv CNN, John Kelly, shefi i ri i shtabit në Shtëpinë e Bardhë dëshiron ta heqë qafe sa më parë Stephen Bannon-in. Këtë e bënë të ditur në kushte anonimiteti një bashkëpunëtor aktual dhe një bashkëpunëtor i larguar i Presidentit. Kanali televiziv, CBS madje përcaktoi edhe një kornizë kohore. Ai raportoi duke iu referuar një burimi, që nuk e përmendi, se Bannon mund të largohet nga posti që në fund të javës.

Shkak është kritika e Presidentit të SHBA, Donald Trump ndaj dhunës ekstremiste të djathtë në Virginia. Vetëm pas presionit masiv nga brenda dhe jashtë vendit u distanca Trumpi nga dhuna ekstremiste e djathtë në Charlottesville. Dy ditë më parë ai deklaroi vetëm se për dhunën janë përgjegjëse "shumë palë". Kjo i sollti atij ndër të tjera kritikë të ashpër edhe nga kampi i tij.

Shumë shohin pas

Kryestrategu Banonin para largimit

# Vështirësohet situata në Shtëpinë e Bardhë



deklaratave fillimisht ngurruese të Presidentit të SHBA dorëshkrimin e kryestrategut të tij Bannon. Kritika që bëhet është se deklaratën e tij të parë, e cila nuk i vinte emër të qartë terrorit nga e djathta, Trumpi e pati formuluar të tillë për të mos lënduar ekstremistët e djathtë dhe racistët në radhët e mbështetësve të tij. Pas saj, sipas kritikëve,

ndodhet Bannon-i. Ish-shefi nacionalist i djathtë i portalit "Breitbart News" konsiderohet si një nga kokat pas luftërave për pushtet në Shtëpinë e Bardhë. Portali i dikurshëm i internetit i Bannonit kritikohet se ka ndikuar në forcimin e lëvizjes antisemitike dhe raciste Alt-Right. Por duke folur para reporterëve në lobin e

Trump Tower në New York të martën, Trump tha se Bannon "është njeri i mirë, nuk është racist". "Do të shohim se çfarë do të ndodhë me të", tha Trumpi, duke e lënë të hapur të ardhmen e Bannon-it. Sipas tij, marrëdhëniet racore në SHBA janë përmirësuar që kur ai ka ardhur në pushtet. Trump përsëriti se dhuna në Charlottesville erdhi

## Postimi antiracist i Obamës më i pëlqyeri në Twitter

Një postim i ish-presidentit amerikan, Barack Obama, pas tubimit të së djathtës ekstreme në Virgjinia, është bërë meashti më i pëlqyer i të gjitha kohërave në rrjetin Twitter. "Askush nuk është lindur me urrejtje ndaj personit tjetër për shkak të ngjyrës së lëkurës së tij, për prejardhjen e tij apo për religjionin e tij...", ka shkruar Obama në rrjetin Twitter më 12 gusht, duke e cituar liderin e Afrikës Jugore, Nelson Mandela, i cili ka vdekur para disa vitesh. Ky postim ishte bërë pasi femra 32 vjeçare, Heather Heyer, nëpunëse në fushë të drejtësisë, që protestonte kundër tubimit të nacionalistëve të bardhë, në qytetin Sharlottesville, ishte vrarë kur një shofer me makinën e tij e kishte sulmuar turmën e demonstruesve. Ky postim i Obamës është pëlqyer më shumë se 3 milionë herë, deri sot në mëngjes, duke e bërë kështu shkrimin më të pëlqyer të të gjitha kohërave në rrjetin Twitter. Ky shkrim është ripostuar më tepër se 1.2 milion herë.

nga të dyja palët dhe se përfaqësuesit e të majtëve i patën sulmuar të djathtët. 63 vjeçari Bannon shihet shpesh në lidhje me organizata djathtëtiste nga më të ndryshmet, të cilat mbledhen nën emrin "Alt-Right". Pjesë të rëndësishme të agjendës politike të Trumpit janë lufta kundër emigrimit "të tepert" dhe një luftë kul-

ture e Perëndimit "të krishterë" kundër pjesëve të tjera të botës. Mësohet se Bannoni ka disa kohë që e ka humbur ndikimin. Sipas të dhënave, Trumpi takohet vetëm një herë në javë me kryestrategun e tij; Bannoni është dërguar në një lloj "internimi të brendshëm", raporton "New York Times".

Sipas një informacioni të kësaj gazete, moduli i medieve, Rupert Murdoch i pati kërkuar që para dhunës në Charlottesville Trumpit që ta largojë nga posti kryestrategun e tij. Presidenti i SHBA e pati kundërshtuar sipas këtij informacioni vetëm me gjysmë zemre këtë kërkesë. Njëkohësisht ai është shprehur i zhgënjyer nga Bannoni. Shefi i shtabit të Shtëpisë së Bardhë, John Kelly sipas këtij informacioni ka paralajmëruar se nuk do t'i durojë më intrigat në Shtëpinë e Bardhë.

## Trump përsëri i fajësoi të "dy palët" për dhunën në Virxhinia

Një ditë pasi e shpalli racizmin se është "djallëzor", presidenti amerikan, Donald Trump, përsëri i ka fajësuar "të dy palët" për dhunë, që shpërtheu në një tubim gjatë fundjavës të organizuar nga supremacistët e bardhë në Sharlottesville në Virxhinia. "Ju e keni një grup në një anë, që ishte shumë shumë i keq, dhe ju e keni një grup tjetër në anën tjetër, që ishte shumë, shumë i dhunshëm", u tha Trump gazetarëve gjatë vizitës në ndërtesën, Trump Tower, në Nju Jork. Ai tha se ka pasur njerëz "problematikë" në mesin e asaj që ai i cilësoi si kundërdemonstrues "të majtë alternativë" në këtë tubim, që ishte organizuar nga neo-nazistët, Klani Ku Klux dhe nga supremacistët e bardhë, dhe ata të majtë, të pajisur me shkopinj dhe që synonin konfrontim të dhunshëm. Në pamjet e përlshjeve ndërmjet dy grupeve duke se si të dy palët ishin të pajisur me shkopinj të bejsbollit dhe mburoja, derisa këmbenin goditje. Protestuesit antifashistë patën thënë se ata kishin planifikuar shkatërrimin e tubimit të krahut të djathtë. "Ata i dolën njëri-tjetrit me shkopinj dhe kjo ishte e tmerrshme dhe tejet brutale", tha Trump dhe shtoi se "protestuesit e krahut të majtë" e sulmuan në mënyrë të dhunshme grupin tjetër. Këto komente të presidentit Trump ishin një lloj jehone i deklaratës së tij të parë më 12 gusht se "shumë palë" i kontribuan dhunës. Dëshmti i tij fillestar që t'i fajësojë grupet e krahut të djathtë për përhapjen e dhunës, ka shkaktuar kritika të ashpra. Këto kritika kanë çuar që ai më 14 gusht në mënyrë të qartë i dënoi organizuesit e tubimit për racizëm dhe urrejtje, duke thënë se grupet e këtylla janë "të papranueshme për gjithçka që për ne si amerikanë është e çmueshme".

## Akuza të reja nga ambasadorja e SHBA, Haley

# Irani po e mbanë peng botën me largim nga marrëveshja atomike

Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara në Kombet e Bashkuara, Nikki Haley, tha mbrëmë se Irani po përpiqet ta "mbajë peng botën" duke u kërcënuar se mund të tërhiqet nga marrëveshja atomike e vitit 2015, për shkak të "sanksioneve dhe detyrimit" nga Shtetet e Bashkuara



Në këtë mënyrë, ambasadorja Haley u përgjigj ndaj komenteve të presidentit të Iranit, Hassan Rohani, i cili dje më herët gjatë ditës, tha se presidenti amerikan, Donald Trump, i cili ka imponuar disa raunde të reja të sanksioneve kundër Iranit, ka treguar se "nuk është partner i mirë" dhe i gatshëm ta zbatojë pjesën amerikane të marrëveshjes dhe se kjo mund të çojë në tërheqjen e Iranit nga përkushtimet për kufizimin e aktiviteteve atomike brenda "disa orëve". Ambasadorja Haley në deklaratën e saj në Kom-

bet e Bashkuara në Nju Jork, theksoi se sanksionet e Trumpit nuk ishin të ndërlidhura me marrëveshjen atomike, sipas së cilës Shtetet e Bashkuara dhe fuqitë botërore janë pajtuar për tërheqjen e pjesës më të madhe të sanksioneve ekonomike kundër Iranit. Më tutje, ajo tha se Teherani duhet të mbahet veta raketore, mbështetjen për terrorizëm, mosrespektim të të drejtave të njeriut dhe shkelje të rezolutave të Këshillit të Sigurimit të


Kombeve të Bashkuara. "Irani nuk mund të lejohet ta shfrytëzojë marrëveshjen atomike për ta mbajtur botën peng", tha Haley dhe ka shtuar se "marrëveshja atomike nuk duhet të bëhet shumë e madhe që të dështojë". Nikki Haley është shprehur se "Irani në asnjë rrethanë, asnjëherë nuk duhet të lejohet të ketë armatim atomik". Presidenti iranian, Hassan Rohani, dje më herët gjatë ditës u tha ligjvënësve në Teheran se administrata Trump duket se dëshiron të kthe-

het në periudhën para marrëveshjes atomike, pasi disa herë po përpiqet ta detyrojë Iranin të ndryshojë nëpërmjet taktikave të presionit, e jo të negociatave. "Përvoja e dështuar e sanksioneve dhe e detyrimit, e solli administratën e tyre të mëparshme në tryezën e negociatave", tha ai në një fjalim në Parlament, që u transmetua në televizion. "Nëse ata dëshirojnë të kthehen në këtë përvojë, atëherë definitivisht për një kohë të shkurtër, jo javë ose muaj, por në

shkallën e orëve dhe ditëve, ne do të kthehemi në situatën e mëparshme shumë më të fuqishëm", tha Rohani. Rohani tha se Donald Trump, prej se e ka filluar presidencën, i ka treguar botës se "nuk është partner i mirë", jo vetëm sa i përket marrëveshjes madhore atomike të vitit 2015, që njihet si Plan i Përbashkët Gjithpërfshirës Aksional (JCPOA), por edhe në marrëveshjet e tjera globale. "Popujt e botës, në muajt aktualë, qartazi kanë parë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës, veçanërisht nën presidencën e zotit Trump, i injorojnë marrëveshjet ndërkombëtare. Pos që shpeshherë dhe në mënyrë të vazhdueshme e shkelin marrëveshjen atomike, ato i kanë shkelur marrëveshjet prej Parisit, e deri te ajo me Kubën, pastaj prej marrëveshjes NAFTA e deri te ajo për Partneritet Trans-Paqësor. I ka demonstruar botës dhe bile edhe aleatëve se Shtetet e Bashkuara nuk janë partner i mirë", tha Hassan Rohani duke folur

në Parlamentin e Iranit. Zëdhënësjë e Departamentit amerikan të Shtetit, Heather Nauert, mbrëmë nuk i ka komentuar direkt deklaratat e Rohanit, por ka insistuar se Uashingtoni është plotësisht në harmoni me pjesën e saj të marrëveshjes atomike. Ajo, po ashtu, tha se Uashingtoni po e shqyrton politikën e vet ndaj Iranit dhe beson se marrëveshja atomike nuk i ka përfunduar "aktivitetet e tjera destabilizuese" të Teheranit në rajon. Më herët këtë muaj, zoti Trump ka vlerësuar se Irani nuk është në harmoni "me shpirtin" e marrëveshjes atomike, të cilën ai e ka përshkruar si "shumë të keqe". Marrëveshja me fuqitë botërore i mundëson Iranit lehtësim nga sanksionet ndërkombëtare për kufizim të aktiviteteve të tij bërthamore. Agjencitë monitoruese të Shteteve të Bashkuara dhe të Kombeve të Bashkuara, kanë thënë se Irani e ka respektuar marrëveshjen e vitit 2015.





Mes Lindjes dhe Perëndimit, një qytet magjepsës me ndërtime shumë inovative që meriton të vizitohet

# Tokio dhe arkitektura, një zhytje në horizontin e të ardhmes

Tokio është traditë, por mbi të gjitha inovacion dhe e ardhme, për këtë arsye metropoli japonez karakterizohet edhe nga një horizont i jashtëzakonshëm ndërtesash dhe grataçelash moderne dhe bashkëkohore, shpesh të karakterizuara nga forma të veçanta dhe të çuditshme. E ndërkohë që qeveria e Tokios, në pikëpamje të 2020, ka qëllim të vazhdojë me zhvillimin e grataçelave të shumta dhe të reja, thuhet me qindra, prezantojmë bërthamën e ndërtesave të apelit kulturor dhe turistik të kryeqytetit japonez. Sugjerimi për vizitorët është që të përfshijnë në planet e tyre të vizitave disa, jo të gjitha, nga arkitekturat me interes të madh, të realizuar nga arkitektë me famë botërore.

**MUZEU SUMIDA HOKUSAI** - mes ndërtesave të reja në qytet, më e reja është veçanërisht muzeu Sumida Hokusai, hapur muajt e fundit në lagjen e Sumidës, ku ka lindur në 1760, artisti japonez me famë botërore Ukiyoe, Katsushika Hokusai, i famshëm në perëndim për kontributin e tij në lindjen dhe përhapjen e stilit japonez në Europë. Një tjetër rëndësi kulturore e muzeut si koleksionist i operave të shumta origjinale që ilustronë rrugëtimin artistik të artistit, muzeu është vetë një ndërtesë me rëndësi arkitektonike bashkëkohore. Projekti është nën kujdesin e Kazuyo Sejima, një ndër arkitektet femra më të famshme të botës.

**PALLATI I PERLAVE** - një tjetër ndërtesë e rëndësishme gjendet në Ginza, qarku i butikut dhe luksit sipas përkufizimit, që mirëpret pjesën më të madhe të përqendrimit të ndërtesave arkitektonike eksperimentale të kryeqytetit japonez, shpesh të porositura nga brande të famshme ndërkombëtare. Mes këtyre Mikimoto Ginza 2, ndërtesa japoneze e Mikimotos, e specializuar për perla, për të cilat Japonia është e njohur në botë. Brandi është themeluar nga Kokichi



Mikimoto, burri i parë që perfeksionoi teknikën e kultivimit të perlave, dhe që në 1899 hapi dyqanin e parë, pikërisht në Ginza, Tokio, derisa u rrit dhe u bë furnizues i shtëpive reale botërore, nga ajo perandorake japoneze deri tek Shtëpia e Vërtetë Britanike.

**NË RRETHIN E SHOPPING** - jo shumë larg nga rrethi i Ginzës, gjendet rrethi i Aoyama, konsideruar një qendër në gjendje të bashkojë kul-

turën dhe modën, edhe kjo e karakterizuar nga butiqe të shumta dhe ikona e palleteve, si për shembull të mrekullueshmet Prada, Dior, e Todis Building. Gjatë një shëtitjeje shopping, do të jetë e pamundur të mos vësh re që mbi peizazhin urban të rrethit vazhdon kompleksi i dyqaneve dhe zyrave Ao Building, me 16 katet dhe 90 metrat lartësi.

**TREKËNDËSHI I ARTIT** - në qoftë se e gjeni veten duke vizituar rrethin

e Minatos, ku ndodhet e njohura Tokio Tower, ja vlen të vazhdosh drejt zonës së Roppongit për të vizituar edhe National Art Center, një nga hapësirat më të mëdha të llojit të tyre në Japoni, që bashkë me Mori Art Museum dhe Suntory Museum formohet kështu i ashtuquajtur "trekëndëshi i artit". Muzeu lind si hapësirë përshkruese inovative, jo i pajisur me një koleksion të përhershëm dhe votuar në evente dhe ngjarje spe-



cialë. Ndër vite ka mirëpritur edhe ekspozita shëtitëse nga artistët e mëdhenj ndërkombëtarë si Renoir, Salvador Dali, Alfons Mucha dhe shumë të tjerë.

**MUZEU I LE CORBUSIER** - gjatë një udhëtimi në Tokio, mos harroni edhe një vizitë, në Muzeun Kombëtar të Artit Perëndimor, në të cilën ndërtesa kryesore u përfundua në 1959 në operën e mastrit të racionalizmit Le Corbusier dhe në 2016 është

regjistruar në listën e "Aseteve të Humanistëve" UNESCO. Muzeu është pikë referimi për artin perëndimor në Tokio. Gjendet në brendësi të parkut Ueno dhe ja vlen ta vizitosh sepse përmban operat e artit perëndimor që shkojnë nga Tardo Medioevo deri tek mjeshtrit e mëdhenj të filimit të shekullit njëzet, mes të cilëve zambakët e ujit të Monet dhe skulpturat e rëndësishme të Rodin.





1 për qind e popullsisë botërore zotëron 40 për qind të pasurisë së planetit. Ja si jeton, ku jeton, çfarë bëjnë dhe si shpenzojnë paratë ajo pjesë e popullsisë kundër të cilës dhe në emër të 99 përqindështit tjetër "lufton" lëvizja "Occupy Wall Street"

"Mami, çfarë bëjnë gjithë këta njerëz në avionin tonë?". Djali i Jacqueline Siegel nuk arrinte ta shpjegonte dot, kur u gjend në radhë për të hipur në avion me shumë njerëz të panjohur (në klasin e parë). Ai ishte mësuar të udhëtonte me të atin në avionin privat të kompanisë. Mirë se erdhët në botën që i përket vetëm 1 për qind të njerëzve. Një kategori sociale që ka përfunduar nën vëmendjen publike falë lëvizjes "Occupy Wall Street": ajo që vetëpërcaktohet si "99 përqindëshi tjetër" dhe denoncon privilegjet e oligarkisë. Nëse jetoni në Manhattan, d.m.th. në zemër të protestës, cilat janë shenjat nga mund ta kuptoni se jeni pjesë e atij 1 përqindëshi? Ja 12 pikat që tregojnë atë që këta njerëz bëjnë në jetën e përditshme. Është një test empirik, prova e së të vërtetës që tradhton të privilegjuarit e vërtetë. E para: visheni gjithmonë me veshje "Made in Italy", me përjashtim të këpucëve "Louboutin", që i blini te Bergdorf Goodman në "Fifth Avenue". E dyta: darkoni te Masa (restoranti japonez me menynë pa çmime), "Per se", "Marea", "Babbo" dhe të paktën disa herë në vit merrni në shtëpi t'u gatujë shefi i kuzhinës së ndonjë restoranti superluksoz. E treta: keni abonim fiks në "Metropolitan Opera". E katërta: udhëtoni vetëm me "BusinessFirst", nëse nuk mund të arrini dot "Gulfstream". E pesta: nuk hipni kurrë në metro, madje edhe kur bie borë. E gjashta: frekuentoni rregullisht një "Spa-fitness", me masazhatorë dhe trajner personal. E shtata: jeni të abonuar në "Wall Street Journal". E teta: pushimet verore i bëni në Toskana,

# PASANIKËT, e përse janë gjithmonë e më të pasur



në Aspen për të bërë ski, dhe fundjavat nëpër resorte marramendëse. E nënta: fëmijët i keni në një shkollë private të tipit "Waldroff", ku shpenzimet nisin nga 30 mijë dollarë viti. Së dhjeti: asgjë kundër rrymës dhe një telefon me shërbimin e personalizuar "Wealth Management" të një banke të madhe. E njëmbëdhjeta: pallati ku ju banoni, apo vilat supergjigante duhet t'i ketë portierët të veshur me kostum super të shtrenjtë. E dymbëdhjeta: ju pëlqejnë gjithmonë qentë e bukur e të shtrenjtë që kujdestari personal i kafshëve tuaja jua sjell çdo mëngjes në "Central Park". Këto rregulla jetese për atë 1 përqindëshin e popullsisë, ndryshojnë vetëm pak nëse banoni në Kinë, vendi që sapo ka kaluar pranë një milionë milionerëve: pikërisht në Republikën Popullore "Burberry" i rriti shitjet e

tij me 34 për qind brenda gjashtë muajve, Zegna inauguroi dyqanin e tij numër 70, dhe shtëpia e ofertave Christie's shiti për katër milionë euro disa pistoletat të dinastisë Qing të punuara me flori në disa pjesë. Nuk ndryshon shumë as nëse jetoni në Brazil, ku fuqia blerëse e pasanikëve është aq e madhe saqë "Louis Vuitton" mban një çmim 100 për qind më të lartë se produktet e dyqanit të tij në Champs-Élysées. Po flasin për një pakicë të caktuar superpasanikësh? Atëherë menjëherë na shkon mendja te bankierët, manjaget e industrisë, yjet e spektakleve apo futbollit. Por jo vetëm kaq? Në SHBA, personat me një pasuri neto nga 1 deri në 5 milionë – pragu sipër të cilit klasifikohen si pasanikë të mëdhenj – janë plot 26,7 milionë. Të tjerë, rreth 2 milionë amerikanë kanë një pasuri që shkon

nga 5 deri në 10 milionë. Një milion të tjerë kanë nga 10 deri në 100 milionë. Së fundmi, vetëm 29 mijë fluturojnë sipër 100 milionë dollarëshit. Të gjithë së bashku bëjnë më shumë se gjyca e popullsisë së një vendi evropian, si Franca apo Italia. Nëse duam të qëndrojmë në përcaktimin e saktë të 1 për qindëshit, d.m.th. të atyre tre milionë amerikanëve, këtu pragu i hyrjes matet në bazë të të ardhurave. Të dhënat e "Internal Revenue Service" (Drejtoria Tatimore Amerikane) shënojnë kufirin e saktë: duhet të kesh një pagë të paktën 560 mijë dollarë në vit (375 mijë euro) për t'u futur në rrethin e tre milionë personave që përbëjnë 1 për qind të popullsisë amerikane. Në nivelin botëror, për të izoluar atë 1 për qind që qëndron në majë të piramidës, mjafton t'u rikthehesh statistikave

për pasurinë. "Global Wealth Report" i "Credit Suisse", tregon se këta pasanikë kontrollojnë 38.5 për qind të pasurisë botërore, dhe se të ardhurat e tyre janë rritur me 29 për qind vetëm për një vit: një shpejtësi kjo dyfish më e lartë se rritja e pasurisë së përgjithshme të planetit. Megjithatë, "Occupy Wall Street" denoncon një fenomen real, ata që qëndrojnë shumë lart, duke u distancuar gjithmonë e më shumë nga mazhoranca e popullsisë. Një studim magjepsës i historianëve Peter Lindert dhe Jeffrey Williamson tregon se asnjëherë më parë në histori, ai 1 për qind nuk zë përqindje kaq të madhe në pasurinë botërore. Në vitin 1774, kur ishte ende kolonializmi anglez dhe aristrokracia, 1 për qind e të privilegjuarve të "New England" kontrollon 9 për qind të totalit. Fisnikëria e asaj kohe jetonte në kushte

shumë herë më të mira se mesatarja, krahasuar me oligarkitë e reja të mijëvjeçarit të tretë. Por në historinë amerikane "zhvillimi" jo normal i mosbarazisë ka një datë të saktë lindjeje: vitin 1982. Jo rastësisht, bëhet fjalë për fillimin e epokës së Ronald Reagan kur nisën edhe sulmet sistematike ndaj Welfare State, pushtetit të sindikatave dhe politikave fiskale gjithmonë e më pak progresive. Pikërisht që prej vitit 1982, ai 1 për qind është distancuar nga të tjerët, është ngritur drejt stratosferës, ka zgjeruar distancat. Pikërisht këtë trajektore marramendëse të tyre ilustron kopertina e fundit e të përjavshmes "The nation": "Wall Street shpiku luftën e klasave". Kur ai koncept ishte bërë tabu tashmë në debatin politik amerikan, u afruan të pasurit dhe konfliktin social në shpërndarjen e burimeve e fituan ata. Por ka edhe nga ata që na kërkojnë të kemi mëshirë. Robert Frank në sagën "The High-Beta Rich" tregon historinë e familjes Siegel, atë të djalit që nuk arrin ta kuptojë se duhet të hipi në avion me njerëz të tjerë të panjohur. Pasi u bënë pasanikë në fushën imobiliare, dhe pasi ndërjuan "Versajen e SHBA"-së në Orlando, Florida (23 banja, një garazh për 20 makina, 2 kinema) iu sekuestrua nga banka kur tregu pësoi humbje duke i lënë me gisht në gojë. Gjithsesi, kriza ka dëshmuar qartë se të varfrit bëhen më të varfër, ndërsa të pasuarit akoma më të pasur. Amerika është vendi ku kjo duket më mirë se kudo tjetër.

## Ky është personi që mund të nisë luftën e tretë botërore

Tensionet mes SHBA-së dhe Koresë së Veriut janë në pikën më kritike, në një kohë kur të dyja vendet kërcënojnë me luftë. Por, ekziston një person që mund të jetë më i rrezikshëm nga sa duket. Ai shfaqet gjithmonë duke buzëqeshur dhe duke bërë shaka me vartësit, por është më i rrezikshëm nga sa tregon pamja e tij e jashtme. Gjenerali Kim Rak-gyom është "hija" e diktatorit koreano-verior Kim Jong Un, shkruan "Daily Mail". Sipas tabloidit britanik, ai është shefi i komandës raketore të Koresë së Veriut dhe besohet të jetë përgjegjës për lëshimin e raketave balis-



tike, vetëm duke shtypur "butonin". Që prej vitit

2012, Gjenerali Kim Rak-gyom drejton komandën

raketore dhe gjithmonë shfaqet prapa krahëve të



Kim Jong Un gjatë testimi të raketave balistike. Deklaratën e Presidentit Trump që kërcënoi Korenë Veriore me "zjarr dhe tër-

bim", Kim Rak-gyom e cilësoi si të pakuptimtë. Ai tha se Koreja e Veriut planifikon të lëshojë 4 raketa në të njëjtën kohë në ishullin Guam (territori i SHBA), që do të duhet ekzaktesisht 17 minuta e 45 sekonda për ta goditur. Gjenerali Kim Rak-gyom shihet shpesh në fotot e shpërndara nga regjimi diktatorial kur Kim Jong Un teston raketat, por për të dihet shumë pak. Koreja e Veriut ka deklaruar se është duke përgatitur planin për të goditur ishullin Guam ku ndodhet një bazë ushtarake e SHBA, dhe kjo gjë, sipas shtetit komunist, do të ndodhë në mes të gushtit.





## Jeta sekrete e Kim Jong-un

Në 50 vjetët e fundit bota “disi është mësuar” me kërcënimet që vinin nga Koreja Veriore, por me ardhjen e Kim Jong-un në pushtet ato kanë marrë formë të ashpër. Pas shumë testeve nukleare dhe raketore, me të cilat është dëshmuar se Koreja Veriore ka zhvilluar teknologjinë me të cilën mundet që përmes raketave nukleare të goditen caqet e largëta me mijëra kilometra, Kim Jong-un ka kërcënuar edhe me testin, në të cilin katër raketa do të fluturojnë mbi Japoninë dhe do të bien në deti 30 kilometra larg ishullit amerikan Guam me 160.000 banorë, në të cilin ndodhet baza e madhe ajrore luftarake amerikane. Një test i tillë sigurisht se do të shkaktonte reagimin ushtarak të SHBA-ve, gjë e cila do të shkaktonte luftë të hapur ndërmjet dy Koreve, shkruan gazeta kroate “Veçernji list”. Kjo mund të çojë deri të rënia e regjimit veri-korean, por nëse Kim do ta bëjë këtë, aktualisht nuk mund të vlerësohet, pasi që pothuajse asgjë nuk dihet në tërësi për të, thuhet më tej në tekstin e gazetës. Kim Jong-un është i lindur më 8 janar, por publiku nuk e di saktë se në cilin vit, 1982, 1983 ose 1984. Nëna e tij është Ko Jong Hui, e dashura e Kim Jong Il, me të cilën ka pasur edhe dy fëmijë. Kim Jong-un në fëmijërinë e hershme më tepër kishte kaluar kohën me nënë e


**“Asnjëherë Kim-ët nuk ishin mjet i Moskës ose Pekinit, dhe sidomos tash kur është në pushtet Kim Jong-un, i cili është më pak racional se sa babai i tij. Kim zhvendos kufijtë, por jo deri në atë masë sa do të vinte deri te shpërthimi i gjithë situatës. Kjo nuk do të thotë se ai punon me urdhra të Kinës, apo Rusisë”, konsideron analisti Tvrtko Jakovina, shkruan “Veçernji list”**

tij dhe nuk ishte paraparë që të marrë udhëheqjen e ushtrisë. Por, atij i është plotësuar çdo dëshirë në një jetë luksoze dhe pasuri. Qysh në moshën shtatë vjeçare ai u bë me automobil dhe nisi të pi vodkë në moshën 14-vjeçare, dhe gjatë rinisë së tij ishte ndër tjerash, i rrethuar me femra, të cilat babait të tij i shërbenin për “argëtim”. “Kur ishte shtatë vjeç nisi të vozisë veturë dhe ajo ishte “Mercedes”. Që nga ajo kohë i adhuron “Mercedes-at” thotë Kenji Fujimoto, i cili kishte ikur nga rezidenca e Kim, por edhe nga Koreja Veriore, para disa vjetësh. Pas shkollimit filor në Korenë Veriore, Kim Jong-un shkollimin e mesëm e kreu në Zvicër. Atje ishte i paraqitur me emrin Pak Un, si djali i një diplomati veri-korean në ambasadën e atjeshme. Miqtë e tij nuk

kishin dijeni se bankën e shkollës po e ndanin me liderin e ardhshëm të Koresë Veriore. “Kishte sens për humor, nuk dilte shpesh në qytet, por adhuronte sportin dhe ishte argëtues”, thotë Marko Imhof, ish-shok i klasës. Pas përfundimit të shkollimit në Bernë, Kim Jong-un kthehet në vitin 2007 në atdhe, ku vazhdon shkollimin në akademinë ushtarake. Gjatë kësaj kohe, gjysmë-vëllai i tij, i cili ishte paracaktuar që të marrë drejtimin e shtetit, ra në mëshirën e babait, dhe Kim Jong-un u caktua të jetë lider i ri i shtetit. Ai mori gradën gjeneral dhe kur babai i tij Kim Jong Il vdiq në vitin 2011 në rrugë drejt Rusisë, Kim Jong-un u bë lideri i shtetit më të mbyllur në botë. Shtrohet pyetja nëse Kim Jong-un në fakt është marionetë e Pekinit dhe Moskës, përmes të cilit ata testojnë SHBA për të parë se deri në cilët kufij mund të shkojë vendosmëria e administratës Donald Trump. “Asnjëherë Kim-ët nuk ishin mjet i Moskës ose Pekinit, dhe sidomos tash kur është në pushtet Kim Jong-un, i cili është më pak racional se sa babai i tij. Kim zhvendos kufijtë, por jo deri në atë masë sa do të vinte deri te shpërthimi i gjithë situatës. Kjo nuk do të thotë se ai punon me urdhra të Kinës, apo Rusisë”, konsideron analisti Tvrtko Jakovina, shkruan “Veçernji list”.







Skuadra Tetovare sonte ballafaqohet me gjigandin italian

# E njohim Milanin, por Shkëndija do të shfaq më të mirën

Të vënë para reputacionit dhe historisë së klubit italian, tre lojtarët shprehen me respekt për Milanin, por theksojnë se Shkëndija do të jap më të mirën nga vetja. Kapitani Adrian Cuculi thotë se Shkëndija për dy vite me radhë luan në play-off dhe kjo nuk është e rastësishme, ndërsa thekson se në Milano kemi ardhur të tregojmë lojën tonë më të mirë dhe të prezantojmë futbollin e Maqedonisë në mënyrën më të mirë të mundshme

Nga Milano,

Koha Vedat MEMEDALIU

Milano, 16 gusht - Një ditë para ndeshjes historike të Shkëndijës në fazën e play-off të Ligës së Evropës ndaj Milanit, tre futbollistët kuqezi, Ardian Cuculi, Armend Alimi dhe Kostadin Zahov në një dalje para gazetarë kanë shfaqur qëndrimet e tyre para sfidës kundër gjigandit italian. Të vënë para reputacionit dhe historisë së klubit italian, tre lojtarët shprehen me respekt për Milanin, por theksojnë se Shkëndija do të jap më të mirën nga vetja. Briefingu është mbajtur në ambientet e hotelit Melia në Milano, ku edhe është e vendosur skuadra tetovare. Kapitani Adrian Cuculi thotë se Shkëndija për dy vite me radhë luan në play-off dhe kjo nuk është e rastësishme, ndërsa thekson se në Milano kemi ardhur të tregojmë lojën tonë më të mirë dhe të prezantojmë futbollin e Maqedonisë në mënyrën më të mirë të mundshme. "Normalisht kemi një sfidë të vështirë, është raundi i katërt "play-off" i



**Kapiteni Adrian Cuculi thotë se Shkëndija për dy vite me radhë luan në play-off dhe kjo nuk është e rastësishme, ndërsa thekson se në Milano kemi ardhur të tregojmë lojën tonë më të mirë dhe të prezantojmë futbollin e Maqedonisë në mënyrën më të mirë të mundshme.**

Liga Europa. Dy vite me radhë po e bëjmë këtë hap, përsërisim këtë rezultat dhe nuk është kjo gjë rastësi. Dominimi ynë në ndeshjet e deritanishme të zhvilluara në kuadër të Liga Europa, fati ynë deshi që tash të ndeshemi me Milanin. Një skuadër që nuk donë shumë fjalë, një skuadër me kualitet shumë të lartë në futbollin evropian. Ne këtu në Milano kemi ardhur për të

## MILAN I KTHEN PËRGJIGJE SHKËNDIJËS PËR VIDEON

E mrekullueshme video e Shkëndijës së Tetovës që postoi në faqen e saj zyrtare në Facebook, një video dedikuar Milanit, kundërshtarit në fazën "play-off" të Europa League, ku bënte një krahasim me humor mes dy skuadrave dhe dy qyteteve. Gjetja gjeniale e tetovarëve për të ndezur atmosferën para ndeshjes së parë në "San Siro" bëri xhiron e internetit dhe u prit shumë mirë nga gjithë opinioni sportdashës. Disa orë pas postimit të videos nga Shkëndija, erdhi dhe reagimi i faqes zyrtare të Milanit në Facebook. Kjo e fundit komentoi në postimin e Shkëndijës duke përshëndetur shpirtin e garës së treguar nga kuqezinjtë shqiptarë: "Përshëndetje KF Shkëndija. Treguat shpirt të madh të rivalitetit të shëndetshëm. Do të jetë një kënaqësi t'ju presin të enjten në San Siro. Shihemi miq", shkruan komenti i Milanit.



prezantuar sa më mirë dhe në mënyrë dinjitoze futbollin e Maqedonisë dhe normalisht duke e dhënë më të mirën tonë dhe duke bërë që Shkëndija në këtë ndesh-

je të dalë sa më mirë. Nuk kemi gjë për të humbur, thjeshtë vijmë të bëjmë punën tonë dhe në fund të shpresojmë në një rezultat të mirë", tha Ardian Cuculi, i cili është i vetëdi-

jshëm për kualitetin që posedon skuadra kundërshtare. Armend Alimi, lojtari që theu Vardarin Vikendin e kaluar në Tetovë gjithashtu u shpreh optimist para ndesh-

## MILANI KUNDËR SHKËNDIJËS DËSHIRON REKORD TË RI

"Milani" ka përsëritur të martën thirrjen drejtuar tifozëve Rosonerët të tyre që të vijnë në numër sa më të madh të enjten në ndeshjen kundër Shkëndijës së Tetovës, e vlefshme për turin e parë të fazës së play-off të Ligës së Europës. Në faqen zyrtare të klubit të famshëm italian, "Milani" njofton se deri të martën janë shitur rreth mijë 25 bileta, ndërsa u kërkon Rosonerëve të arrijnë në 80.000 tifozë dhe me këtë, të thyejnë rekordin prej 65.763 në "San Siro". "Kundër Krajovës ishit 65.763. Zëri juaj u dëgjua në minutën e 94-të të lojës, duke ndihmuar ekipin të kalojmë pengesën e parë drejt grupës së LE-së. Tani përballemi me Shkëndijën, sfidë që nuk duhet nënçmuar sepse kundërshtari ynë ka kaluar tre runde eliminatorë, duke treguar e fortë në mbrojtje. Sfidë që nuk duhet lëshuar, pasi paraqet edhe debutimin e Bonuccit në San Siro. Zgjedhni vendin tuaj. Janë 25.000 rosonerë që kanë blerë bileta. Le të bëhemi 80.000 dhe në San Siro të brohorasim bashkë "Forca Milan", thuhet në thirrjen e Milanit drejtuar tifozëve Rosonerët.

jes. "Atmosfera në San Siro nuk duhet të jetë një pengesë për ne, por do të na motivojë më shumë për lojë më të mirë. Kuptohet disa gjëra varen edhe nga kundërshtari", tha Alimi. Edhe portieri kuqezinjve, Konstandin Zahov, është optimist. Ai thotë se strategjia e lojës do të koncentrohet në mbrojtje dhe duke krijuar mundësi në kundërsulm. "S'kemi ardhur këtu me flamur të bardhë, nuk kemi se çka të humbim. Do të jemi nën presion, nuk guxojmë të bëjmë gabime, do të përpiqemi me kundërsulme të shënojme gol", shtoi portieri Zahov. Takimi në stadiumin San Siro do të luhet të enjten (sonte) me fillim prej orës 20:45.

## VIDEOJA E SHKËNDIJËS BËHET VIRALE NË RRJETET SOCIALE

Në prag të ndeshjes më të rëndësishme ndonjëherë, ekipi shqiptar e ka prezantuar veten në një mënyrë interesante të rivalit e vet. Në videon e çuditshme, që është bërë virale në rrjetet sociale duke arritur mbi 100 mijë klikime në orët e para të publikimit, kuqezinjtë tetovarë u tregojnë atyre milanezë disa gjëra të veçanta për veten dhe vendin nga vijnë, e mbi të gjitha për vjetërsinë e qytetit të tyre. Mes tjerash, zikuqve italianë u bëhet e ditur se Tetova ka objekte goxha më të vjetra fetare e kulturore, krahasuar me Milanon. Videoja kreative e Shkëndijës përmban edhe momente humoristike. Videon e Shkëndijës për ndeshjen kundër Milanit e ka bërë studio "Ikona" nga Prishtina, ndërsa është realizuar nga Ismail Kaqiku. Ja përmbajtja e videos: "I dashur Milan! Ne jemi Shkëndija e Tetovës. Nga qyteti që u themelua 1000 vite përpara lindjes së Krishtit! Ju keni Piazza D'Uomo në Milano, por ne kemi xhaminë që është më e vjetër se sa sheshi juaj! Ne e pranojmë që tetovarët marrosen pas Monika Beluçit, por edhe shume italiane vazhdojnë të çmenden pas Blerim Destanit! Italianet bien në dashuri dhe zemra e tyre thyhet lehtësisht, por ne mund t'iu ofrojmë kardiologun Omer Xhemali! Ju keni pastat më të mira në botë, por ne kemi shefin më të mirë: Rene Rexhepi! Ju keni stadiumin me 80 mijë vende, por ne kemi qytetin me 100 mijë banorë! Lojtaret tuaj vlejné më shumë se sa 330 milionë euro, por qetësohuni. Tanët vlejné 400 milionë denarë! Ju dërguat agjentë për të na vëzhguar, ndërsa ne kemi agjentë që ju shohin gjithë vitin! Vëmë një bast? Tetova ka më shumë kuqezinj se sa Milano, Roma dhe Torino së bashku! Ju jeni ekipi i dytë në botë për trofe, ndërsa ne jemi ekipi i parë në shqiptari për trofe! Ju shkuat deri në Kinë për te gjetur sponsorin, ndërsa ne kemi sponsor ekologjik në Tetovë, lider botërorë në fushën e tyre! Zemrat e tetovarëve dhe e të gjithë shqiptarëve do të rrahë kuqezit të enjten në mbrëmje! Shihemi Miq!





Berisha tek Anzhi për 600 mijë euro dhe së fundmi Liridon Latifi te Pushkash për 930 mijë euro, tashmë pret që të arkëtojë edhe nga Bakari Nimaga

# Ofertë ruse për Nimagën, Takaj e refuzon dhe i vendos çmimin mesfushorit

Skënderbeu nuk do të ndalet. Pas Olainkës që shkoi te Genti për 1.1 milionë euro, Berisha tek Anzhi për 600 mijë euro dhe së fundmi Liridon Latifi te Pushkash për 930 mijë euro, tashmë pret që të arkëtojë edhe nga Bakari Nimaga. Prezantimi i mirë në ndeshjet eliminatorë të Europa Ligës dhe mbi të gjitha goli ndaj kazakëve të Kairat Almatit ka bërë që mesfushori të vihet nën "lupën" e klubeve të huaja. Dhe nuk bëhet fjalë për dëshirë, por për ofertë konkrete. Në krye të listës mësohet se është një skuadër ruse, e cila renditet në mesin e tabelës. Mendohet të jetë Urali, por asgjë nuk është e konfirmuar zyrtarisht. Burime për gazetën "Panorama Sport" bëjnë me dije se javët e fundit ekipi rus ka ardhur në dyert e klubit korçar me një ofertë



zyrtare.

Nuk bëhet e ditur se sa janë gati që të japin, por burime të sigurta të gazetës bëjnë me dije se presidenti Takaj e ka kthyer mbrapsht, pasi nuk është "tunduar" nga shifrat. Ai, madje, i ka vendosur edhe çmimin malienit. Pa 700 mijë euro Nimaga nuk shitet. Jo vetëm kaq,

pasi drejtuesi më i lartë i Skënderbeut pret që të ruajë edhe vlerën e kartonit, por ky detaj mbetet për t'u diskutuar, pasi varion nga 10 deri në 20, si në rastin e Latifit. Kjo kërkesë duket se e ka "ngjirë" paksa tratativën, por as e mbyllur nuk mund të quhet, pasi rusët mund të rishikojnë ofertën.

Në prononcimin e tij për gazetën një ditë më parë, presidenti i korçarëve, Ardjan Takaj, la gjithçka të hapur për këtë çështje, ndërsa tha: "Nuk besoj se do të ketë më shitje, por asnjëherë nuk i dihet".

Megjithatë, mbetet për t'u parë se çfarë do të ndodhë në ditët në vijim në lidhje me këtë çështje. Skënderbeu deri tani ka treguar se është një klub shumë i organizuar dhe gjërat funksionojnë mirë. Ka ende edhe disa ditë deri në mbylljen e merkatos dhe gjithçka mund të ndodhë. Ajo që pret klubi i Skënderbeut është që Nimaga të bëjë edhe dy paraqitje të shkëlqyera në ndeshjet ndaj Dinamos së Zagrebit për të tërhequr më shumë vëmendjen, por mbi të gjitha për të justifikuar vlerën e kërkuar nga Skënderbeu për kartonin e tij.

## Coutinho refuzon të luajë për Liverpoolin

Philippe Coutinho raportohet se është duke u përgatitur që të mos luajë për Liverpoolin nëse klubi nuk e shet te Barcelona. 25-vjeçari besohet se me çdo kusht dëshiron kalimin te gjiganti spanjoll që së fundmi ka arkëtuar 220 milionë euro nga shitja e Neymarit te Paris Saint-Germaini dhe është në kërkim të zëvendësuesit të tij. Javën e kaluar Liverpooli insistoi se braziliani nuk do të shitet, por anëtori është duke detyruar shitjen te Barça. Mundo Deportivo raporton se Coutinho nuk do të luajë as një ndeshje për Liverpoolin këtë sezon, edhe nëse atij nuk i ofrohet mundësia që të përfshihet në përfaqësuesen e Brazilit për Botërorin "Rusia 2018".



## Sharapova pjesëmarrëse në turneun e hapur në Nju Jork

Tenistja ruse, Maria Sharapova, pesë herë fituese e turneve Grand Slam, është ftuar të jetë pjesëmarrëse e turneut të hapur të Shteteve të Bashkuara në Nju Jork. Organizuesit e turneut thanë mbrëmë se ish-tenistja më e mirë në botë, Maria Sharapova, që është kthyer në terren këtë vit, pas vuajtjes së dënimit me 15 muaj moslojë për shkak të dopingut, ishte njëra prej të jetëve të turneut të hapur të Shteteve të Bashkuara në Nju Jork. Organizuesit e turneut thanë mbrëmë se ish-tenistja më e mirë në botë, Maria Sharapova, që është kthyer në terren këtë vit, pas vuajtjes së dënimit me 15 muaj moslojë për shkak të dopingut, ishte njëra prej të jetëve të turneut të hapur të Shteteve të Bashkuara në Nju Jork.



Ndërkombëtare e Tenisit. Prej se është kthyer në arenën e tenisit në muajin prill, asaj i janë dërguar ftesa të veçanta (e ashtu quajtura "wild card") për të luajtur në turne të ndryshme, dhe kjo mënyrë e angazhimit të saj është kritikuar nga kolegët profesionistë. Por, tenistja 30 vjeçare, në

turneun French Open, nuk e kishte këtë privilegj, prandaj nuk ishte aktive disa javë. Për shkak të lëndimit të këmbës nuk mori pjesë as në turneun Wimbledon në Londër. Turneu i hapur i Shteteve të Bashkuara filon më 28 të këtij muaji dhe përfundon më 10 shtator.

## Kosova me sy nga Tallini

Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll po vazhdon përgatitjet për ndeshjen e së shtunës. Por rëndësinë e vërtetë të sfidës ndaj Estonisë, basketbollistët kosovarë do ta kuptojnë vetëm të mërkurën (sot) në mbrëmje, pasi të përfundojë ndeshja mes Estonisë dhe Maqedonisë. Kjo ndeshje luhet në Tallin të Estonisë nga ora 17:30 dhe prej saj varet shumë kualifikimi i Kosovës. Lojtarët e Kosovës do të bëjnë tifo për Estoninë pasi me fitore eventuale të saj gjasat që Kosova të kalojë me



sukses parakualifikimet për botërorin e vitit 2019 do të jenë më të mëdha. Në një situatë të tillë, pra nëse Estonia fiton ndaj Maqedonisë, Kosovës i

mjafton fitorja për të shkuar tutje. Nëse Maqedonia eventualisht e mposht Estoninë, atëherë gjasat e Kosovës do të jenë shumë të vogla.

Publicitet

## F1, synohet gara e tretë në Amerikën Latine

Cirkuiti automobilistik i Buenos Airesit ka pritur plot 20 gara emocionuese të Formulës 1, por pas një shkëputjeje prej thujse dy dekadash, drejtuesit e kampionatit spektakolar mund ta rikthejnë sërish në axhendë. Ndalea argjentinase e garave ka qenë që prej vitit 1953 deri në 1998-n, por mund të jetë pjesë e kalendarit ndoshta sërish pas dy vitesh. Drejtori i garave të Formulës 1, Charlie Whiting kompletoi një inspektim informal të kryeqendrës në Amerikën Latine, për të vlerësuar kapacitetet dhe gjendjen aktuale të pistës dhe ndërtesave përreth. Sipas medieve argjentinase, delegacioni u shpreh



i kënaqur me gjendjen aktuale, duke lënë të kuptohet se mund të ketë një garë të Formulës 1 në vitet e ardhshme. "Liberty Media", që zotëron të drejtat komerciale të Formulës 1, ka nënvizuar gjithmonë se është në favor të një kalendarit me më shumë se 21 gara sezonale. Kjo ka ngjal-

lur interesin e shumë vendeve për të pritur një ndalesë të F1-shit, mes të cilave edhe Portugalia e Turqia. Por Argjentina po bën hapa konkretë dhe, nëse finalizohet, kjo do të jetë ndalesa e tretë e Botërorit në Amerikën Latine, pas Brazilit dhe Meksikës.

**REPUBLIKA E MAQEDONISË**  
**KOMUNA E KUMANOVËS**

**Sektori për urbanizëm, veprimtari komunale dhe mbrojtje të mjedisit jetësor dhe natyrës**

21-3946/8  
Të datës 11.08.2017

Në bazë të nenit 35 paragrafi 3 të Ligjit për planifikim hapësor dhe urbanistik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16), nenit 50 paragrafi 1 pika 4 e Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 5/02) dhe nenit 25 paragrafi 1 pika 7 e Statutit të Komunës së Kumanovës ("Fletorja zyrtare e Komunës së Kumanovës" nr. 13/03, 13/07 dhe 8/15), Kryetari i Komunës së Kumanovës në vijim publikon këtë:

**LAJMËRIM**

Për organizim të Anketës publike dhe Prezantimit publik në lidhje me

1. Projekti arkitektonik urbanistik i PK 171/1 me qëllim V1 arsim dhe shkencë, fshati Çerkez KK Fshati Çerkez – Kumanovë

Anketa publike dhe Prezantimi publik në lidhje me Propozim PDU-të do të realizohet përmes prezantimit të Propozim PDU-ve në Sirtarët e komunës në Sheshin e qytetit që gjendet tek ish "Tutun" – Kumanovë.

Anketa publike do të zgjasë 5 ditë pune duke filluar prej më 22.08.2017 deri më 29.08.2017.

Për kohëzgjatjen e anketës publike subjektet e interesuara fizike dhe juridike informacione më të detajuara mund të marrin në Komunën e Kumanovës, Sektori për urbanizëm dhe veprimtari komunale dhe mbrojtje të mjedisit jetësor dhe natyrës. Gjatë anketës publike propozimet ose vërejtjet e tyre të gjitha subjektet e interesuara fizike dhe juridike mund të parashtrijnë në letrat anketuese..

**PREZANTIMI PUBLIK**

Më datë 25.08.2017 në ora 12<sup>00</sup>, në sallën e mbledhjeve në Komunën e Kumanovës organizohet Prezantimi publik me prezantim profesional të Projektit arkitektonik urbanistik të PK 171/1 me qëllim V1 arsim dhe shkencë, fshati Çerkez KK Fshati Çerkez – Kumanovë, dokumentacioni teknik nr. U-02/17 të përpiluar nga "URBAN GIS" SHPK – Kumanovë

Kryetari i Komunës  
Zoran Damjanovski

**Shitet tokë në Shkup, gjendet në Konjare të poshtme;**  
PK 426, vendi i quajtur Karalti, me sipërfaqe prej 1612m<sup>2</sup>, e regjistruar ne Flet pronësi nr. 162 për KK Konjare e poshtme, pronësi e Velida Ramadanovska;  
PK 424 vendi i quajtur Gllumovo, me sipërfaqe prej 127m<sup>2</sup> dhe PK 424 vendi i quajtur Gllumovo, me sipërfaqe prej 4267m<sup>2</sup> e regjistruar ne Flet pronësi nr. 226 për KK Konjare e poshtme, bashkëpronësi e Amira Trublanin.

**Të interesuarit dhe të gjithë atë që kufizohen me parcelat ne fjalë, ofertat e tyre mund ti paraqesin ne zyrën e Noterit Mahir Ziberit, rr. Butelska nr. 4, Shkup-Butel.**





Reagon seleksionuesi i karatesë U21, Arlind Huseini

# “Azra Curri nuk i plotësoi kushtet”

Siç bëri të ditur Arlind Huseini, fakti i marrjes së titullit kampione shtetërore plotëson kushtin e reprezentimit të Maqedonisë, mirëpo, pasohet edhe me dy gara tjera seleksionuese

Shkup, 16 gusht - Në lidhje me rastin e karateistes Azra Curri, seleksionuesi i U21 Arlind Huseini tha se rasti i mosshkruarjes së saj në Kampionatin Botëror në Spanjë nuk vjen si pasojë e diskriminimit dhe padrejtësive, por si rezultat i mospërbushjes së kriterëve të cilat parashihen për seleksionim të reprezentuesve nga Federata e Karatesë së Maqedonisë, njofton Portalb.mk. Siç bëri të ditur Arlind Huseini, fakti i marrjes së titullit kampione shtetërore plotëson kushtin e reprezentimit të Maqedonisë, mirëpo, pasohet edhe me dy gara tjera seleksionuese. “Ne nuk i seleksionojmë kandidatët por që



kemi kriterë në bazë të së cilave bëhet ajo. Kemi disa gara që vetvetiu e bëjnë selektimin e garuesve. Duke i kaluar këto gara kandidatët selektohen vetë. Është e qartë se marrja e titullit kampione shtetërore i jep përparësi pjesëmarrjeje në Federatën Botërore të Karatesë e cila mbahet në Spanjë, por që krahas asaj janë edhe dy gara seleksionuese të cilat kandi-

datëve u mundëson grumbullimin e pikëve. Problemi nuk është se ka të bëjë me diskriminim siç u interpretuar në opinion por se nuk i ka plotësuar kriteret të cilat i kërkoi Federata e Karatesë në Maqedoni”, tha Huseini. Edhe pse në kategorinë e Azrës nuk ka asnjë përfaqësues i cili i plotëson kushtet, sërish Maqedonia nuk merr pjesë me kategorinë e saj në Span-

jë. Në lidhje me këtë për Portalb.mk Huseini u shpreh kështu: “Meqë Azra nuk arriti ti plotësojë kushtet për reprezentim të Maqedonisë, nuk ka tjetër që i ka plotësuar, kategoria e saj ngelet e zbrazët dhe Maqedonia nuk përfaqësohet në Spanjë. Secili i cili do të arrijë të fitojë katër ndeshjet seleksionuese pas marrjes së kampionatit shtetëror do të ketë mundësi të përfaqësojë Maqedoninë në Spanjë”. Siç bëri të ditur Huseini, në kategorinë e U21 vetëm Azra Curri dhe një maqedonase nuk i plotësojnë kushtet. Përndryshe, pasi që Federata e Karatesë së Maqedonisë (FKM) nuk e ftoi Azra Curri që të jetë pjesë e reprezentacionit për Kampionatin Botërorë për kadetë, junior dhe junior deri në 21 vjeç, që do të mbahet në Tenerife të Spanjës (25 deri 29 tetor), ajo dhe prindi i saj sollën vendimin që të tërhiqet nga sporti i karatesë, ndërsa trajneri i saj, ish-kampioni evropian, dolën me një reagim për vendimin e palogjikshëm të federatës.

## Kur qengji puth sportisten më të mirë shqiptare në Mal të Zi

Një foto sa një mijë fjalë. Hendbollistja më e mirë shqiptare në Mal të Zi, Dijana Ujkiq, që luan për kampionin e shumëfish të malazez, Budućnostin e Podgoricës dhe për kombëtaren e Malit të Zi, ka befasuar me një fotografi atraktive. Dijana dëshmoi se ka dashuri ndaj kafshëve sidomos ndaj qengjit, ku shihet duke përqaftuar atë. Shihet edhe qengji se si e puth në qafë hendbollistja ka respektin e pamasë për kafshë dhe i adhuron shumë ato, por ndërkohë ka mendjen se si të përgatitet me ekip për garat në Mal të Zi dhe në Champions League.



## Zyrtare: Futbollisti i Tiranës firmos në Spanjë

Talenti i Tiranës, Elvi Berisha, më në fund ka firmosur në Spanjë, për Leganes. Klubi i Primeras është bindur nga paraqitjet e mira të mesfushorit 18-vjeçar, i cili qëndroi disa kohë në provë me Leganes B. Sot Berisha ka firmosur, duke u transferuar përfundimisht në Spanjë, ku

bëhet shqiptari i dytë aty, pas Keidi Bares, raporton Sport Ekspres. Për momentin Berisha do të luajë te Leganes B, ndërsa më pas do të jetë në dorën e tij gjithçka, sepse paraqitjet e mira mund t'i hapin dyert e ekipit të parë herët a vonë. Ndërkaq, Tiranës i takojnë 90 mijë euro si klubi mëmë.



Hidhet shorti i Kategorisë së Parë

# Tirana e Dinamo synojnë Superiore

Bardheblutë kanë mësuar edhe kalendarin sesi do të përballen në grupin B, ku ata bëjnë pjesë, në 3 fazat e Kategorisë së Parë. Një grup ku do të shmanget derbi me Dinamon, në grupin A të Kategorisë së Parë, por nuk mungojnë skuadrat e tjera konkurruese dhe me më shumë eksperiencë

Në vitin e 97 të historisë së saj, skuadra e Tiranës do të luajë në Kategorinë e Parë, për herë të parë në histori. Bardheblutë kanë mësuar edhe kalendarin sesi do të përballen në grupin B, ku ata bëjnë pjesë, në 3 fazat e Kategorisë së Parë. Një grup ku do të shmanget derbi me Dinamon, në grupin A të Kategorisë së Parë, por nuk mungojnë



skuadrat e tjera konkurruese dhe me më shumë eksperiencë në këtë kategori inferiore sesa bardheblutë, që do t'ia vështirësojnë jo pak kampionatin. “Shorti ishte i

vështirë, duke qenë se ka skuadra të forta edhe në këtë kategori, që mund të na pengojnë në synimin tonë për t'u rikthyer menjëherë në Superiore. Do të shohim se çfarë do të

ndodhë me skuadrën, me largimin dhe afrimin e lojtarëve, por gjithçka do të jetë gati”, tha Gerti Dajçi, drejtor i klubit Tirana. Me të njëjtin objektiv për t'u rikthyer në Superiore do

“Ndeshjet e Kategorisë së Parë fillojnë më 16 shtator, një javë pas fillimit të Superiores. Në të marrin pjesë 20 skuadra të ndara në dy grupe, A dhe B, ku fituesja e secilit grup ngjitet në Kategorinë Superiore

të rifillojë këtë sezon 2017-2018 edhe Dinamo, e cila pavarësisht dëshirës të saj dhe të sportdashësve për të qenë sërish në elitën e futbollit shqiptar, mundësitë duken modeste. “Do të preferoja të kishim edhe Tiranën në grupin tonë për të luajtur një derbi, sepse derbi është gjithmonë një ndeshje e bukur. Megjithatë do të përpiqemi maksimalisht

për t'u ngjitur në Kategorinë Superiore. Për momentin kemi lojtarë të rinj, por do të bëjmë sërish merkato”, tha Igli Allmuça, trajner i klubit Dinamo. Ndeshjet e Kategorisë së Parë fillojnë më 16 shtator, një javë pas fillimit të Superiores. Në të marrin pjesë 20 skuadra të ndara në dy grupe, A dhe B, ku fituesja e secilit grup ngjitet në Kategorinë Superiore.





Komisioni për Ankesa i Federatës së Futbollit të Spanjës e ka hedhur poshtë të mërkurën ankesën e Real Madridit kundër pezullimit me 5 ndeshje të Cristiano Ronaldos, vendim i marrë nga gjyqtari i vetëm i Kodit Disiplinor, pas dëbimit të tij me karton të kuq të dielën, në ndeshjen e parë të Superkupës së Spanjës, lujatur në "Camp Nou".

# Kuqezinjtë protagonistë në sezonin e ri të Serie A

Elseid Hysaj, Etrit Berisha, Thomas Strakosha, Arlind Ajeti dhe Berat Gjimeshi, janë këtë 5 shqiptarët e Serisë A të cilët pritet të kenë një rol protagonist në sezonin e ri të futbollit italian. 4 të parët konsiderohen titullarë të padiskutueshëm në skuadrat e tyre respektive ndërkohë që edhe Berat Gjimeshi do të ketë hapësirat e tij tek Benevento ku do të kërkojë konfirmohet pas një sezoni shumë pozitiv te Avellino në Serinë B. Të Shtunën ngre siparin edicioni futbollistik 2017-2018 i Serisë A italiane një ekskluzivitet i Supersport ku të gjitha shqiptarët do të kenë mundësinë të shijojnë magjitë që dhurojnë mes shtyllave dy portierët e kombëtares kuqezij, Etrit Berisha dhe Thomas Strakosha, klasin e Elseid Hysajt, forcën e Arlind Ajetit dhe dëshirën për të spikatur të Berat Gjimeshit.

I pari që do të zbresë në fushë do të jetë Hysaj me Napolin e tij që të Shtunën në mbrëmje do të sfidojë Vernonën në transfertë. Të Kaltrit janë gati të sfidojnë Juventusin në garën për titullin dhe pse jo ti zbresin bardhezinjtë nga froni ku mbretërojnë prej 6 vitesh. Për mbrojtësin e djathtë shqiptar ky do të jetë sezoni i tretë te skuadra e Sarrit. Në këto 2 vite 23-vjeçari nga Shkodra ka qenë një titullar i padiskutueshëm te Napoli aq sa në drejtim të klubit



jugor kanë ardhur shumë oferta për Hysajn nga disa prej klubeve më të mëdha europiane. Megjithatë dëshira e madhe e kuqezijut është të fitojë një titull kampion me Napolin, sic e ka bërë shpeshherë të ditur dhe kjo është një nga arsytet që se ka menduar asnjëherë largimin. Sezoni i parë i Etrit Berishës me Atalantën ishte për tu vendosur në vitrinë.

Vendi i 4-t në kampionat u arrit edhe falë pritjeve fantastike të portierit shqiptar i cili zhvilloi një sezon perfekt dhe tashmë është gati të përsërisë vetveten dhe pse jo të bëjë paraqitje ako-


ma edhe më të mira. Berisha tashmë është në cdo efekt një futbollist i skuadrës zikaltër pasi gjatë kësaj vere Atalanta bleu përfundimisht kartonin e tij nga Lazio. Objektivi i 28-vjeçarit nga Prishtina është të bëjë sërish të lumtur tifozët bergamaskë, me Berishën që është gati të lërë sërish shenjën e tij duke filluar që nga ndeshja e javës së parë ndaj Romës. Atë që se bëri dot Etrit Berisha te Lazio e realizoi me sukses Thomas Strakosha. Talenti shqiptar me formën e arritur gjatë sezonit të kaluar arritë të ulte në stol një portier ekspert si Federico Marchetti.

Në finalen e Superkupës së Italisë tregoi edhe njëherë sesa vlen duke dhënë një sinjal të qartë se ky do të jetë sezoni i shpërthimit të tij. Tanimë më kuqeziu është një titullar fiks i portës së Lazios me Marchettin që ka pranuar të jetë zëvendësi i tij.

Ndaj Spal-it të Dielën në mbrëmje, Thomas Strakosha nis rrugëtimin e tij drejt një sezoni që pritet ta shohë si protagonist absolut të bardhekaltërit. Arlind Ajeti la Torinon gjatë kësaj vere pikërisht për tu transferuar te Crotone aty ku pritet ta ketë të sigurtë vendin në formacion dhe të hedhë pas shpatullave atë sezon të vështirë që kaloi te Torino. Te kalabrezët e Davide Nicolas, Ajeti do të ketë mundësi të tregojë potencialin e tij të vërtetë, pasi ka më pak presion se tek Torino dhe mund të spikasë ashtu sic bëri te Frosinone në sezonin e tij të parë në Serinë A. Të Dielën ndaj Milanit mbrojtësi shqiptar pritet ta nisë si titullar. Ai ka debutuar në Serinë A me fanellën e Atalantës por pas një sezoni te Avellino, Gjimeshi do të luajë sërish si i huazuar këtë herë te Benevento. Paraqitjet e tij të mira me Avellino bënë që klubi nga Campania, të firmoste me mbrojtësin e kombëtares shqiptare e cili edhe pse nuk pritet ta nisë sezonin si titullar te Benevento, konsiderohet një vlerë e shtuar për skuadrën që në këtë sezon debuton në Serinë A italiane.

## Së shpejti do të bëjë një garë me Valentino Rossin

Lewis Hamilton si gjithnjë preferon sfidat dhe është gati për një tjetër të tillë shpejtësie, këtë herë në motoçiklizëm. Pasioni i tij për këtë sport dihet prej kohësh, teksa ai shpesh lëviz nga gara në garë me motor, madje në garën e Bahreinit në Formula 1 deklaroi se një ditë synon të garojë në MotoGP. Në një intervistë për "Channel 4" piloti britanik i Mercedes tha: "I pëlqej shumë garat e motoçiklizmit dhe ju garantoj se së shpejti do të bëjë një garë me Valentino Rossin në garat rally, jo në pistë normale garash të MotoGP", u shpreh Hamilton.



## Turneu i Cincinatti starton pa surpriza



Turneu i Cincinattit nisi pa surpriza me favoritet që arritën të fitonin pa shumë probleme sfidat e tyre. Nick Kyrgios nuk pati probleme kundër David Goffin teksa triumfoi në dy sete me rezultatin 6-2, 6-3. Kyrgios pati meritën në setin e parë pasi në gamen e tretë mundi të marrë menjëherë një game me break duke patur më pas kontrollin e lojës, ndërsa në setin e dytë gjithçka ishte e barabartë deri në gamen e 6-të, përpara se Kyrgios të merrte 3 game radhazi duke fituar 6-3 dhe krejt takimin 2-0. Shumë e luftuar ishte ndeshjes mes Juan Mar-

tin Del Portos e Thomas Berdych, me cekun që fitoi setin e parë 6-3 por u dorëzua më pas në dy pasardhësit 7-6 dhe 6-0. Yuichi Siguta arriti të mposhtë numërin 13-të të turneut Jack Sock në dy sete, me japonezin që luftoi fortë në setin e parë ku fitoi 7-5 pasi i mori shërbimin kundërshtarit të tij, ndërsa në setin e dytë një tjetër game me break i dha atij fitoren 6-4 në setin e dytë. italiani Fabio Fognini nuk arriti dot të përballojë lojën e Dominic Thiem duke u dorëzuar lehtësisht përpara kundërshtarit të tij që fitoi 2-0 me sete, 6-3, 6-2.

## Wenger e pranon: Sanchez ikën si lojtar i lirë

Trajneri i Arsenalit, Arsene Wenger, thotë se është një mundësi e veçantë që Alexis Sanchez të largohet nga klubi në verën e ardhshme, si transferim i lirë. Ai thotë se nuk ka pasur progres në arritjen e një rinovimi për sulmuesin 28-vjeçar, marrëveshja e të cilit është deri në qershorin e ardhshëm. Gjithsesi, kjo nuk do të thotë se Wenger do ta ndalë së luajturi kilienin. Alexis ka qenë i lidhur me PSG dhe Manchester City, klube që e konsiderojnë atë një objektivi të lartë, por Wenger ka pranuar tani se ylli i tij është gati të largohet për asgjë. "Ne nuk kemi bërë ndonjë përparim në atë drejtim, - pranoi trajneri



francez kur u pyet për një kontratë të re me Alexis. - Largimi i tij si lojtar i lirë është një pasojë e asaj që unë po them, për fat të keq. Ne duhet të bëjmë një zgjedhje midis efikasitetit në terren dhe interesit financiar. Në këtë rast mendoj se do t'i jap përparësi anës sportive". Wenger

mohoi ngjashmëritë me gjendjen e Diego Costa te Chelsea, ku lojtari po përpiqet të detyrojë blutë për një transferim tek Atletico Madrid: "Unë nuk mendoj se ka ndonjë krahasim në të gjithë, sepse ne duam që Sanchez të jetë me ne, ndërsa Chelsea nuk e dëshiron këtë domosdosh-

mërisht." Alexis nuk është paraqitur këtë sezon për shkak të një problemi në muskujt e barkut. Ai nuk do të jetë i gatshëm të luajë kundër Stoke në fundjavë, ndonëse trajneri është i bindur se do të kthehet së shpejti. "Për Sanchez duket pak herët rikthimi. Ai po punon shumë në trajnim. Pjerëz-it tanë mjekësorë mendojnë se e shtuna vjen shumë shpejt, - shtoi Wenger. - Ai duhet të jetë i disponueshëm në ndeshjen e ardhshme, kundër Liverpulit. Shërimi i tij po shkon shumë mirë, po punon shumë. Ne duhet të jemi të kujdesshëm me një tendosje të muskujve, që të mos kemi asnjë pengesë për të".

## Zyrtare, Bacca lë Milanin, firmos për Villareal

Carlos Bacca, pas 2 vitesh kuqezij, ku realizoi 34 gola në 77 ndeshje, ka firmosur sot me skuadrën spanjolle te Villareal. Lajmin e ka konfirmuar klubi spanjoll, që e ka marrë ish-sulmuesin e Milanit në formë huazimi, me të drejtë blerje sezonin e ardhshëm. Për Bacca ky

është një rikthim në La Liga, pasi ka luajtur aty në sezonet 2013-2015 me skuadrën e Siviglia. Po këtë mëngjes, Carlos Bacca ka qenë në Spanjë, ku ka kryer dhe ka kaluar me sukses testet mjekësore e më pas është prezantuar si sulmuesi i ri i Villareal. Ai ka shkuar në formë

huazimi, nga i cili Milani do të përfitojë momentalisht 2,5 milionë euro, ndërsa blerja përfundimtare pas një viti është fiksuar në shifrën e 15,5 milionë eurove. "Jam krenar që do të vesh fanellën e këtij ekipi dhe që më është dhënë mundësia të tregoj afërsitetë e mia si sulmues te

Villareal", kanë qenë fjalët e para të sulmuesit kolumbian me skuadrën e re. Lajmin e këtij transferimi e kanë konfirmuar sot edhe drejtuesit kuqezinj, në prag të konferencës për shtyp që Milani ka zhvilluar para ndeshjes me Shkëndinë, e vlefshme për Europa League.



**DASHI (20/III-20/IV)**

Marrëdhëniet me bashkëpunëtorët ose kolegët janë nën shënjestrën e Hënës, që nuk është në favor me shenjën tuaj, kështu që duhet të tregoheni të qetë dhe diplomatë. Jepini më shumë hapësirë dashurisë dhe marrëdhënieve sociale dhe do të shihni që do t'ju kthehet buzëqeshja.

**DEMI (21/IV-20/V)**

Marrëdhëniet me bashkëpunëtorët ose kolegët janë nën shënjestrën e Hënës, që nuk është në favor me shenjën tuaj, kështu që duhet të tregoheni të qetë dhe diplomatë. Jepini më shumë hapësirë dashurisë dhe marrëdhënieve sociale dhe do të shihni që do t'ju kthehet buzëqeshja.

**BINJAKËT (21/V-20/VI)**

Konfigurimet e ekuilibruara jvore sot do t'ju japin optimizmin e duhur. Lëreni fantazinë të lirë dhe do të shikoni që do t'i bëjë mirë si shpirtit, ashtu edhe trupit tuaj. Një darkë nën shoqërinë e miqve tuaj, do t'ju bëjë të ndiheni në humor.

**GAFORRJA (21/VI-22/VII)**

Mos përfshini familjarët tuaj në një keqkuptim midis jush dhe partnerit. Hëna dhe Marsi, në kundërshtim me shenjën tuaj, ju bëjnë të ndiheni nervozë dhe të shkarkoni të gjithë tensionin e mbledhur mbi personat që keni më për zemër.

**LUANI (23/VII-22/VIII)**

E ekuilibruar, romantike dhe diplomate Hëna të shenja e Peshores, do t'ju dhurojë qëndrueshmëri në jetë dhe ju drejton në rrugën e duhur për sa u përket zgjedhjeve të detyruara. Sfera profesionale do t'ju nxisë një bashkëpunim me kolegë, bashkëpunëtorë dhe shokë studimi.

**VIRGJËRESHA (23/VIII-22/IX)**

Shumë gjëra po shkojnë në drejtimin e duhur, duke filluar që nga situata financiare shumë aktive. Mund të bëni plane të detajuara për të përmirësuar hyrjet e parave në llogarinë tuaj. Shikojeni të ardhmen sentimentale me besim dhe shpresë.

**PESHORJA (23/IX-22/X)**

Sot do të jetë një ditë ku fantazia dhe shpirti krijues mund të bëjnë të veçantë jetën tuaj profesionale dhe sentimentale. Vetëm tregoni të kujdesshëm në marrëdhëniet me njerëzit e seksit të kundërt dhe në menaxhimin e detyrave që ju ngarkohen në punë.

**AKREPI (22/X-21/XII)**

Sot do të jetë një ditë ku fantazia dhe shpirti krijues mund të bëjnë të veçantë jetën tuaj profesionale dhe sentimentale. Vetëm tregoni të kujdesshëm në marrëdhëniet me njerëzit e seksit të kundërt dhe në menaxhimin e detyrave që ju ngarkohen në punë.

**SHIGJETARI (22/XI-21/XII)**

Ndiheni energjikë për të sfiduar çdo rrezik që mund t'ju dalë në rrugën tuaj, për të bërë për vete personin që ju intereson, ose për të takuar dashurinë tuaj sekrete. Kënaqësi të mëdha personale do të vijin nga një marrëdhënie e vjetër miqësie.

**BRICJAPI (22/XII-20/I)**


Hëna në pozicion pak të favorshëm me shenjën tuaj bën që sot të shfaqni sjellje kritike përballë partnerit, sidomos në qoftë se ai i përket Gaforres ose Peshores. Në qoftë se dëshironi të mos prishni ditën e sotme, ruani një sjellje korrekte në ambientin profesional dhe privat.

**UJORI (20/I-19/II)**

Të ndiheni tërheqës, të sigurt në vetvete dhe të rëndësishëm për dikë, mjafton për të qenë të bukur dhe interesantë. Është vetëm çështje vetëkontrolli. Përfitoni nga ky moment me fat për ta shfrytëzuar në sektorët që keni më shumë nevojë.

**PESHQIT (20/II-19/III)**

Do të demonstroi një shpirt të madh iniciative dhe aftësi të shkëlqyera për të parandaluar çdo problem që ju paraqitet. Ata që kanë një aktivitet të pavarur, mund të kenë besim të suksesi i garantuar dhe përfitime të mëdha.



KOHA	KOHA QË SHTOHEJ KOHËS SE RREGULLIT (SH)	LIDHJA E KONTRATËS KONTRAKTIMIT	FLORI	VEPRIMTARI YNE ZEKË	VEPRIMTARI YNE FOTË (DELEGAT NË KONGRESIN E MANASTIRIT)	VEDHJES	VEPRIMTARI YNE FOTË (DELEGAT NË KONGRESIN E MANASTIRIT)	IDA NJATUN	BANORE E NË SHITETI ISHULLOR NË OQ. E QIETE KËRCELL GRURI	S	TITULL FISNIK ANGLEZ	PROVINÇË NË KANADA
RRETHANË DUKURI						VIJAT					AMPER	
NË GJUHË AFRO-AZIATIKE (FLITET NË ÇAD)						LLOJ TURJELE DORE					AKTORI ANGLEZ GINIS	
AKTORJA AMERIKANE MARGARET			QYTET NË SLLAVONI, KROACI						KËNGËTARJA JONË, FARA			
FILIM							AMERICAN ENGLISH				ELEKTRO OPTIKA	
POZITA PËRBALLE NJERI-TJETRIT							SHULL NË DETIN E KARABEVE				RAJONI I FSHATIT	
K												
AKTORI AMERIKAN, FALCO				NËJË E NËJË FILLI, VJEGËT								
MASA E VËLLIMIT TË LENGJEVE	NËJËSI E MADHE LUFTARAKE (SHQ)			LUMË (SPANJ)							SULFUR	
L							LLOJ NEURONI ME DY ZGATJE				UNIONI GUERMAN OLIVER TUIST	RADIUM
MAL NË BULLGAR, AFER SOFJES							SHUMËS					
									MORALI			

ZGJIDHJET: S, PIKASO, BENJAMIN, T, SHORT, DRITA, A, OSHËNAR, NK, ELI, IRA, EO, ANORAK, SHAK, LINJAT, M, TORAM, LARANË, EN, DARUVARAS, START, AE, IKU, KARSHI KARSHI, SE, TAV, ARAQET, S, KORPUSI, UGJ, LITRI, BIPOLAR, VITOSHA, ETIKA.

**Sudoku**

*shumë i lehtë*

*shumë i vështirë*

4			6					2
	6		7		2			8
			4	3	9			
	3	4				2	7	
8		5				3		6
	7	6				9	5	
			5	1	3			
	2		9		8			1
5				7				4

							6		
4			3		8	5			
	2	7		9				3	
	7			6				1	
		3	5		2	4			
	5			4				2	
7	1			2		3	8		
		8	1		5				4

Shumë i lehtë: 459681732, 361752489, 782439165, 134695278, 895127346, 276384951, 948513627, 627948513, 513276894, Shumë i vështirë: 381257649, 469318572, 527694138, 274963815, 193582467, 856741923, 715429386, 638175294, 942836751.





## Policët ia hoqën shaminë, myslimania dëmshpërblehet me 85.000 dollarë

Një qytet i Kalifornisë ka rënë dakord të paguajë 85,000 dollarë për të zgjidhur një padi të ngritur nga një grua muslimane, shamia e së cilës u hoq me forcë nga policia. Këshilli mbi Marrëdhëniet Amerikano-Islamike (CAIR), i cili njoftoi

vendimin të enjten, kishte paditur qytetin e Long Beach në emër të Kirsty Powell, një muslimane afrikano-amerikane, "pasi policët me forcë i hoqën hixhabin në sy të meshkujve të tjerë oficerë dhe dhjetëra të burgosurve." Powell, e cila mban mbulesën e kokës "si pjesë e besimit të saj fetar", ishte "detyruar të kalonte tërë natën e ekspozuar në paraburgim, dhe e përshkroi përvojën si traumatizuese", tha grupi i të drejtave. Powell u arrestua

gjatë një ndalesë trafiku në maj të vitit 2015 për mandatat e papaguara që ishin pastruar prej kohësh. Long Beach votoi të martën për të miratuar vendimin, tha CAIR, duke shtuar se komunitetet aty pranë kanë miratuar tashmë politika që mbrojnë veshjet fetare në paraburgim pas padive të ngjashme. Tani oficeret femra janë të detyruara t'u heqin shaminë femrave të burgosura "kur është e nevojshme për sigurimin e oficerëve", dhe kjo larg

oficerëve meshkuj dhe të burgosurve, tha për Los Angeles Times avokati i qytetit Long Beach, Monte Machit. Gjatë arrestimit, oficerët i thanë Powell se ajo duhet të hiqte shaminë e saj. Asaj iu mohua kërkesa për një oficerë femër, dhe iu mohua kërkesa për të mbajtur shaminë e saj në paraburgim. "Unë nuk do të doja kurrë që dikush të përjetonte atë që unë ndjeva nga kjo përvojë", tha Powell vitin e kaluar kur u paraqit padia, sipas CAIR.

## Bisha Jaguar, 100 kilometra për 5.1 sekonda

Divizioni ekskluziv i "Jaguar Land Roverit" që është përgjegjës për përfundimin e modeleve ekzistuese, i kanë mbetur detajet e fundit në modelin "XE SVR", që pritet të jetë rival i "BMW M3". "Auto Express" raporton se, modeli është duke u zhvilluar në Spanjë dhe është ekskluzivisht rival i "BMW"-së dhe "Mercedes-AMG C63". "XE SVR" ka motorin "supercharged" 5.0-litra V8 me tetë shpejtësi automatike. Modeli i përfunduar ka 567 kuajfuqi, që lënë prapa "BMW"-në. Përfundimi i ka mundësuar veturës që shpejtësinë 100 kilometra në orë ta arrijë për 5.1 sekonda.



## Stallone nis xhirimet për "This Is Us"



Sylvester Stallone ka filluar zyrtarisht xhirimet për "This Is Us". Aktori 71-vjeçar lajmin e bëri të ditur përmes llogarisë së tij në Instagram duke publikuar një fotografi. "Miku im i mirë Mimo Ventimiglia i cili ishte mjaft i këndshëm për të më ftuar të isha në këtë shfaqje "This Is Us", tha Sylvester nën fotografimin me Milo para se të postonte më shumë foto me yjet e këtij sezoni, Justin Hartley dhe Chrissy Metz. Sezoni i dytë i "This Is Us" shfaqet të martën, më 26 shtator në NBC.

## KALENDARI HISTORIK 17 GUSHT

- 1579 - Francois van Anjou viziton mbretëreshën angleze Elizabeta I.
- 1743 - Suedia dhe Rusia nënshkruajnë marrëveshje të paqes.
- 1787 - Hebrenjve u jepet leje në Budapest të Hungarisë të luten në grupe.
- 1834 - Çarls Darwin arrin në majë të Kampana në Kili.
- 1858 - Hapet banka e parë në Havai.
- 1892 - Gjenerali rus, Obruçev dhe ai francez, Boisdefre nënshkruajnë Aleancë të dyfishtë.
- 1903 - Xho Pulitzer dhuron i 1 milion dollar Universitetit të Kalifornisë dhe fillon me Çmimet e Pulitzerit.
- 1914 - Lituania i dorëzohet gjermanëve.
- 1916 - Sulmi bullgar ndaj Maqedonisë.
- 1917 - Italia i shpall luftë Gjermanisë dhe Turqisë.
- 1918 - Trupat britanike sulmojnë Bakun në Azerbajxhan.
- 1924 - Nënshkruhet marrëveshje tregtare mes Francës dhe Gjermanisë.
- 1926 - Marrëveshja e paqes mes Grekëve dhe Sllavëve serb dhe kroat.
- 1940 - Hitleri urdhëron bllokadë totale ndaj Britanisë së Madhe.
- 1988 - Kryetari pakistanez Muhammad Zia-ul-Haq dhe Ambasadori amerikan Arnold Raphel vriten në një aksident ajror.

## A E DINI SE...



Kënga juaj e preferuar është e tillë, për shkak se ju a asocioni ndoshta me një moment tejet emocional në jetën tuaj.

Ekzistojnë më shumë se 400 fobi (frikëra) që janë kataloguar prej psikologëve.



Nëse shpenzoni para për të tjerët, përftoni më shumë lumturi se sa nëse i shpenzoni për vete, sipas disa studimeve.

## BARSOLETA



**ÇFARË POZICIONI TË PËLQEN?**  
Ajo: Zemër çfarë pozicioni të pëlqen ty?  
Ai: Të kem kokën afër prizës që të karikoj telefonin!

**BURRI I PAKËNAQUR**  
- Burri i pakënaqur nga gruaja i çon sms vjehrrës: Produkti që ju keni prodhuar është jashtë kërkesave të mija...!  
- Vjehrra ja kthen: Produkti që ju keni marr është mall pa kthim pasi i ka kaluar afati i garancisë dhe i është prish vula e sigurisë!

## THËNIA E DITËS

Pasardhësit njeriu nuk mund t'i ndryshojë, por mund të përcaktojnë çfarë do të ndodhë me pasardhësit. (François de la Rochefoucauld)

